



СЕГА

Коалиција на младински организации
www.sega.org.mk



БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО

Pestalozzi Children's Foundation



UDHËZUES

**PËR PJESËMARRJE TË NXËNËSVE,
ORGANIZIM TË NXËNËSVE DHE
MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË
FËMIJËVE NË SHKOLLAT FILLORE**



UDHËZUES

**PËR Pjesëmarrje të nxënësve,
Organizim të nxënësve dhe
Mbrotje të të drejtave të
fëmijëve në shkollat fillore**

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “Zbatimi i Konventës për të drejtat e fëmijës në Maqedoni”, mbështetur nga ana e Fondacionit të fëmijëve Pestaloci, ndërsa e zbatuar nga ana e Koalicionit të organizatave rinore SEGA në bashkëpunim me Byronë për zhvillimin e arsimit dhe Ministrinë për arsim dhe shkencë. Mendimet e shprehura në këtë dokument u takojnë autorëve dhe nuk i shprehin qëndrimet e Fondacionit të fëmijëve Pestaloci.

Titulli

Udhëzues për pjesëmarrje të nxënësve, organizim të nxënësve dhe mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në shkollat fillore

Botues

Koalicioni i organizatave rinore SEGA

Autorë

Mitko Çeshllarov, Byroja për zhvillim të arsimit
Ajshe Ajrullai, Byroja për zhvillim të arsimit
Oliver Stanojoski, Byroja për zhvillim të arsimit
Zoran Ilieski, Koalicioni i organizatave rinore SEGA
Tomislav Gajtanoski, Koalicioni i organizatave rinore SEGA
Monika Ilioska Kantarxhioska, Koalicioni i organizatave rinore SEGA

Bashkëpunëtorë

Teodora Stolevska
Marija Nashokovska

Lektura

Katica Trajkova

Përkthimi

Besim Dogani

Dizajni

Brigada Dizajn

Shtypshkronja

Acetoni

Tirazhi:

200 kopije

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

373.3:342.7-053.2(497.7)(036)
373.3.062(497.7)(036)

UDHËZUES për pjesëmarrje të nxënësve, organizim të nxënësve dhe mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në shkollat fillore / [autorë Mitko Çeshllarov ... и др.]. - Prilep : Koalicioni i organizatave rinore SEGA, 2020. - 71 стр. : табели ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Други автори: Ajshe Ajrullai, Oliver Stanojoski, Zoran Ilieski, Tomislav Gajtanoski, Monika Ilioska Kantarxhioska. - Содржи и: Shtojca 1-16

ISBN 978-608-4631-13-2

1. Cheshllarov, Mitko [автор] 2. Ajrullai, Ajshe [автор] 3. Stanojoski, Oliver [автор] 4. Ilieski, Zoran [автор] 5. Gajtanoski, Tomislav [автор] 6. Ilioska Kantardjioska, Monika [автор]
а) Права на децата - Заштита - Основни училишта - Македонија - Водичи б)
Ученици - Париципација - Основни училишта - Македонија - Водичи
COBISS.MK-ID 111982602

TË GJITHË TERMET TË CILËT NË DOKUMENT JANË PËRDORUR NË GJININË GRAMATIKORE MASHKULLORE PËRFSHIJNË GJININË MASHKULLORE DHE FEMËRORE TË PERSONAVE TË CILËVE U REFEROHEN.

PËRMBAJTJA

1. UDHËZUES PËR PJESËMARRJE TË NXËNËSVE, ORGANIZIM TË NXËNËSVE DHE MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË SHKOLLAT FILLORE	4
1.1. HYRJE DHE QËLLIMI I UDHËZUESIT	4
1.1.1.Konventa për të drejtat e fëmijës	5
1.1.2Si lindi Konventa për të drejtat e fëmijëve?	5
1.1.3Si të kuptojnë fëmijët dhe të rinjtë më tepër për të drejtat e tyre?	6
1.2.PJESËMARRJA E NXËNËSVE	7
1.2.1Parimi i pjesëmarrjes aktive të nxënësve në jetën e shkollës	7
1.2.2Lloje të pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve	8
2. MODELE TË PJESËMARRJES SË NXËNËSVE DHE MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË SUAZA TË SHKOLLËS	12
2.1.BASHKËSIA E PARALELES	12
2.1.1 Zgjedhja e kryetarit të bashkësisë së paraleles	12
2.1.2 Procedura për zgjedhje të kryetarit të bashkësisë së paraleles	13
2.1.3 Shkarkimi i kryetarit të bashkësisë së paraleles	14
2.1.4 Funksionimi i bashkësisë së klasës	15
2.2. PARLAMENTI I NXËNËSVE	15
2.2.1. Zgjedhja e kryetarit të parlamentit të nxënësve	15
2.2.2 Ndërprerje e parakohshme e mandatit të kryetarit të parlamentit të nxënësve	16
2.2.3 Propozim-trupa të parlamentit të nxënësve	16
2.2.4 Kompetencat e parlamentit të nxënësve	16
2.3. THEMELIMI I OMBUDSMANIT TË NXËNËSVE	17
2.3.1 Procedura për zgjedhje të ombudsmanit të nxënësve	18
2.3.2 Mandati i ombudsmanit të nxënësve	19
2.3.3 Procedura për dorëzim të parashtresave dhe komunikim me personelin e shkollës	19
2.4. UDHËZIME DHE DOKUMENTE THEMELORE TË NEVOJSHME PËR PLANIFIKIM DHE REALIZIM TË SUKSESSHËM TË AKTIVITETEVE TË NXËNËSVE	20
2.4.1 Plani vjetor për punë (Plan veprimi për aktivitete)	20
2.4.2 Mbledhjet e trupave të bashkësisë së nxënësve (parlamenti i nxënësve, bashkësia e paraleles, ombudsmani i nxënësve, trupa tjerë të përhershëm dhe të përkohshëm me pjesëmarrje aktive të nxënësve)	20
2.4.3 Roli i nxënësve në mbledhjet e trupit	21
2.5. UDHËZIME KONKRETE PËR OBLIGIMET DHE AKTIVITETET E ARSIMTARËVE DHE SHËRBIMEVE PROFESIONALE	21
3. BURIME MBËSHTETËSE PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE NË SHKOLLË	23
3.1. KOMUNIKIMI, LIDERSHIPI DHE PUNA EKIPORE	23
3.1.1. Komunikimi – hyrje	23
3.1.2. Lidershipi – hyrje	27
3.1.3. Puna ekipore	28
3.2. UDHËZIM DHE REKOMANDIME PËR MBLEDHJE EFEKTIVE	30
3.3. HULUMTIM – SI TË ZHVILLONI NJË PYETËSOR	32
3.4. DEBATI NË ARSIM	35
4. MODULE PËR PUNËTORI DHE TRAJNIME ME NXËNËS	40
4.1. Punëtori: Kam të drejtë t’i di të drejtat e mia	40
4.2. Modul për punëtori: Vendimi im, vendimi yt	40
4.3. Modul për punëtori: Ndërmarrja e veprimeve në shkollë	41
4.4. Modul për punëtori: Njohja me Konventën për të drejtat e fëmijës	44
4.5. Modul për punëtori: Parimet e Konventës për të drejtat e fëmijës	46
4.6. Modul për punëtori: Të drejta tjera nga Konventa për të drejtat e fëmijës dhe roli i ombudsmanëve të nxënësve	51
4.7. Modul për punëtori për arsim ndërkulturor	58
5. SHTOJCA – FORMA TË DOKUMENTEVE	59

1. UDHËZUES PËR Pjesëmarrje të nxënësve, Organizim të nxënësve dhe mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në shkolla fillore

1.1 HYRJE DHE QËLLIMI I UDHËZUESIT

Ky botim paraqet një udhëzues për zbatimin e nenit 68 të Ligjit për Arsim Fillor, i miratuar në korrik të vitit 2019 dhe ka të bëjë me “Organizimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve”. “Udhëzuesi për pjesëmarrje të nxënësve, organizim të nxënësve dhe mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në shkolla fillore” (në tekstin e mëposhtëm – Udhëzuesi) i dedikohet të gjitha shkollave, bashkësive të paraleleve, bashkësive dhe parlamenteve të nxënësve, kujdestarëve të klasave në shkolla fillore, si dhe shërbi-meve profesionale, të cilët duhet të jenë bartësit, përkrahësit dhe promotorët kryesor të pjesëmarrjes demokratike të nxënësve në shkollë. Udhëzuesi përmban burime për ngritje të kapaciteteve dhe zbatim efektiv të të drejtave të fëmijëve në sistemin arsimor. Pjesëmarrja dhe organizimi i nxënësve duhet të integrohen në statutin e çdo shkolle në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për Arsim Fillor, si dhe në pajtim me këtë dokument.

Udhëzuesi është përpiluar në kuadër të projektit “Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijës në Maqedoni”, i realizuar nga Koalicioni i Organizatave Rinore SEGA ndërmjet viteve 2011 – 2019, i mbështetur nga Fondacioni i Fëmijëve Pestaloci, ndërsa në bashkëpunim të ngushtë me Byronë për Zhvillim të Arsimit dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Qëllimi i projektit ishte të forcohen njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm për të praktikuar të drejtat e fëmijëve, si dhe fuqizimit të pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset e vendimmarrjes në përputhje me rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Gjatë periudhës së kaluar, SEGA ka realizuar pilot modele për pjesëmarrjen e nxënësve dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shkollat pilot, shkollat e mesme dhe fillore, në bazë të së cilave është përpiluar ky dokument.

Në pjesën hyrëse të Udhëzuesit jepet një hyrje e shkurtër për atë përse është e rëndësishme për nxënësit të mësojnë për të drejtat e tyre dhe çfarë nënkupton pjesëmarrja aktive e nxënësve në jetën e shkollës. Pastaj, janë dhënë shembuj të formave themelore të organizimit të shkollës – bashkësitë e paraleleve, bashkësitë e nxënës-

ve dhe parlamenti i nxënësve dhe si do të funksiononin ato në mënyrë demokratike, si dhe propozim-procedura për futjen e Ombudsmanit të nxënësve në shkolla, i cili si model pilot i zbatuar me projektin e SEGA-s është identifikuar si i tillë dhe është futur në Ligj, i cili paraqet edhe një hap përpara drejt të ushtruarit të vërtetë të demokracisë në shkolla dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Shtojcat e Udhëzuesit përfshijnë propozim-module për punëtori/seminare dhe trajnime për punën me arsimtarët dhe nxënësit për të ndërgjegjësuar pjesëmarrjen e vërtetë të nxënësve në jetën demokratike të shkollës (me përshtatjen e tyre sipas nevojës) me forma dhe metoda se si ajo të nxitet dhe të gjallërohet në shkolla.

Gjithashtu, janë dhënë shembuj edhe të disa dokumenteve themelore për planifikimin e punës së parlamenteve të nxënësve, ndërmarrjen e iniciativave, planifikimin e aktiviteteve, mbajtjen e procesverbaleve, përgatitjen e raporteve, formave të adresimit deri tek organet shkollore për sigurimin e propozimeve/kërkesave, shembuj të formularëve për realizimin e zgjedhjeve demokratike të përfaqësuesve të organizatave të nxënësve ose të trupave të tjerë në shkollë, etj.

Për shkak të zbatimit efektiv të dispozitave ligjore për pjesëmarrjen e nxënësve, ndërsa në pajtim me praktikat pozitive të projektit, rekomandohet që **çdo shkollë të formojë ekip të përkrahjes së pjesëmarrjes dhe organizimit të nxënësve** (në tekstin e mëposhtëm – ekipi për përkrahje). Udhëzuesi përmban propozim-detyrime të arsimtarëve për të përkrahur aktivitetet që duhet të realizohen nga parlamenti i nxënësve në shkollë gjatë një viti shkollor. Gjithashtu, janë dhënë edhe propozim-detyrime të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional të ekipit për përkrahje në lidhje me Ombudsmanin e nxënësve dhe aktiviteteve të ombudsmanëve nxënës gjatë një viti shkollor.

1.1.1. Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Konventa për të Drejtat e Fëmijës është një marrëveshje ndërkombëtare e miratuar nga Kombet e Bashkuara, e cila i përmban të drejtat për të cilat kanë rënë dakord shtetet anëtare, për ato të drejta që iu takojnë të gjithë fëmijëve anëmbanë botës. Konventa i përcakton standardet themelore të mirëqenies së fëmijëve në fazat e ndryshme të zhvillimit të tyre. Shtetet që do ta pranojnë (ratifikojnë) këtë Konventë kanë për detyrë të krijojnë kushte për zbatimin praktik të të drejtave të fëmijëve. Ato rregullisht i dorëzojnë raporte Komitetit për të Drejtat e Fëmijës pranë OKB-së, rreth masave që ndërmerren për të harmonizuar ato me dispozitat e Konventës. Aktualisht, kjo është Konventa të cilën e kanë pranuar pjesa më e madhe e shteteve të botës.

Kjo Konventë është akti i parë universal juridik dhe obligues mbi të drejtat e fëmijës në histori. Në të janë përfshirë disa të drejta thelbësore të fëmijës, të cilat deri atëherë ishin të shpërndarë në një numër më të madh të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Konventa përcakton një kornizë të hollësishme për standardet minimale që janë të nevojshme për të arritur progresin e fëmijëve. Karakteristikë e Konventës është se ajo më tepër se cilido qoftë instrument tjetër për të drejtat e njeriut përfshin në vete një spektër të tërë të të drejtave të njeriut: të drejta qytetare, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe siguron zhvillim të plotë të potencialeve të çdo fëmije në ambient lirie, dinjitet dhe drejtësi. Konventa e përkufizon raportin ndërmjet bartësve të të drejtave (fëmijëve) dhe bartësve të detyrimeve (të rriturve). Vendosja e statusit “bartës i të drejtave” dhe “bartës i detyrimeve” dhe zbatimi i këtij parimi paraqesin thelbin e realizimit të ndryshimeve të rëndësishme dhe të qëndrueshme në jetën dhe perspektivën e fëmijëve dhe si i tillë duhet të citohet gjatë çdo kërkesë të bërë në emër të fëmijëve. Gjithmonë duhet të kihet parasysh se ndryshimet e kërkuara nuk janë akt i keqardhjes, mëshirës ose dhembshurisë, por realizim i detyrimit dhe përgjegjësisë të marrë përsipër për fëmijët. Çasti kryesor gjatë nisjes së aktiviteteve lidhur me avokimin për të drejtat e fëmijëve është të arrihet ky kalim drejt vrojtimit të fëmijëve si bartës të të drejtave.

Teksti i Konventës është i ndarë në katër pjesë:

Preambula – e përcakton kontekstin e Konventës;

Pjesa e parë (neni 1–41) – i përcakton të drejtat e të gjithë fëmijëve;

Pjesa e dytë (neni 42–45) – e shqyrton monitorimin dhe zbatimin e Konventës;

Pjesa e tretë (neni 46–54) – i përfshin kushtet për hyrjen në fuqi.

Grupimi themelor i neneve që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve është bërë sipas përmbajtjes: mbijetesë, mbrojtja, zhvillimi dhe pjesëmarrja.

Të drejtat që kanë të bëjnë me mbijetesën i mbulojnë të drejtat e fëmijëve për jetë dhe nevojat e tyre, përmbushja e të cilave është e domosdoshme për ekzistencë. Në to bëjnë pjesë të drejtat për standarde të përshatshme jete, shtëpie, ushqimi dhe qasjeje në shërbime shëndetësore.

Të drejtat që kanë të bëjnë me zhvillimin i përfshijnë ato gjëra për të cilat kanë nevojë fëmijët për të ngritur potencialin e tyre. Këtu bëjnë pjesë e drejta për arsim, lojë dhe pushim, aktivitete kulturore, qasje në informacione, liri të mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar.

Të drejtat për mbrojtje e imponojnë detyrimin ligjor për mbrojtje të fëmijëve nga çfarëdo lloj keqpërdorimi, anashkalimi ose shfrytëzimi. Këto të drejta përfshijnë çështje si që janë: kujdesi i veçantë për fëmijët refugjatë, tortura, keqpërdorimi në sistemin e të drejtës penale, shfrytëzimi i fëmijëve në konflikte të armatosura, punësimi i fëmijëve, keqpërdorimi i substancave psikotrope, si dhe shfrytëzimi seksual.

Të drejtat për pjesëmarrje iu mundësojnë fëmijëve të kenë rol aktiv në shoqëri. Këtu bëjnë pjesë liria e shprehjes së mendimit të vet, e drejta shprehjes për çështje që kanë të bëjnë me jetën e tyre, e drejta e organizimit dhe e drejta e tubimit të qetë. Forcimi i aftësive të fëmijëve duhet të shpie drejt mundësive më të mëdha për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shoqërore, me çfarë ato do të përgatiten që të bëhen qytetarë të rritur e të përgjegjshëm.

Konventa është pjesë përbërëse e sistemit më të gjere të të drejtave të njeriut dhe i referohet të gjitha pikëpamjeve të jetës së fëmijës, si dhe është ligjërish e detyrueshme.

1.1.2. Si lindi Konventa për të Drejtat e Fëmijës?

Në vitin 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e miratoi Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Natyrisht, në këtë dokument pionier u përfshinë edhe të drejtat e fëmijëve, mirëpo së shpejti, u arrit konsensus ndërkombëtar se nevojat e posaçme të fëmijëve duhet të përfshihen në një dokument të veçantë.

Në vitin 1959, Kombet e Bashkuara e miratuan Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës. Ajo përbëhet nga 10 të drejta dhe nuk ka qenë ligjërish e detyrueshme për shtetet nënshkruese.

Në vitin 1978, Qeveria e Polonisë i dorëzoi një Propozim-Konventë për të Drejtat e Fëmijëve Komisionit për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara. Gjatë Vitit Ndërkombëtar të Fëmijëve në vitin 1979, Komisioni ngriti një grup pune me detyrë për të bashkërenduar idetë e llojllojshme lidhur me Propozim-Konventën, të cilat i propozuan qeveritë e të gjitha vendeve të botës. Shteteve iu deshën 10 vite negociata dhe marrëveshje që të mund të arrijnë kompromis rreth të drejtave që çdo fëmijë duhet t'i ketë në tërë botën.

Më 20 nëntor 1989, u përfundua Konventa për të Drejtat e Fëmijës, ndërsa Asambleja e Përgjithshme e miratoi menjëherë. Megjithatë në thelb e ruajti frymën e Deklaratës për të Drejtat e Fëmijës së vitit 1959, Konventa i pasqyron problemet dhe arsyet bashkëkohore të shqetësimit, si që janë dëmtimi i mjedisit jetësor, ke-

qpërdorimi i drogës dhe shfrytëzimi seksual. Konventa hyri në fuqi në vitin 1990 pas ratifikimit të 20 shteteve. Vendi ynë e ratifikoi Konventën në vitin 1993. Deri në vitin 2019, 196 shtete e ratifikuan Konventën për të Drejtën e Fëmijës.

Ratifikimi i Konventës – çfarë nënkupton kjo?

Kur një shtet i caktuar e ratifikon Konventën, ajo bëhet pjesë e legjislacionit vendor, ndërsa ai shtet obligohet:

- t'i mundësojë kushtet e domosdoshme për realizimin e të drejtave të përcaktuara në Konventë;
- t'i pranojë të gjitha masat e domosdoshme për arritjen e standardeve të përcaktuara në Konventë (ndryshim të ligjeve, formim të trupave dhe mekanizmave të ri, ndërrim të shprehive administrative dhe sociale);
- ta përcaktojë vlerën maksimale të burimeve të disponueshme për të siguruar zbatim të Konventës.

Në shumicën e rasteve, për të arritur standardet e Konventës, mund të jetë i domosdoshëm rishikim i plotë i politikave ekzistuese dhe buxhetimit me qëllim tejkalimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm të pengesave për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Shteti ka marr përsipër:

- të harmonizojë legjislacionin kombëtar;
- të harmonizojë praktikën;
- të sigurojë praktikimin;
- të garantojë mbrojtjen;
- të përhap njohuritë.

1.1.3. Si të kuptojnë fëmijët dhe të rinjtë më tepër për të drejtat e tyre?

Fëmijët nuk mund të kuptojnë më tepër për të drejtat e tyre vetëm me anë të leximit të Konventës dhe neneve të saj. Hapi i parë i rëndësishëm është të dihet se ekziston një dokument i tillë që iu referohet atyre, ndërsa mënyra e vërtetë që të rinjtë dhe fëmijët të kenë njohuri për të drejtat e tyre është mundësia që ato të drejta t'i praktikojnë në jetën e përditshme; të drejtat të jenë të pranishme në çdo aktivitet që ka të bëjë me ato, si dhe t'iu jepet liri të rinjve dhe fëmijëve që t'i hulumtojnë kufijtë e të drejtave të tyre dhe t'i zbulojnë të drejtat e të tjerëve. Në kushte ideale, duhet të ndodh një proces i tre fazave, i cili përfshin:

- **studimin** e temës për të drejtat e fëmijëve – grumbullimi, analiza dhe sinteza e informacioneve që kanë të bëjnë me këtë temë, shpjegimi i të drejtave abstrakte me ndihmën e situatave konkrete në jetën e përditshme, identifikimi i të drejtave dhe shkëlja e tyre, zbulimi i kufijve të të drejtave;

- **reagimin** ndaj informacioneve të grumbulluara – njohja me perspektivat e llojllojshme, zhvillimi i ndjeshmërisë për dimensionin njeri lidhur me ato të drejta, perceptimi i përgjegjësisë për respektim të të drejtave të të tjerëve, kultivimi i ndjenjës së empatisë dhe krijimi i interesimit për pjesëmarrje;
- **ndërmarrjen e veprimeve** në mënyrë konkrete dhe praktike, zakonisht në mjedisin e vet; gatishmëri për të qëndruar në mbrojtje të të drejtave të veta dhe të tjerëve; nëpërmjet aktiviteteve të manifestimeve lokale për çështje lidhur me të drejtat globale, fëmijët mund të ndërlidhen me përpjekjet që bëhen në tërë botën me qëllim të ndihmohet drejtësia dhe të nxiten ndryshime konstruktive.

Të drejtat e fëmijëve dhe prindërit

Konventa për të Drejtat e Fëmijës konfirmon një numër të madh të të drejtave themelore dhe ajo e vë në plan të parë mirëqenien e fëmijës, duke i marr parasysh të drejtat dhe detyrimet e prindërve. Konventa konkretisht thekson se qeveritë do të bëjnë gjithçka në fuqinë e tyre për të mos u prishur familja dhe do të sigurojnë mbështetje dhe ndihmë për prindërit në përmbushjen e detyrave të tyre kryesore lidhur me rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre. Avancimi i të drejtave të fëmijëve nuk nënkupton vënien e fëmijëve në konflikt me të rriturit në jetën e tyre, por nënkupton nxitje të të gjithë qytetarëve që së bashku të punojnë për një të ardhme të sigurt, të shëndetshme dhe produktive të fëmijëve të tyre.

Pjesa thelbësore e procesit të mësimi është ambienti në të cilin zhvillohet hulumtimi i temave lidhur me të drejtat e fëmijëve. Fëmijët mund të kuptojnë se çfarë të drejtash kanë nëpërmjet metodave gjatë të cilave informacionet ua jep një person i rritur. Mirëpo, mësimi për thelbin e të drejtave nënkupton krijimin e një ambienti në grup në të cilin çdo individ çmohet dhe respektohet; në të cilin fëmija nuk ndjen asnjë kërcënim; në të cilin nuk ka vend për supozime dhe paragjykime; në të cilin nxitet pjesëmarrja demokratike dhe ku të shprehurit e mendimit të vet është normë. Shkurt, mësimi do të jetë më efikas kur të rinjtë jo vetëm që do t'i kuptojnë nocionet, por edhe do t'i praktikojnë shkathtësitë e nevojshme dhe vetvetiu do t'i zhvillojnë qëndrimet që kanë rëndësi thelbësore për realizimin dhe avancimin e të drejtave.

Një element njësoj i rëndësishëm i mësimi të të drejtave është edhe shembulli personal i të rriturit. Çfarëdo dallimi ndërmjet asaj që flitet dhe asaj që veprohet mund të ketë ndikim jashtëzakonisht negativ mbi procesin e kuptimit dhe praktikimit të të drejtave.

Gjatë punës me të rinjtë, të rriturit duhet të jenë të vetëdijshëm se shumë pikëpamje të të drejtave janë jashtëzakonisht të ndjeshme dhe personale. Në çdo grup mund të ketë të rinj që kanë përjetuar ose përjetojnë varfëri, abuzim, anashkalim, ndarje nga njëri ose të dy prindërit ose diskriminim. Nevoja e tyre për privatësi duhet të respektohet; ato asesi nuk guxojnë

të detyrohen të flasin për këto tema kundër vullnetit të tyre. Nga ana tjetër, të rriturit duhet paraprkisht të dinë se cilat janë personat e duhur ose shërbimet e shkollës ose në komunitet që do të mund të ndërmjetësojnë gjatë shkëlqeve serioze të të drejtave. Atëherë, nëse lind nevoja, ata do të jenë të përgatitur dhe do të dinë se ku t'i referojnë fëmijët, të cilët mund të kenë nevojë për ndihmë profesionale.

1.2. PJESËMARRJA E NXËNËSVE

Pjesëmarrja (participimi) i fëmijëve:

- është e drejtë e njeriut – në qoftë se fëmijët privohen nga e drejta e tyre për pjesëmarrje, atëherë kjo nënkupton se janë shkelur të drejtat e tyre;
- është nevojë themelore për zhvillim të shëndetshëm njerëzor;
- paraqet parakusht për qytetari demokratike;
- mundëson përmirësim të cilësisë së dispozitave që kanë të bëjnë me fëmijët;
- garanton përgjegjësi më të madhe të fëmijëve për aktivitetet e ndërmarrja.

Pjesëmarrja e nxënësve ka rëndësi të veçantë personale dhe shoqërore nëse merret parasysh se paraqet mjetin më të mirë nëpërmjet të cilit nxënësit mund të mësojnë se si të qëndrojnë në mbrojtje të të drejtave të veta dhe të tjerëve, si dhe si të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes dhe si të marrin pjesë në mënyrë demokratike në jetën e shkollës dhe komunitetit. **Në bazë të nenit 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, fëmijët kanë të drejtë ta shprehin lirshëm mendimin e tyre, të cilit duhet kushtuar vëmendje e posaçme në pajtim me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tyre. Në bazë të nenit 15, fëmijët kanë të drejtë për lirinë e organizimit dhe lirinë e grumbullimit paqësor. Pikërisht kjo, jo vetëm që iu jep të drejtë, por edhe i obligon shkollat që t'i mësojnë nxënësit për qeverisje demokratike në mënyrë që do të sigurojnë forma të organizuara të përfshirjes aktive të nxënësve në proceset demokratike.** Më tutje, është shumë e rëndësishme që format e tilla të mos jenë vetëm si një simulim i të drejtave dhe përgjegjësi që ani do të duhet të fitohen, por t'u jepet nxënësve një mundësi të vërtetë për të ndikuar në marrjen e vendimeve për çështje që janë në interes të jetës së tyre në shkollë dhe jashtë saj.

1.2.1. Parimi i pjesëmarrjes aktive të nxënësve në jetën e shkollës

Shkolla do t'i mundësojë pjesëmarrje aktive nxënësit në realizimin e të gjitha aktiviteteve të shkollës që kanë të bëjnë me të. Kjo nënkupton:

- a) **sigurim të ambientit dhe kushteve** të cilat do t'i nxisin nxënësit të formojnë mendimin e tyre të pavarur dhe ta shprehin lirshëm atë mendim pa asnjë pasojë dhe
- b) **ndërtim të mekanizmave dhe procedurave** që do t'u mundësojnë nxënësve të kenë ndikim ndaj vendimeve dhe zhvillimeve në shkollë, duke pasur rezultate qartësisht të dukshme nga ai ndikim.

Ky parim e përmban edhe të drejtën e çdo fëmije që të kërkojë, pranojë dhe jep informacione, të merr pjesë në procese të vendimmarrjes dhe të organizohet me fëmijë të tjerë për shkak të formulimit dhe manifestimit më të përshtatshëm të nevojave dhe interesave të veta¹.

Kërkesa për përfshirjen aktive të nxënësve në jetën shkollore për të gjitha gjërat që iu referohen atyre buron edhe nga qasja e përgjithshme ndaj Konventës për të Drejtat e Fëmijës, në të cilën theksohet se fëmijëria nuk është vetëm përgatitje për periudhën kur do të jemi të rritur, por ajo paraqet një periudhë të veçantë të jetës së çdo njeriu në të cilën fëmijët duhet të trajtohen si individë me të drejtat e tyre, të barabartë me të rriturit dhe si pjesëmarrës aktiv në zhvillimet e shkollës dhe komunitetit, të cilët duhet të shndërrohen në qytetarë të rritur dhe të përgjegjshëm që i respektojnë të drejtat e të tjerëve.

Vetëm shkolla e hapur që mundëson pjesëmarrje demokratike të nxënësve paraqet garanci për stabilitet të shkollës, vendosje të marrëdhënieve ndërmjet të rriturve dhe fëmijëve, si dhe një ambient të përshtatshëm në të cilin edhe fëmijët edhe të rriturit ndjehen rehatshëm, ndërsa arsimtarët iu mundësojnë nxënësve të fitojnë njohuritë, qëndrimet dhe shkathtësitë e përshtatshme me të cilat nxënësit do të përgatiten për t'u përballur në mënyrë konstruktive me sfidat në shkollë dhe në komunitetin më të gjerë.

Shkolla që krijon nxënësit të përgatitur për aktivitet demokratik, mes tjerash:

- nxit **bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet të gjithë** aktorëve në të, edhe të rritur edhe fëmijë;
- e promovon **barazinë**, edhe kur bëhet fjalë për të drejtat, edhe kur bëhet fjalë për përgjegjësitë;
- zhvillon **ndjenjë të përgjegjësisë** për respekt të ndërsjellë, ndërtim të normave shkollore të mirë menduara, respektim të normave dhe vlerave shkollore, si dhe për tejkalimin e problemeve në shkollë, të cilat janë pjesë e jetës së përditshme (për shembull: prania e formave të ndryshme të dhunës, çështje të sigurisë, disiplina gjatë orës mësimore dhe gjatë pushimeve, përballimi me pirjen e duhanit, konsumimi i alkoolit dhe substancave të tjera psiko-aktive, etj.);

¹ Konceptimi për arsim dhe edukim nëntëvjeçar fillor, gusht 2007, faqe 69.

- nxit **pjesëmarrje të përbashkët** të nxënësve në procese të llojllojshme që kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të tyre për punë në ekip, bashkëpunim të ndërsjellë, avokim të interesave të përbashkëta dhe marrje të vendimeve të përbashkëta;
- zhvillon **shkathtësi sociale** dhe e forcon **mendimin kritik** të nxënësit;
- zhvillon **ndjeshmëri për nevojat**, edhe për nevojat e veta edhe për të tjerët dhe
- ndërton **respektim dhe praninë të dallimeve**.

Nxënësit e përfshirë në jetën e shkollës ndjehen si pjesë qendrore dhe thelbësore të saj, ndjejnë se shkolla kujdeset për ato, ndërsa ato ia kthejnë duke marrë pjesë aktive në të, gjë që më tutje shpie në zhvillimin e vazhdueshëm të shkollës. Përfundimisht, ambienti që krijohet në kushte të tilla kontribuon në përmirësimin e marrëdhënieve ndër-personale ndërmjet fëmijëve dhe të rriturve.

Nxënësit duhet të përfshihen në mënyra të llojllojshme dhe nivele të ndryshme të vendimmarrjes për të gjitha gjërat që kanë të bëjnë me ato në shkollë, ndërsa realisht shumë të pakta janë ato gjëra ku nuk kanë të bëjnë me ato. Nxënësit mund të marrin pjesë pothuajse në të gjitha sferat e jetës së shkollës, në lidhje me:

- **mësimdhënien** (për shembull: si të përmirësohet suksesi dhe vlerësimi, si të përmirësohet cilësia e mësimdhënies ose disa kushte të punës, si të jetë orari i ditës);
- **aktivitetet jashtë mësimore** (për shembull: ku të shkohet në shëtitje, ekskursion, si të shënohet një manifestim, si të organizohet një festë e përbashkët, cilat pjesë të organizohen në shkollë, si të ndahen mjetet për aktivitetet jashtë mësimore);
- **marrëdhëniet ndërmjet nxënësve** (për shembull: si të përmirësohen marrëdhëniet në klasë, si të zgjidhet një konflikt);
- **marrëdhëniet me të rriturit** (për shembull: si të zgjidhen problemet në lidhje me disa arsimtarë dhe nxënës), dhe
- **kushtet fizike në shkollë** (për shembull: si të rregullohet shkolla, si të përmirësohet higjiena e tualeteve, si të sigurohet kujdes për sistemin e reklamave shkollore, si të sigurohen libra të ri për bibliotekën).

Cili është roli i të rriturve?

Të rriturit:

- duhet të jenë të vetëdijshëm për aftësitë e nxënësve për të shprehur, përfaqësuar dhe përçuar pikëpamjet e veta;
- kanë për detyrë t'iu kushtojnë vëmendje të përshtatshme mendimeve të fëmijëve;
- duhet të krijojnë kushte në të cilat fëmijët do të mund lirisht ta shprehin mendimin e tyre;
- duhet të ndërmarrin masa nëpërmjet të cilave do të inkurajohet dhe ndihmohet pjesëmarrja e fëmijëve, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre;

- duhet të jenë iniciatorë dhe lehtësues të procesit të pjesëmarrjes së fëmijëve;
- kanë obligim ta kërkojnë mendimin e fëmijëve për vendime që kanë të bëjnë me ato ose që i prekin fëmijët;
- duhet të jenë kompetent ta dëgjojnë mendimin e fëmijëve.

Çfarë duhet të plotësohet që të arrihet pjesëmarrje e vërtetë e fëmijëve?

Fëmijët kanë të drejtë:

- të jenë të informuar për të drejtat e tyre;
- të kenë mjedis të sigurt që ofron mundësi për shkëmbim të informacioneve dhe mendimeve;
- t'i mësojnë shkathtësitë për pjesëmarrje nëpërmjet praktikimit dhe realizimit të tyre.

Çfarë duhet të shmanget në punën me fëmijët:

1. Nuk guxon të jemi tepër këmbëngulës.
2. Nuk duhet të imponohen mendimet dhe zgjidhjet personale.
3. Nuk guxon të premtohen gjëra joreale dhe të pa realizueshme.
4. Nuk guxon të manipulohet me fëmijët.

1.2.2. Llojet e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve

Fëmijët mund të përfshihen ose të jenë të pranishëm në proceset e vendimmarrjes në mënyra të ndryshme. Jo çdo përfshirje e fëmijëve në proceset e vendimmarrjes paraqet edhe realizimin e të drejtave të garantuara me Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Mënyra e pjesëmarrjes dhe respektimit të disa standardeve themelore kanë rëndësi të posaçme për realizimin e ndikimit të vërtetë të fëmijëve dhe respektimit të parimeve kryesore të mosdiskriminimit, interesit më të mirë të fëmijës, si dhe mbijetesës dhe zhvillimi. *Shkalla e pjesëmarrjes*, autor i të cilit është Roxher Hart, paraqet tetë shkallë të përfshirjes së fëmijëve dhe të rinjve. Ajo zbatohet si kriter për vlerësim, përkatësisht sa janë të përfshirë të rinjtë në zgjidhjen e çështjeve të përbashkëta në komunitet. Në këtë shkallë, niveli më i lartë i pjesëmarrjes për një çështje është kur të rinjtë e iniciojnë atë çështje, ndërsa e zgjidhin së bashku me të rriturit, kurse niveli më i ulët i pjesëmarrjes së të rinjve është kur janë të ftuar të marrin pjesë në një projekt, por nuk kanë as informacione të vërteta as ndikim për vendimet dhe rezultatet që arrihen.

Sipas kësaj shkalle, pjesëmarrja e fëmijëve mund të jetë në formë të:

- **manipulimit** – fëmijët e tregojnë ose e bëjnë atë që iu sugjerojnë të rriturit, pa mos e kuptuar problemin në të vërtetë. Për manipulim bëhet fjalë edhe atëherë kur të rriturit i pyesin fëmijët se çfarë duan dhe i dëgjojnë disa prej ideve të tyre, mirëpo nuk i njoftojnë për mënyrën se si këto mendime kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar;
- **dekorimit** – dekorimi i referohet asaj kur fëmijët marrin pjesë në një ngjarje të caktuar pa asnjë njo-

huri për problemin për të cilin janë ftuar dhe pa mundësi reale që në të vërtetë të ndikojnë në vendimet që merren;

- **tokenizmit** – është praktikë kur fëmijët pyeten që ta shprehin problemin e tyre, pa mos pasur mundësi për ta kuptuar mënyrën se si ta shprehin mendimin ose ta përcaktojnë vëllimin e ideve që mund t'i shprehin;
- **emëruar, por të informuar** – të rriturit ndërmarrin iniciativë për të ftuar fëmijët, mirëpo fëmijët vetë vendosin nëse do të marrin pjesë në aktivitetet, pasi që të jenë të informuar për elementet e projektit për të cilin janë ftuar;
- **konsultuar dhe informuar** – fëmijët marrin pjesë si konsulentë në një projekt që është hartuar dhe menaxhuar nga të rriturit, me shpjegime paraprake për procesin në të cilin do të përfshihen fëmijët dhe me qasje serioze për mendimet e tyre;
- **vendime të përbashkëta me fëmijët, të nxitura nga të rriturit** – të rriturit paraqiten si iniciatorë që i përfshijnë fëmijët në projekte, ndërsa marrja e vendimeve të rëndësishme patjetër duhet të bëhet me konsensus ndërmjet të rriturve dhe fëmijëve;
- **të iniciuar dhe menaxhuar nga fëmijët** – fëmijët fillojnë, organizojnë dhe vetë menaxhojnë me një projekt, pa përfshirjen e të rriturve;
- **vendime të përbashkëta me të rriturit, të nxitura nga fëmijët** – marrja e vendimeve të përbashkëta të fëmijëve dhe të rriturve është qëllimi përfundimtar i pjesëmarrjes autentike.

Standardet për realizimin e pjesëmarrjes së përshtatshme të fëmijëve në procesin e vendimmarrjes janë:

1. Qasja etike: transparencja dhe ndershmëria

Individë dhe organizata kanë për detyrë të veprojnë në mënyrë etike në raste kur në procesin e vendimmarrjes marrin pjesë fëmijë dhe duhet t'i vënë interesat e fëmijëve në plan të parë.

Pse?

Ekziston një ekuilibër i pashmangshëm në fuqinë dhe statusin e fëmijëve dhe të rriturve. Qasja etike është e domosdoshme që pjesëmarrja e fëmijëve të jetë reale dhe domethënëse.

Si të përmbushet ky standard?

- Fëmijët duhet të kenë mundësi që lirisht t'i shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre, si dhe ato duhet të shqyrtohen me respekt.
- Pjesëmarrja e fëmijëve duhet të përkufizohet si një qëllim i veçantë.
- Rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë palëve të përfshira (fëmijë, të rritur dhe palë të tjera) janë qartësisht të përkufizuara, të kuptuara dhe të harmonizuara.
- Fëmijëve iu sigurohen të gjitha informacionet e nevojshme dhe kanë qasje në to.

- Fëmijët janë të përfshirë në proceset e vendimmarrjes që nga fillimi dhe kanë mundësi të ndikojnë në formën dhe përmbajtjen e proceseve në të cilat marrin pjesë.
- Fëmijët kanë kohë ta analizojnë pjesëmarrjen e tyre dhe kanë mundësi për ta dhënë pëlqimin e tyre.
- Të rriturit "nga jashtë", të përfshirë në çfarëdo procesi me pjesëmarrje të fëmijëve, duhet të jenë të ndjeshëm gjatë punës me fëmijë, të kenë vullnet të dëgjojnë dhe të mësojnë, si dhe ta kenë të qartë rolin e tyre.
- Organizatat dhe punëtorët e tyre janë përgjegjës për fëmijët lidhur me obligimet e ndërmarrja.
- Atje ku procesi i pjesëmarrjes kërkon që të ketë një grup më të madh të fëmijëve, zgjedhja e përfaqësuesve të grupit do të bazohet në parimet e demokracisë dhe mosdiskriminimit.
- Pengesat me të cilat mund të përballen fëmijët në fushat tjera të jetës së tyre duhet të shqyrtohen dhe të diskutohen së bashku me fëmijët.

2. Pjesëmarrja e nxënësve është relevante dhe vullnetare

Fëmijët marrin pjesë në punën e temave të interesit të tyre të drejtpërdrejtë dhe kanë të drejtë të përcaktohen nëse do të marrin pjesë ose jo.

Pse?

Pjesëmarrja e nxënësve duhet t'i ngrit njohuritë e tyre personale – informacionet dhe njohuritë që i kanë në jetën e tyre lidhur me çështjet e interesit të tyre. Duke konsideruar obligimet e tyre të tjera, pjesëmarrja e fëmijëve duhet të jetë nën kushtet e tyre dhe me kohëzgjatje të përcaktuar nga vetë ato.

Si të përmbushet ky standard?

- Pyetjet janë në interes të fëmijëve që janë përfshirë.
- Fëmijët janë përfshirë në përcaktimin e kriterëve të përfaqësimit dhe përzgjedhjes së pjesëmarrjes.
- Fëmijët kanë nevojë për informacione të disponueshme dhe përkrahje për të marrë një vendim të informuar për (mos)pjesëmarrjen e tyre.
- Pjesëmarrja e fëmijëve është në baza vullnetare dhe ato mund të tërhiqen në çdo çast.
- Fëmijët duhet të përfshihen në mënyrë, nivel dhe shpejtësi që janë të përshtatshme me kapacitetet dhe interesat e tyre.
- Duhet të respektohen edhe obligimet e tjera të fëmijëve dhe të përshtatemi sipas tyre (për shembull: detyra shtëpie, detyra pune, detyra shkollë).
- Mënyrat e punës dhe metodat e pjesëmarrjes duhet të përfshijnë dhe përmirësojnë strukturat, traditat, njohuritë dhe praktikat lokale.

3. Një mjedis që ofron mundësi dhe është miqësor për fëmijët

Fëmijët gjenden në një ambient të sigurt, inkurajues dhe të mirëpritur për pjesëmarrjen e tyre.

Pse?

Cilësia e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe aftësia e tyre për të nxjerrë dobi nga ajo janë nën ndikim të fuqishëm të përpjekjeve të bëra për krijimin e një ambienti pozitiv për pjesëmarrjen e tyre.

Si të zbatohet ky standard?

- Zgjedhja e mënyrave dhe kushteve të përshtatshme të punës e ndërton vetë-respektin dhe vetëbesimin e fëmijëve dhe ato ndjehen të aftë për të kontribuar me përvojën dhe pikëpamjet e tyre.
- Fëmijët marrin pjesë në krijimin e metodave të pjesëmarrjes dhe kanë mundësi ta zgjedhin mënyrën e të shprehurit me të cilin do të ndjehen më të rehatshëm.
- Janë vënë në dispozicion burime dhe kohë e mjaftueshme për pjesëmarrje cilësore.
- Të rriturit janë ndërgjegjësuar me qëllim që më mirë ta kuptojnë vlerën e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të luajnë një rol pozitiv në përkrahjen e tyre (p.sh., me ngritjen e vetëdijes, me ndërtimin e kapaciteteve dhe me të menduarit e tyre).
- Si vende për takime shfrytëzohen vendet në të cilat fëmijët ndjehen të çliruar, të rehatshëm dhe kanë qasje në kapacitete të nevojshme, ndërsa duhet të jenë të qasshme edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Procedurat zyrtare dhe organizative janë të dizajnuara/të përshtatura në drejtim të lehtësimit (e jo frikësimit) të fëmijëve dhe të mikpritjes për fëmijët me më pak përvojë.
- Atje ku është e nevojshme, sigurohet përkrahje për ndarjen e informacioneve dhe/ose ngritjen e kapaciteteve dhe shkathtësive që janë të nevojshme për pjesëmarrjen efikase të fëmijëve.
- Fëmijët pyeten se cilat për çfarë informacionesh kanë nevojë, ndërsa informacionet e qasshme iu ofrohen në kohë, në formatin dhe gjuhën e kuptueshme për fëmijët.
- Në situatat kur fëmijët hasin në gjuhë të ndryshme nga gjuha e tyre amtare, është e nevojshme të sigurohet përkthim, me çfarë do të mundësohet pjesëmarrja e plotë e fëmijëve në diskutime, si dhe qasja e tyre në informacionet e shkruara.
- Në të gjitha diskutimet në të cilat marrin pjesë fëmijët përdoret gjuhë jo teknike dhe/ose të gjitha nocionet teknike ose në zhargon shpjegohen tërësisht.

4. Barazia e mundësive

Puna me pjesëmarrjen e fëmijëve duhet që t'i zvogëlojë e jo t'i forcojë skemat ekzistuese të diskriminimit dhe përjashtimit.

Pse?

Fëmijët, po ashtu edhe të rriturit, nuk janë grup homogjen dhe pjesëmarrja duhet të sigurojë barazi të mundësive për të gjithë, pa dallim të moshës, statusit, prejardhjes etnike, të klasave, gjinisë, aftësive dhe faktorëve të tjerë.

Si të zbatohet ky standard?

- Të gjithë fëmijët duhet të kenë shanse të barabarta për pjesëmarrje dhe të mos diskriminohen për shkak të moshës, gjinisë, aftësive, gjuhës, prejardhjes shoqërore, etnike të klasës, ose gjeografike, etj.
- Pjesëmarrja e fëmijëve duhet të përqendrohet në

përfshirjen e të gjithëve, e jo në përfshirjen e një pakice të vogël (përfshirjen e fëmijëve në mjediset e tyre lokale, në vend që të ftohen përfaqësues të tyre në një pikë të centralizuar).

- Procedurat për sigurim të pjesëmarrjes së fëmijëve duhet të jenë mjaft elastike që t'i plotësojnë nevojat, pritshmëritë dhe gjendjet e grupeve të llojllojshme të fëmijëve.
- Kufiri i moshës, gjinia dhe aftësitë e fëmijëve merren parasysh gjatë përcaktimit të mënyrave të organizimit të pjesëmarrjes.
- Nuk bëhet asnjë supozim paraprakisht për atë se si dhe sa mund të bëjnë grupet e llojllojshme të fëmijëve.
- Gjithkund ku është e mundur, fëmijët duhet vetë të përgjedhin se cilët nga prijësit e tyre do t'i përfaqësojnë në iniciativat në të cilat ato do të marrin pjesë.
- Persona të rritur me ndikim angazhohen në drejtim të sigurimit të përkrahjes nga komuniteti për pjesëmarrje të grupeve të diskriminuara.

5. Të rriturit janë efikas dhe të sigurt

Të rriturit që janë përfshirë në procese dhe aktivitete në të cilat marrin pjesë fëmijë janë të trajnuar për kryerjen e punës së vet sipas standardeve të larta.

Pse?

Të rriturit mundet që edhe në mënyrë efikase dhe të sigurt ta nxisin pjesëmarrjen e vërtetë të fëmijëve, vetëm nëse disponojnë me shkathtësi dhe njohuri të nevojshme.

Si të zbatohet kjo?

- Të rriturit janë të ndërgjegjësuar për pjesëmarrjen e fëmijëve dhe e kuptojnë obligimin për ta mundësuar këtë pjesëmarrje.
- Për të rriturit është siguruar trajnim i përshtatshëm dhe mundësi të tjera për të arritur përparim në procedurat në të cilat janë të përfshirë fëmijët.
- Ndërtohen shkathtësi teknike specifike dhe ekspertizë (për shembull: komunikim, lehtësim, zgjidhje të konflikteve ose punë shumë-kulturore).
- Sigurohet mbështetje për të rriturit për të cilët pjesëmarrja e fëmijëve paraqet ndryshim të rëndësishëm personal ose kulturor, pa mos e konsideruar këtë si problem.
- Të rriturit janë në gjendje t'i shprehin qëndrimet ose shqetësimet e tyre në kontekst të përfshirjes së fëmijëve, duke shpresuar se kjo do të shpaloset në mënyrë konstruktive.

6. Me pjesëmarrjen promovohet siguria dhe mbrojtja e fëmijëve

Politikat dhe procedurat për mbrojtje të fëmijëve paraqesin një pjesë thelbësore të punës me pjesëmarrjen e fëmijëve.

Pse?

Individët dhe organizatat kanë për detyrë të kujdesen për fëmijët me të cilët punojnë dhe duhet të bëjnë çmos për të minimizuar rrezikun nga abuzimi ose shfrytëzimi i fëmijëve, si dhe nga pasoja të tjera negative të pjesëmarrjes së tyre.

Si të zbatohet kjo?

- Kujdesi për mbrojtjen e fëmijëve ka prioritet më të lartë gjatë planifikimit dhe organizimit të pjesëmarrjes së tyre.
- Fëmijët e përfshirë në këto procedura janë të vetëdijshëm për të drejtën e tyre për të qenë të sigurt nga abuzimet dhe dinë se ku të drejtohen për ndihmë, në rast se paraqitet nevoja.
- Mbrojtja futet me qëllim të minimizimit të rreziqeve dhe parandalimit të keqpërdorimeve.
- Të rriturit që punojnë me fëmijët i njohin përgjegjësitë dhe obligimet e tyre ligjore dhe etike (për shembull: në drejtim të sjelljes së vet dhe në drejtim të asaj se çfarë duhet të ndërmerret në rast të sjelljes së papërshtatshme të të tjerëve).
- Në procedurat për mbrojtjen e fëmijëve janë futur rreziqet specifike me të cilat përballen disa grupe të fëmijëve, si dhe pengesat tjera me të cilët ballafaqohen gjatë pranimit të ndihmës.
- Bëhet vlerësim i kujdesëshëm i rreziqeve lidhur me pjesëmarrjen e fëmijëve në paraqitje publike, fushata dhe avokime. Në pajtueshmëri me rreziqet e identikuara, është e mundur të ndërmerren hapa për mbrojtjen e identitetit të fëmijëve.
- Duhet të sigurohet pëlqim për përdorim të të gjitha informacioneve të fituara nga fëmijët, ndërsa informacionet e besueshme duhet të mbrohen në çdo kohë.
- Asnjë fotografi, video material ose fotografi digjitale e fëmijëve nuk duhet të shkrepet ose publikohet pa pëlqimin e fëmijës.

7. Verifikimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm

Pjesë përbërëse e pjesëmarrjes së fëmijëve paraqesin edhe informacionet kthyesë dhe verifikimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe ndikimit që e kanë krijuar fëmijët me pjesëmarrjen e tyre.

Pse?

Është e rëndësishme që fëmijët të kuptojnë se çfarë rezultati ka arritur pjesëmarrja e tyre dhe si është shfrytëzuar pjesëmarrja e tyre për arritjen e qëllimit të dëshiruar. Është e para pëlqyeshme që fëmijëve t'iu jepet mundësi, atje ku është e realizueshme, të marrin pjesë në proceset dhe aktivitetet e vazhdueshme. Si lojtarë kryesor, fëmijët duhet të jenë pjesë përbërëse e proceseve të monitorimit dhe vlerësimit.

Si të zbatohet kjo?

- Fëmijëve iu jepen informacione kthyesë të shpejta dhe të qarta për rezultatet e pjesëmarrjes së tyre, për pasojat e çfarëdo vendimi ose hapi të radhës dhe për vlerën e pjesëmarrjes së tyre.
- Informacionet kthyesë i jepen çdo fëmije të përfshirë.
- Fëmijët pyeten për kënaqësinë e tyre për procesin në të cilin kanë marr pjesë dhe për mendimet e tyre se si ai mund të përmirësohet.
- Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit iu dërgohen fëmijëve të përfshirë dhe iu prezantohen në mënyrë të përshtatshme, ndërsa reagimet e tyre merren parasysh gjatë aktivitetëve të ardhshme.
- Njihen gabimet që janë identifikuar gjatë procesit të vlerësimit dhe ndërmerren obligime që mësimet e fituara të zbatohen për përmirësimin e procedurave për pjesëmarrjen e fëmijëve në të ardhmen.

Promovimi, praktikimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve mund të sigurohen në mënyra të llojllojshme, joformale dhe alternative. Parimi që është e lejuar gjithçka që nuk është e ndaluar me ligj, lë shumë hapësirë për të gjetur zgjidhje krijuese dhe të pazakonshme, gjë që në masë të madhe do të mundësojë realizimin e interesit më të mirë të fëmijëve, zhvillimin e tyre, mosdiskriminimin dhe pjesëmarrjen e tyre aktive.

2.

MODELE TË PJESËMARRJES SË NXËNËSVE DHE MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË SUAZA TË SHKOLLËS

Të gjithë nxënësit e shkollës e përbëjnë komunitetin e shkollës. Nxënësit kanë të drejtë në organizim të nxënësve në nivel të paraleles ose shkollës. Për realizimin e organizuar të interesave të nxënësve në shkollën fillore, nxënësit organizohen në bashkësi të paraleles dhe parlament të nxënësve. Parlamentin e nxënësve e përbëjnë kryetarët e bashkësive të paraleleve.

Ligji për Arsim Fillor
(korrik 2019, neni 68, paragrafi 1 dhe 4)

Shkolla duhet të mundësojë pjesëmarrje aktive dhe t'i nxit nxënësit të organizohen, përveç në bashkësi të paraleles dhe bashkësi të shkollës, edhe në trupa të veçantë të nxënësve dhe trupa të tjera pune të nxënësve. Nëpërmjet tyre, nxënësve iu jepen mundësi të strukturuar që në mënyrë aktive t'i hulumtojnë dhe diskutojnë pikëpamjet e ndryshme të jetës shkollore që janë relevante për ato, të mësojnë të flasin për problemet që i prekin nëpërmjet trupave të tyre të zgjedhur dhe përfaqësuesve të tyre, të bashkëpunojnë për kontekste të ndryshme (në përbërje të ndryshme etnike dhe gjinore ose me nxënës me pikëpamje të ndryshme) dhe të zbulojnë pikëpamje të llojllojshme të çështjeve që janë të rëndësishme për ato, t'i analizojnë ato që të mund pastaj të punojnë në përmirësimin e tyre.

Në këtë mënyrë, shkolla transformohet në një vend për të mësuar sipas përvijës dhe praktikimit të demokracisë dhe funksionimit demokratik në shoqëri, në vend që të shërbejë vetëm si një vend për të fituar njohuri në disa lëndë të caktuara. Nëpërmjet këtij procesi, nuk mësojnë vetëm ata që janë të përzgjedhur në këto trupa, por edhe gjithë nxënësit e tjerë që janë dëshmitarë të aktiviteteve të tyre ose që i ndihmojnë ato aktivitete në mënyrë aktive, si dhe ata që i ndjejnë efektet e punës së tyre.

2.1. BASHKËSIA E PARALELES

2.1.1. Zgjedhja e kryetarit të bashkësisë së paraleles

Në bazë të nenit 68 të Ligjit për Arsim Fillor, "Të gjithë nxënësit e shkollës e përbëjnë bashkësinë e shkollës. Nxënësit kanë të drejtë për t'u organizuar në nivel të paraleles dhe shkollës (paragrafi 1). Për realizimin e organizuar të interesave të nxënësve në shkollën fillore, nxënësit organizohen në bashkësi të paraleles dhe parlament të nxënësve. Parlamentin e nxënësve e përbëjnë kryetarët e bashkësive të paraleleve (paragrafi 3)". Bashkësinë e paraleles (në tekstin e mëposhtëm - bashkësia) e përbëjnë të gjithë nxënësit e paraleles (klasës). Detyrat e bashkësisë janë për të vendosur për çështje lidhur me mësimdhënien, qëndrimin në shkollë, marrëdhëniet e ndërsjella, si dhe marrëdhëniet me të rriturit në shkollë.

Zgjedhja e trupave të bashkësisë së paraleles kryhet çdo vit, në javën e fundit të muajit të parë të vitit shkollor. Çdo bashkësi zgjedh kryetarin, zëvendës-kryetarin, trupa të përhershëm dhe të përkohshëm. Është e para pëlqyeshme që çdo fëmijë të jetë anëtar së paku në një trup të përhershëm (në përputhje me afinitetet e tij/saj). Trupat e përhershëm nuk duhet të kenë numër të caktuar paraprakisht, madje as orientim tematik. Nxënësit vetë duhet të vendosin sa trupa të përhershëm do të kenë. Çdo nxënës (përveç kryetarit dhe zëvendës-kryetarit të bashkësisë) vullnetarisht përcaktohet se në cilin trup do të merr pjesë. Kryetari dhe zëvendës-kryetari i bashkësisë së paraleles i regjistron anëtarët në çdo trup, ndërsa listën e ruajnë në dokumentacionin e bashkësisë. Kryetari i bashkësisë zgjidhet me mandat prej një viti shkollor. Një kryetar i bashkësisë mund të ketë vetëm dy mandate: një në klasat e ulëta (klasa 1 - 5) dhe një në klasat e larta (klasa 6 - 9).

Kryetari dhe zëvendës-kryetari i bashkësisë së paraleles (të dy funksionet duhet t'i kryejnë nxënës të gjinisë së kundërt, njëri mashkull e tjetra femër, me çfarë çdo vit pasues do të nxitet ndërrimi i kësaj renditjeje).

Kriteret e zgjedhjes

Kriteret e zgjedhjes së kryetarit dhe zëvendës-kryetarit duhet t'i përcaktojnë vetë nxënësit, ndërsa arsimtari duhet me vëmendje t'i drejtojë nga disa vlera të caktuara, si p.sh.:

- ▶ aftësi të komunikimit;
- ▶ respekt për të tjerët (nuk bën dallim ndërmjet nxënësve, vepron njësoj me të gjithë, zotohet për nxënësit);
- ▶ respekt për nxënësit tjerë;
- ▶ sjellje/edukatë;
- ▶ përgjegjësi;
- ▶ gatishmëri që t'i përfaqësojë interesat e të tjerëve para arsimtarit dhe arsimtarëve të tjerë;
- ▶ interesim.

Trupat e përhershëm të bashkësisë së paraleles

(gjithmonë duhet të kihet kujdes për përfaqësim të duhur të anëtarëve meshkuj dhe femra dhe posaçërisht për dëshirat e fëmijëve). Është e para pëlqyeshme që fëmijët vetë të merren vesh për trupat e përhershëm (me udhëheqje të vëmendshme nga arsimtari).

Roli i tyre është të marrin pjesë në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve vijuese:

- ▶ festa dhe manifestime;
- ▶ ekskursionet;
- ▶ grumbullim fondesh dhe aktivitete të tjera humanitare;
- ▶ aktivitete ekologjike;
- ▶ sport;
- ▶ ngjarje/aktivitete të tjera.

Trupat e përkohshëm të bashkësisë së paraleles

(gjithmonë duhet të kihet kujdes për përfaqësim të duhur të anëtarëve meshkuj dhe femra dhe posaçërisht për dëshirat e fëmijëve), formohen sipas nevojës së problematikave të ndryshme (për shembull: mbajtja e uniformave, krijimi i tablosë, ndihma e nxënësit gjatë mësimin, zgjidhja e një problemi aktual, etj.).

2.1.2. Procedura për zgjedhje të kryetarit të bashkësisë së paraleles

Në bashkësinë e paraleles zgjidhet kryetari dhe zëvendës-kryetari. Zgjedhjet për kryetar të bashkësisë së paraleles mbahen në hapësirat në të cilat nxënësit e mbajnë orën e klasës, në një ditë të caktuar me plan programin vjetor të punës së shkollës.

Në orën e parë të klasës të vitit shkollor, kujdestari i klasës ka për detyrë që t'i informojë nxënësit për procedurën e zgjedhjes së kryetarit, zëvendës-kryetarit dhe trupave të tjera të përhershme dhe të përkohshme të bashkësisë dhe ta përpilojë listën e kriterëve së bashku me nxënësit.

Në orën e dytë të orës së klasës të vitit shkollor, paraqiten kandidatët të kujdestari i klasës.

Kandidatët duhet t'i kenë plotësuar dokumentet vijuese:

1. Formularin për regjistrim për zgjedhje të kryetarit të bashkësisë së paraleles (SHTOJCA 1);
2. Lista e nënshkrimeve për përkrahje (SHTOJCA 2);
3. Letër motivuese (SHTOJCA 3).

Në orën e tretë të klasës ose në një orë plotësuese

(orë që do të mbahej pas orëve të rregullta) realizohet procedura për zgjedhjen e kryetarit të bashkësisë së paraleles (zgjedhje të drejtpërdrejta). Zgjedhja realizohet në qoftë se janë të pranishëm 2/3 e numrit të përgjithshëm të nxënësve. Votimi është i fshehtë.

Për kryetar të zgjedhur konsiderohet kandidati që ka fituar numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i nxënësve të bashkësisë së njëjtë të paraleles. Në qoftë se më tepër kandidatë fitojnë numër të njëjtë, numër më të madh të votave, atëherë organizohet rrethi i dytë me kandidatët që kanë fituar numër të njëjtë më të madh të votave. Për kryetar të zgjedhur në rrethin tjetër konsiderohet kandidati që ka më tepër vota. Për zëvendës-kryetar zgjidhet kandidati pasues me numër më të madh votash, **i gjinisë së kundërt** nga kryetari. Në qoftë se nuk ekziston një kandidat i tillë, atëherë zgjidhet kandidati i radhës me numër më të madh votash.

Funksionet tjera në bashkësi përcaktohen në pajtueshmëri me nevojat, ndërsa përzgjedhja e tyre konstatohet me rregullore të posaçme të shkollës.

Materiali i nevojshëm:

1. marker (shkumës) dhe tabelë;
2. kuti me një çarje mbi kapakun;
3. fletëvotime (letër të formatit A4 e prerë në tetë pjesë, në të cilat shkruhen emrat e kandidatëve; përgatiten aq fletëvotime sa ka nxënës në klasë);
4. letër të formatit A4;
5. kriteret e shkruara për të cilat paraprakisht kanë rënë dakord nxënësit;
6. prezantim grafik i funksioneve dhe trupave të bashkësisë së paraleles të paraqitura në letër të formatit A3;
7. shirit ngjites.

Procedura për zgjedhje të kryetarit dhe zëvendës-kryetarit të bashkësisë së paraleles:

Kriteret, për të cilët paraprakisht kanë rënë dakord nxënësit, shkruhen në tabelë. Në murin e klasës ngjitet një letër e madhe grafike me funksionet dhe trupat e bashkësisë së paraleles.

Të drejtë për të dorëzuar fletëparaqitje për kryetar të bashkësisë së paraleles ka çdo nxënës i rregullt, në përputhje me mandatet në dispozicion, i/e cili/a ka përkrahje në formë të shkruar nga së paku 1/5 e numrit të përgjithshëm të nxënësve të paraleles së njëjtë (SHTOJCA 2). Paraprakisht, kujdestari i klasës i informon kandidatët e mundshëm se gjatë mbledhjes së nënsh-

krimeve duhet të prezantojnë cilësitë e tyre në bazë të kriterëve të përzgjedhjes që nxënësit tjerë të mund të vendosin se cilit kandidat që i posedon kriteret për kryetar t'ia japin nënshkrimin e tij/saj. Fletëparaqitja për kryetar i dorëzohet kujdestarit të klasës. Në fillim të orës së klasës, para se të fillohet me procedurën për zgjedhje të kryetarit të bashkësisë së paraleles, kujdestari i klasës i fton kandidatët e paraqitur. Kujdestari i klasës, nxënësve ua jep fletëparaqitjet e plotësuara nga kandidatët, listën e nënshkrimeve dhe letrat motivuese. Çdo kandidat për kryetar ka në dispozicion tre minuta që ta lexojë letrën motivuese dhe/ose të shtojë argumente të tjera sipas së cilave mendon që duhet të zgjidhet për kryetar. Çdo kandidat mund të intervistohet nga nxënësit (t'i parashtrajnë pyetje lidhur me detyrat që i ka si kryetar). Përderisa njëri nga kandidatët është në intervistë, kandidatët tjerë presin jashtë klasës (jo më gjatë se 10 minuta).

Pyetjet që mund t'iu parashtrohen kandidatëve për kryetar:

1. Pse u paraqite të jesh kryetar i klasës?
2. Cilat janë aftësitë tua?
3. Çfarë do të bëje për klasën?
4. Si do t'i përfaqësoje interesat e nxënësve?
5. Përshkruaj tre iniciativa që do t'i realizosh?
6. Në qoftë se nuk zgjidhesh për kryetar, a je i interesuar për një funksion tjetër në bashkësi? etj.

Pasi që të prezantohen kandidatët dhe të realizohet intervista, vazhdohet me procedurën e zgjedhjes së kryetarit:

- Sërish prezantohen kriteret e zgjedhjes së kryetarit/zëvendës-kryetarit të klasës dhe detyrat e tyre. Posenohet se ata duhet të jenë të gjinisë së kundërt (pas numërimit të votave, kandidati me numër më të madh votash, do të jetë kryetar, ndërsa tjetri pas tij/saj do të jetë zëvendës-kryetar, mirëpo i gjinisë së kundërt nga kryetari), (jo më tepër se 2 minuta).
- Zgjedhjet i organizon dhe realizon komisioni i përbërë nga tre nxënës që nuk janë kandidatë për kryetarë dhe zëvendës-kryetarë, si dhe kujdestari i klasës. Anëtarët e komisionit zgjidhen me votim publik të bashkësisë së nxënësve, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i nxënësve të pranishëm. Votimi zhvillohet për çdo kandidat të paraqitur veç e veç. Në qoftë se janë paraqitur vetëm tre nxënës për anëtarë të komisionit, atëherë nuk mbahen zgjedhje për anëtarë të komisionit (të përzier sipas gjinisë, dhe të mos jenë kandidatë për kryetar), (jo më tepër se 2 minuta).
- Komisioni i zgjedhjeve ulet në një pjesë të klasës, ndërsa kujdestari i klasës iu siguron një kuti të zbratur dhe fletëvotime të zbratura me çfarë ka përgjegjësi për realizimin e zgjedhjeve të drejta, demokratike dhe të fshehta.
- Komisioni i zgjedhjeve i jep nga një fletëvotim çdo nxënësi. Votimi realizohet duke e rrethuar numrin para emrit të kandidatit, të fletëvotimeve paraparakisht të përgatitura. Që të parandalohen parregullsi,

në çdo fletëvotim (në pjesën e pasme) nënshkruhen të gjithë anëtarët e komisionit (jo më tepër se 3 minuta).

- Nxënësit, një nga një, vijnë te komisioni i zgjedhjeve dhe marrin nga një fletëvotim; e rrethojnë në fshehtësi kandidatin e preferuar, e palosin fletëvotimin dhe e fusin në kuti. Pasi që të votojnë të gjithë nxënësit, votojnë edhe anëtarët e komisionit (marrin fletëvotime, një nga një, e rrethojnë kandidatin e preferuar dhe e vënë në kuti fletëvotimin), (jo më tepër se 10 minuta).
- Pasi që të gjithë të kenë votuar, komisioni i zgjedhjeve i numëron votat publikisht, vetëm të fletëvotimeve të vlefshme, përkatësisht nëse është rrethuar vetëm një kandidat. Në qoftë se askush nuk është rrethuar, nëse është rrethuar më tepër se një kandidat, nëse janë shtuar emra të kandidatëve, nëse fletëvotimi është shkarravitur, atëherë ai konsiderohet i pavlefshëm. Në qoftë se 51 % ose më tepër fletëvotime janë të pavlefshme – atëherë votimi nuk është i vlefshëm, (5 minuta).

Atë që ka fituar më tepër vota, komisioni i zgjedhjeve e shpall fitues për kryetar, ndërsa tjetrin me radhë sipas numrit të votave, por i gjinisë së kundërt, e shpall fitues për zëvendës-kryetar të bashkësisë së paraleles. Në qoftë se tjetri me radhë sipas numrit më të madh të votave nuk dëshiron të jetë zëvendës-kryetar, atëherë emërohet kandidati i radhës me numër më të madh të votave. Kujdestari i klasës i regjistron emrat e tyre në një listë, të cilën ia dërgon këshillit të arsimtarëve, shërbimeve profesionale dhe drejtorit të shkollës.

Mandej, në orën e njëjtë ose orën e ardhshme të klasës, në pajtim me kohën e mbetur, vazhdohet me konstituimin e trupave të përhershëm të bashkësisë, në bazë vullnetare dhe marrëveshje të ndërsjellë (së paku një mashkull dhe një femër në çdo trup, në qoftë se është e mundur. Nuk guxon të mbetet asnjë nxënës pa mos u përfshirë në ndonjë trup të përhershëm.

2.1.3. Shkarkimi i kryetarit të bashkësisë së paraleles

Kryetarit të bashkësisë së paraleles, mandati para skadimit të afatit i ndërpritet në rastet vijuese:

- nuk i kryen obligimet si kryetar;
- e kryen funksionin në mënyrë të pasuksesshmen;
- nuk merr pjesë në takime ose nuk thirr takime të bashkësisë së paraleles;
- çregjistrimi nga shkolla;
- mungesë më të gjatë në mësim;
- me kërkesë personale;
- me kërkesë të një grupi të nxënësve (së paku 2/3 e numrit të përgjithshëm të nxënësve të klasës) dhe me argumente të dorëzuara për moskryerjen e detyrave si kryetar i klasës;
- në qoftë se mungon në tre takime të njëpasnjëshme të parlamentit të nxënësve, përkatësisht në rast të

pamundësisë së tij/saj, në qoftë se mungon edhe zëvendësi i tij/saj.

Në situata të këtilla, kryetari ose zëvendës-kryetari do të pranojnë një paralajmërim nga kujdestari i klasës. Paralajmërimi do të jetë gojarisht dhe me shkrim; një kopje do t'i dorëzohet drejtorit, prindit dhe nxënësit (kryetar ose zëvendës-kryetar).

Në qoftë se ndodh ndërprerje e parakohshme e mandatit të kryetarit të bashkësisë së paraleles, atëherë bëhet zgjedhje e kryetarit të ri në afat prej 20 ditësh nga dita e ndërprerjes së mandatit, sipas procedurës së njëjtë. Me ndërprerjen e mandatit të kryetarit të bashkësisë, ndërpritet edhe mandati i zëvendësit të tij. Në qoftë se ndodh ndërprerje e parakohshme vetëm e zëvendës-kryetarit të bashkësisë së paraleles, atëherë kryetari i bashkësisë propozon një zëvendës tjetër, ndërsa atë, me vota të fshehta, e konfirmon bashkësia e paraleles me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

2.1.4. Funkcionimi i bashkësisë së paraleles

Punën e bashkësisë së paraleles e udhëheq kryetari i klasës. Kryetari:

- i përfaqëson nxënësit e bashkësisë së paraleles në parlamentin e nxënësve dhe para organeve të tjera të shkollës;
- i njofton nxënësit e bashkësisë së paraleles për çështjet që janë vendosur në parlamentin e nxënësve;
- organizon debate në klasë rreth problemeve dhe çështjeve konkrete (me vetiniciativë ose me iniciativë të nxënësve të tjerë), si që janë për shembull, probleme të caktuara në mësimdhënie, probleme me komunikimin e ndërsjellë, por edhe në komunikimin e nxënësve me arsimtarët, cilësinë e vlerësimit të nxënësve, cilësinë e mësimdhënies, probleme me një arsimtar të caktuar, etj.;
- merr pjesë në takimet prindërore me mundësi për t'i shpjeguar pikëpamjet e nxënësve rreth çështjeve për të cilat diskutohet;
- kujdeset për zgjidhje paqësore të kontesteve në klasë;
- bashkëpunon me kryetarët e bashkësive të tjera të paraleleve;
- bashkëpunon me komisionet e përhershme dhe të përkohshme;
- merr pjesë në punën e parlamentit të nxënësve;
- organizon formim të trupave të përkohshëm me vetiniciativë ose me iniciativë të së paku 5-së nxënësve të klasës.

Me qëllim funksionimin e suksesshëm të bashkësisë, kryetari i kryen detyrat vijuese:

- Javën e parë pas zgjedhjes së trupave të përhershëm, **kryetari thirr takim**.
- Në takimin e parë ata **përpilojnë planin e punës**, i

cili vlen për tërë vitin shkollor. Plani i punës përmban propozim-aktivitete në të cilat do të përfshihen të gjithë anëtarët e bashkësisë. Planin e përbëjnë aktivitete që do t'i realizojnë trupat e përhershëm, ndërsa me këtë do të sigurohet aktivizim më i madh i këtyre trupave.

- Kryetari ka për detyrë të thirr/konvokojë **së paku një takim në muaj** në të cilin do të shqyrtohen nevojat aktuale dhe problemet e nxënësve në klasë; do të diskutohet për mbarëvajtjen e aktiviteteve të *Planit të Punës* dhe do të pajtohen aktivitete të ardhshme në përputhje me nevojat e nxënësve.
- Në këto takime, në përputhje me nevojat, mund të merret edhe **vendim për formim të trupave të përkohshëm** për të cilat bashkësia e paraleles konsideron se janë të domosdoshme për t'u formuar.

2.2. PARLAMENTI I NXËNËSVE

Në bazë të nenit 68 (paragrafi 3 dhe 4) të Ligjit për Arsim Fillor, "për realizim të organizuar të interesave të nxënësve të arsimit fillor, nxënësit organizohen në bashkësi të paraleles dhe parlament të nxënësve. Parlamentin e nxënësve e përbëjnë kryetarët e bashkësive të paraleleve". Në bazë të kësaj, parlamenti i nxënësve është formë e organizimit të nxënësve në nivel të shkollës, ndërsa përbëhet nga kryetarët e bashkësive të paraleleve të një shkolle.

Parlamenti i nxënësve duhet të ketë një grafë të posaçëm në faqen e internetit të shkollës, e cila do të administrohet nga një nxënës i autorizuar nga parlamenti i nxënësve.

Në këtë faqe interneti do të shpallen njoftime, plani vjetor, raporte, përbërja e parlamentit, procesverbalet e takimeve të mbajtura, etj.

Seanca konstituive e parlamentit të nxënësve mbahet në javën e fundit të muajit shtator (përkatësisht menjëherë pas zgjedhjes së kryetarëve të bashkësive të paraleleve). Data e mbajtjes së seancës konstituive caktohet në plan programin vjetor të punës për shkollën. Në pajtim me Ligjin (neni 68, paragrafi 5), seancën konstituive të parlamentit të nxënësve e kryeson drejtori i shkollës.

2.2.1. Zgjedhja e kryetarit të parlamentit të nxënësve

Zgjedhja e kryetarit të parlamentit të nxënësve është pika e parë e rendit të ditës së seancës konstituive të parlamentit të nxënësve. Në seancën konstituive zgjidhet komisioni i tre anëtarëve (me propozim të vetë-iniciuar nga kryetarët e paraleleve të cilët nuk do të kandidohen për kryetar), i cili e realizon zgjedhjen e kryetarit të parlamentit të nxënësve. Çdo kryetar i bashkësisë së paraleles, para fillimit të debatit për pikën e parë, mund të kandidohet për kryetar të parlamentit të nxënësve duke dorëzuar fletëparaqitje deri te kryesuesi i seancës konstituive, përkatësisht deri te drejtori i shkollës. Kandidatët duhet vetë të prezantohen para anëtarëve të parlamentit dhe ta shprehin motivimin e tyre për kryetar

të parlamentit të nxënësve, si dhe t'i prezantojnë idetë e tyre për përfaqësimin e interesave të të gjithë nxënësve të shkollës. Procedura e zgjedhjes së kryetarit të parlamentit të nxënësve rekomandohet të jetë e njëjtë sikur edhe procedura e zgjedhjes së kryetarit të bashkësisë së paraleles. Mandati i kryetarit të parlamentit të nxënësve zgjat një vit shkollor.

Kryetari i parlamentit të nxënësve zgjidhet me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i përfaqësuesve të kryetarëve të paraleleve me anë të votimit të fshehtë (neni 68, paragrafi 7).

Votimi mund të mbahet vetëm nëse në seancë janë të pranishëm së paku 2/3 e numrit të përgjithshëm të kryetarëve të bashkësive të paraleleve.

Për kryetar të parlamentit të nxënësve konsiderohet kandidati që ka fituar numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote. Në qoftë se më tepër kandidatë kanë fituar numër të njëjtë të votave, atëherë organizohet rrethi i dytë me kandidatët që kanë fituar numër më të madh të votave. Për kryetar të zgjedhur në rrethin e dytë konsiderohet kandidati që ka fituar më tepër vota nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote.

Në qoftë se asnjëri prej kandidatëve nuk ka fituar shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, atëherë procedura e zgjedhjes së kryetarit të parlamentit të nxënësve përsëritet.

Pas zgjedhjes së kryetarit të parlamentit të nxënësve, kryetari e merr detyrën për të drejtuar seancën e parlamentit të nxënësve. Kryetari i parlamentit të nxënësve është anëtar i ekipit për integrim të shkollës (neni 46), të cilin e formon drejtori me qëllim avancimin e shumëkulturalizmit, ndër-kulturalizmit dhe integritimit ndëretnik në shkollë.

Për kryerjen e detyrës së tij, kryetarit të parlamentit të nxënësve i ndihmojnë zëvendës-kryetari dhe sekretari i parlamentit të nxënësve, të cilët zgjidhen nga radhët e koordinatorëve në vitin shkollor.

2.2.2 Ndërprerje e parakohshme e mandatit të kryetarit të parlamentit të nxënësve

Kryetarit të parlamentit të nxënësve, mandati para skadimit të afatit i ndërpritet në rastet vijuese:

- 1) nëse atë e kërkon vetë;
- 2) votojnë mosbesim 2/3 e kryetarëve të bashkësive të paraleleve;
- 3) i përfundon statusi i nxënësit të rregullt dhe
- 4) në raste të tjera të përcaktuara me këtë Udhëzues.

Në qoftë se ndodh ndërprerje e parakohshme e mandatit të kryetarit të parlamentit të nxënësve, atëherë bëhet zgjedhje e kryetarit të ri në afat prej 20 ditësh nga dita e ndërprerjes së mandatit.

2.2.3 Propozim-trupa të parlamentit të nxënësve

Koordinatorët e klasave²

Për koordinator të klasës mund të paraqitet çdo kryetar i paraleles nga e njëjta klasë. Zgjedhjen e koordinatorit të klasës e bëjnë kryetarët e paraleleve nga e njëjta klasë me votim të fshehtë.

Për koordinator zgjidhet kandidati që ka fituar numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i votave të kryetarëve të bashkësive të paraleleve nga klasat e njëjta. Në qoftë se më tepër kandidatë fitojnë numër të njëjtë votash, më të madh, atëherë organizohet rrethi i dytë me kandidatët që kanë fituar numër të njëjtë votash, numër më të madh. Për koordinator të zgjedhur në rrethin e dytë konsiderohet kandidati që ka fituar numrin më të madh të votave. Votimin e organizon dhe realizon komisioni për zgjedhje të kryetarit të parlamentit të nxënësve.

Trupi koordinues i parlamentit të nxënësve

Trupi koordinues i parlamentit të nxënësve përbëhet nga koordinatorët e klasave, dy përfaqësues – arsimtarë të emëruar nga drejtori i shkollës nga ekipi për përkrahje të pjesëmarrjes së nxënësve (pa të drejtë vote) dhe sekretari i parlamentit të nxënësve.

Trupi koordinues i parlamentit të nxënësve bën përpilimin e propozim-programit të punës së parlamentit të nxënësve dhe i përgatit materialet për seancat e parlamentit të nxënësve.

2.2.4 Kompetencat e parlamentit të nxënësve

Parlamenti i nxënësve punon në seanca, të cilat mbahen së paku një herë në muaj, përveç muajve kur nxënësit janë në pushim vjetor. Gjatë muajve kur nxënësit janë në pushim vjetor, seancë mund të mbahet me kërkesa të së

² Në bazë të nenit 53 të Ligjit, „Klasa është një tërësi edukativo-arsimore në të cilën realizohen programet mësimore sipas planit mësimor për një vit shkollor. Nxënësit e një klase të njëjtë janë të ndarë në paralele”.

paku gjysmës së numrit të përgjithshëm të kryetarëve të bashkësive të paraleleve.

Seancat i konvokon kryetari i parlamentit të nxënësve në formë të shkruar. Kryetari i parlamentit të nxënësve ka për detyrë që menjëherë, ndërsa në afat prej dy ditëve, të konvokojë seancë të parlamentit të nxënësve, në qoftë se atë e kërkon së paku gjysma e numrit të përgjithshëm të kryetarëve të bashkësive të paraleleve ose drejtori i shkollës. Parlamenti i nxënësve mund të mbaj seancë dhe të merr vendime në qoftë se janë të pranishëm së paku gjysma plus një anëtar i numrit të përgjithshëm të kryetarëve të bashkësive të paraleleve.

Në seancat e parlamentit të nxënësve, pa të drejtë vote, mund të merr pjesë çdo nxënës dhe përfaqësues i kuadrit shkollor (drejtori i shkollës, pedagogu i shkollës, defektologu, psikologu dhe bashkëpunëtorë të tjerë profesional), si dhe përfaqësues të prindërve nga këshilli prindëror me pëlqim paraprak të kryetarit të parlamentit të nxënësve.

Seancat e parlamentit të nxënësve mbahen në hapësira të përshtatshme të përcaktuara nga drejtori i shkollës ose në hapësirat ku mbahen seancat e trupave dhe organeve profesionale të shkollës. Parlamenti i nxënësve mund të merr vendim për të mbajtur seancë edhe në një vend tjetër.

Në lidhje me rolin dhe kompetencat sipas nenit 68, paragrafi 6 të Ligjit, parlamenti i nxënësve:

- 1) merr pjesë aktive në përfaqësimin dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të nxënësve,
- 2) e promovon aktivizimin e nxënësve,
- 3) merr pjesë në aktivitete për sigurimin e përkrahjes së bashkëmohatarëve që kanë nevoja të posaçme arsimore, në realizimin e mësimin dhe aktiviteteve jashtë-mësimore,
- 4) merr pjesë në përgatitjen e programit vjetor të punës,
- 5) jep propozim-aktivitete për ekskursionet që duhet të futen në programet vjetore,
- 6) jep propozime për aktivitete jashtë mësimorë të shkollës,
- 7) jep propozime për përmirësimin e standardit të nxënësve,
- 8) merr pjesë në vlerësimin e punës së shkollës,
- 9) nëpërmjet përfaqësuesve të vet, merr pjesë në këshillin prindëror dhe këshillin e arsimtarëve dhe
- 10) organizon dhe merr pjesë në aktivitete humanitare, aktivitete ekologjike dhe punë të dobishme shoqërore.

Më tutje, parlamenti i nxënësve, gjithashtu:

- 1) e miraton rregulloren e punës së bashkësisë së paraleleve dhe parlamentit të nxënësve, programin vjetor të punës dhe akte tjera të përpiluara nga trupi koordinues i parlamentit të nxënësve;
- 2) merr pjesë aktive në procesin e planifikimit të zhvillimit të shkollës;
- 3) e promovon aktivizimin e nxënësve nëpërmjet përmbytjeve edukative, tryezave të rrumbullakëta, diskutimeve, debateve, hulumtimeve, aktiviteteve humanitare dhe ekologjike, manifestimeve kulturore dhe sportive;
- 4) i dorëzon organeve shkollore iniciativa për përmirësimin e qasjes dhe cilësisë së arsimit në institucionin shkollor;
- 5) bashkëpunon me institucionet dhe organizatat tjera që punojnë me të rinj;
- 6) promovon llogaridhënie dhe transparencë para të gjithë nxënësve nëpërmjet informimit publik rreth aktiviteteve të veta.

Në bazë të nenit 106 paragrafi 3 të Ligjit, “në seancat e këshillit shkollor ftohen dhe marrin pjesë, pa të drejtë vote, edhe dy përfaqësues të nxënësve të caktuar nga parlamenti i nxënësve”. Sipas kësaj, pas themelimit, parlamenti i nxënësve emëron, përkatësisht zgjedh dy persona (një mashkull dhe një femër) nga përbërja e vet për të marr pjesë në këshillin shkollor, duke pasur kujdes përfaqësimin etnik. Përfaqësuesit e parlamentit të nxënësve në këshillin shkollor, si dhe të gjithë trupat tjera të shkollës, kanë të drejtë fjale dhe ta shprehin mendimin dhe qëndrimin e tyre, të diskutojnë për probleme dhe të propozojnë zgjidhje në drejtim të përmirësimit të jetës së përgjithshme të shkollës.

2.3 THEMELIMI I OMBUDSMANIT TË NXËNËSVE

Në bazë të nenit 68, paragrafi 8, Ligji për Arsim Fillor përfshin edhe ombudsman të nxënësve, roli i të cilit është “të kujdeset për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të nxënësve në shkollë”. Ombudsmani i nxënësve është një funksion dhe detyrë për nxënësit, i cili paraqet një model të ri të pjesëmarrjes së nxënësve dhe është shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shkollë. Që të sigurohet përfshirje më e madhe në klasa të ndryshme, rekomandohet që përveç ombudsmanit të nxënësve të zgjidhen edhe (së paku) dy zëvendës të tij/saj.

Funksioni dhe roli i ombudsmanit të nxënësve dhe zëvendësve të tij do të përbëhet nga dy komponenti parësore:

1. Promovimi i të drejtave të fëmijëve.

Detyra e ombudsmanit të nxënësve për promovimin e të drejtave të fëmijëve fillimisht do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve promovuese (**punëtori edukative, debate, ditë informative, etj.**). Informacionet rreth përmbajtjes së punëtorive duhet të sigurohen nga shërbimi profesio-

onal i shkollës (ose ekipi për përkrahje), i cili duhet të jetë partner i ombudsmanit të nxënësve. Gjithashtu, nxënësit ombudsmanë dhe zëvendësit do të mund të organizojnë ngjarje informuese nëpërmjet të cilave do t'i promovojnë të drejtat e fëmijëve. Ombudsmani i nxënësve përpilon raporte (gjysmë vjetorë dhe vjetore) në të cilat i përmbledh ankesat e parashtruara dhe gjendjen me shkeljen e të drejtave të nxënësve në shkollë.

2. Përkrahje për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Detyra e dytë e ombudsmanit të nxënësve dhe zëvendësve të tij është të sigurojë përkrahje për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe informim të nxënësve të shkollës. Ombudsmani i nxënësve identifikon shkelje të të drejtave të fëmijëve dhe grumbullon ankesa nga nxënësit, të cilat më tutje ia dorëzon shërbimit profesional për zgjidhje të mëtutjeshme. Ombudsmani i nxënësve i përgatit dhe ia dorëzon parashtrësarë të nxënësve, lidhur me shkeljen e të drejtave të tyre nga arsimtari ose kuadri joarsimor, drejtorit dhe këshillit të shkollës. Në suaza të kësaj detyrë është edhe grumbullimi i të dhënave nga të gjitha organet dhe trupat e parlamentit të nxënësve dhe shërbimit profesional të shkollës, duke e fituar rolin e një vëzhguesi të përhershëm. Nxënësit ombudsmanë mbajnë takime të rregullta me shërbimin profesional të shkollës. Ombudsmani i nxënësve mund të merr pjesë në punën e parlamentit të nxënësve dhe trupave të tjerë të shkollës në të cilat diskutohen probleme me shkelje të mundshme të të drejtave të nxënësve.

2.3.1 Procedura për zgjedhje të ombudsmanit të nxënësve

Në bazë të Ligjit, ombudsmani i nxënësve zgjidhet me shumicë votash të nxënësve nga klasat e shtata deri të nënta, me anë të votimit të fshehtë. Vijon përkrahja e hapave vijuese për zgjedhjen e ombudsmanit të nxënësve dhe zëvendësve të tij/saj, të cilat rekomandohet që t'i bëjë çdo shkollë, me mundësi për aktivitete plotësuese në bazë të nevojave konkrete në nivel lokal.

Hapi 1

Drejtori i informon të gjithë arsimtarët e shkollës, gjatë takimit të parë (më së mirë kjo të bëhet në seancën e këshillit të arsimtarëve), për tërë procesin e zgjedhjes dhe grumbullimit, për përfshirjen e tyre aktive, si dhe për përkrahjen e tyre të plotë.

Hapi 2

Shërbimi profesional (pedagogjik-psikologjik) në shkollën fillore përgatit një thirrje publike për zgjedhjen e ombudsmanit të nxënësve dhe zëvendësve të tij (Shtojca 4, 5, 6). Thirrja shpallet në **tabelën e shpalljeve** dhe në **faqen e internetit të shkollës, ndërsa respektohen hapat e radhës:**

- Thirrja ka të bëjë me nxënësit që mësojnë në shkollën ku bëhet shpallja e thirrjes.
- Thirrja për ombudsmanin e nxënësve dhe zëvendësve të tij shpallet në fillim të muajit tetor, çdo vit të dytë shkollor.

- Kandidatë për ombudsman të nxënësve dhe zëvendës të tij mund të jenë vetëm nxënësit e klasave të 7-ta, 8-ta dhe 9-ta. Në thirrje qartësisht përshkruhet pozita dhe obligimet e funksionit të ombudsmanit të nxënësve dhe zëvendësve të tij, duke i theksuar kushtet e sipërpërmenduar të paraqitjes (mosha).
- Me thirrjen bashkëngjitet edhe fletëparaqitja, e cila është në përputhje me moshën e nxënësve. Dokumentacionin duhet ta sigurojë shërbimi profesional i shkollës.
- Në thirrje theksohet afati i fundit i dorëzimit të fletëparaqitjeve.
- Në thirrje përcaktohet kujt dhe ku dorëzohen fletëparaqitjet e nxënësve.
- Në thirrje shpjegohet procesi i përzgjedhjes: kush do të përfshihet në procesin e përzgjedhjes, kur dhe ku do të bëhet përzgjedhja përfundimtare dhe kur do të shpallen rezultatet.
- Në thirrje shpjegohet edhe procesi i trajnimit fillestar të nxënësve të zgjedhur, të cilën do ta realizojnë shërbimet profesionale të shkollës, në bazë të moduleve të trajnimit që janë të disponueshme në shtojcën e këtij dokumenti.

Hapi 3

Më së voni, një javë para skadimit të afatit të fundit të paraqitjes, kujdestarët e klasës/paraleleve kanë përdetyrë që ta përhapin dhe t'ua shpjegojnë thirrjen nxënësve të tyre dhe t'iu përgjigjen të gjitha pyetjeve të tyre. Kjo e nënkupton nevojën e përgatitjes paraprake të të gjithë kujdestarëve të klasave, përkatësisht të paraleleve (të klasave përkatëse), të cilën do ta realizojë shërbimi profesional.

Hapi 4

Gjatë thirrjes së hapur (para skadimit të afatit të fundit) për paraqitje, formohet një komision për zgjedhje të ombudsmanit të nxënësve, i cili përbëhet nga: **pedagogu, psikologu dhe 3 persona të emëruar nga parlamenti i nxënësve** (numri i anëtarëve të komisionit është tek). Detyra e këtij komisioni është t'i shqyrtojë fletëparaqitjet e dorëzuara për ombudsman të nxënësve dhe të organizojë zgjedhje për ombudsmanin e nxënësve. Fletëparaqitjet duhet të përmbajnë të dhëna themelore, letër motivuese për funksionin e ombudsmanit të nxënësve (ose zëvendësit) dhe ide për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shkollë. Mandati i komisionit zgjat dy vite (deri në zgjedhjet e ardhshme të ombudsmanit të nxënësve).

Hapi 5

Komisioni i zgjedhjes së ombudsmanit të nxënësve e përcakton datën e zgjedhjeve dhe e shpall publikisht në tabelën e shpalljeve të shkollës. Në tabelën e shpalljeve, së bashku me informacionet për zgjedhjet, shpallen edhe fletëparaqitjet e kandidatëve për ombudsman të nxënësve dhe zëvendës të tij që të njoftohen nxënësit me idetë dhe pikëpamjet e tyre. Për nevojat e zgjedhjeve, komisioni do të shtyp fletëvotime me emrat e kandidatëve për ombudsman të nxënësve dhe zëvendës. Duke simuluar një proces të vërtetë të zgjedhjeve, do të rrethojë numrin rendor në mënyrë të fshehtë dhe do ta fus atë në kutinë e zgjedhjeve.

Hapi 6

Pas mbarimit të votimit, komisioni i numëron publikisht votat. Për ombudsman të zgjedhur të nxënësve konsiderohet ai që ka fituar më së shumti vota nga nxënësit e klasave të 7-ta, 8-ta dhe 9-ta. Ombudsmanët e zgjedhur nënshkruajnë deklaratë përgjegjësie gjatë realizimit të aktiviteteve në kohën e mandatit të tyre (Shtojca 7 dhe 8).

2.3.2 Mandati i ombudsmanit të nxënësve

Për shkak të konsistencës dhe qëndrueshmërisë së modelit, rekomandohet që mandati i ombudsmanit të nxënësve dhe zëvendësve të tij të jetë **2 vite** (përveç kur ombudsmani i nxënësve zgjidhet nga klasat e nënta, atëherë mandati është një vit). Pas mbarimit të mandatit, shpallet thirrje e re. Thirrjes mund t'i përgjigjen edhe zëvendës ombudsmanët të përfshirë në mandatin paraprak. Pas mbarimit të mandatit, shkolla i akordon një **certifikatë ombudsmanit të nxënësve** për kohën e kaluar si ombudsman.

Në qoftë se gjatë kohës së mandatit, ombudsmani i nxënësve nuk ka mundësi të vazhdojë me aktivitetet për shkak të arsyeve të ndryshme, atëherë komisioni i zgjedhjeve të ombudsmanit të nxënësve (ose drejtori) e emëron njërin nga zëvendësit deri në përfundimin e mandatit të rregullt. Në qoftë se edhe zëvendës-ombudsmanët nuk janë në gjendje të vazhdojnë me detyrat e tyre, atëherë komisioni merr vendim për të shpallur zgjedhje (të parakohshme) për ombudsman të nxënësve.

2.3.3 Procedura për dorëzim të parashtrësve dhe komunikim me personelin e shkollës

Ankesë/parashtrësë (Shtojca 9) mund të dorëzojë çdo nxënës i shkollës, në qoftë se mendon se është shkelur një e drejtë e tij. Formulari i parashtrësve duhet të jetë i qasshëm në faqen e internetit të shkollës dhe te ombudsmani i nxënësve. Parashtrësja e plotësuar i dorëzohet ombudsmanit të nxënësve ose njërit prej zëvendësve të tij. Dorëzimi mund të bëhet në mënyrë elektronike ose personalisht. Ombudsmani i nxënësve ka adresë të posazme elektronike (e-mail), të cilën do ia sigurojë shkolla. Adresa elektronike është theksuar në faqen e internetit të shkollës, si dhe është vënë në vend të dukshëm në tabelën e shpalljeve të shkollës. Në qoftë se ai/ajo që denoncon shkelje të një të drejte dëshiron të kontaktojë personalisht me ombudsmanin e nxënësve, atëherë ai/ajo mund të realizojë takim të drejtpërdrejtë me atë. Pas takimit, nxirret përfundim nëse duhet të plotësohet parashtrësja dhe të dorëzohet zyrtarisht.

Parashtrësja mund të **nënshkruhet** dhe të përmbajë të dhëna personale të parashtruesit (**individuale**), të përmbajë rrethanat, faktet dhe provat mbi të cilat bazohet parashtrësja, ose parashtrësja mund të jetë edhe **anonime**. Gjithashtu, parashtrësja mund të jetë **grupore** (nga më tepër nxënës ose tërë klasa ose paralelja).

Parashtrësja anonime mund të dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike, mirëpo duhet t'i përmbajë të gjitha faktet mbi të cilat bazohet shkelja e të drejtave të nxënësve.

Pasi që nxënësit ta dorëzojnë parashtrësën në mënyrë adekuate, ombudsmani i nxënësve përcakton nëse parashtrësja është e përshtatshme. Ombudsmani i nxënësve, në konsultim me zëvendësit e tij, përcakton nëse parashtrësja paraqet shkelje të një të drejte të fëmijëve ose nuk është e përshtatshme për shqyrtim të mëtutjeshëm. Ombudsmani i nxënësve, në çdo kohë, mund të kërkojë ndihmë dhe të këshillohet me arsimtarin, përfaqësuesin e shërbimeve profesionale ose një ekspert të jashtëm (përfaqësues të një organizate joqeveritare, avokat, Avokatin e Popullit, etj.).

Pas dorëzimit të parashtrësës në mënyrë të rregullt, në qoftë se ajo është e nënshkruar, përkatësisht nëse nuk është anonime, ombudsmani i nxënësve ose zëvendësit e tij përpiqen të caktojnë takim me personin që e ka dorëzuar parashtrësën, në kohë dhe vend të duhur. Nga ai takim, ombudsmani i nxënësve ose zëvendësit e tij, përpilojnë një procesverbal të shkurtër me elementet më të rëndësishme dhe e vazhdojnë komunikimin me shërbimet profesionale. Në qoftë se parashtrësja është e karakterit më serioz dhe nuk mund të zgjidhet në suaza të kompetencave të shërbimit profesional dhe drejtorit të shkollës, atëherë ombudsmani i nxënësve së bashku me shërbimet profesionale vendosin kontakt me zëvendës Avokatin e Popullit, i cili është i ngarkuar për të drejtat e fëmijëve, që ta njoftojë me rastin, si dhe që të merren vesh si të vazhdojnë më tej. Pas rënies dakord për hapat e radhës, parashtrësja së bashku me procesverbalin, i dorëzohet shërbimit profesional të shkollës. Më tutje, ombudsmani i nxënësve diskuton për parashtrësën dhe procesverbalin e takimit (nëse ka) me shërbimin profesional. Në qoftë se shërbimi profesional nuk gjen zgjidhje për parashtrësën në fjalë, atëherë ajo i dorëzohet Avokatit të Popullit, i cili në qoftë se konstaton shkelje serioze të të drejtave të fëmijëve, do të veprojë në përputhje me kompetencat e tij. Ombudsmani i nxënësve së bashku me ekipin për përkrahje (shërbimin profesional) mban evidencë të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve – Shtojca 10.

2.4 UDHËZIME DHE DOKUMENTE THEMELORE TË NEVOJSHME PËR PLANIFIKIM DHE REALIZIM TË SUKSESSHËM TË AKTIVITETEVE TË NXËNËSVE

2.4.1 Plani vjetor i punës (Plan veprimi për aktivitete)

Çdo bashkësi paraleleje, parlament të nxënësve, si dhe çdo formë tjetër e organizimit të nxënësve në shkollë, për shkak të organizimit më të mirë të punës dhe për shkak të evidentimit më të mirë të aktiviteteve, duhet të përpilojë plan vjetor pune, duke përfshirë edhe planin e veprimit. Ky plan mundëson organizim dhe realizim më të lehtë dhe më efikas të të gjitha aktiviteteve. Plani i veprimit më së miri të përpilohet në fillim të çdo viti shkollor dhe të ketë lidhje me aktivitetet gjatë vitit shkollor. Është shumë e rëndësishme që të gjithë anëtarët e një ekipi të caktuar të marrin pjesë në përpilimin e planit vjetor, pasi që kjo mundëson të merren parasysh idetë e të gjithëve dhe ato të bashkohen në një plan të vetëm. Kështu, të gjithë anëtarët do të ndjehen më mirë për shkak të pjesëmarrjes së tyre dhe do të angazhohen më shumë për realizimin e aktiviteteve të planit. Përpilimi i planit vjetor të punës nuk guxon të jetë tepër formal dhe nuk është e nevojshme që plani të ketë formë juridike. Është e rëndësishme që të marrin pjesë sa më shumë nxënës që është e mundur në përpilimin e tij, të përmbajë aktivitete konkrete dhe realisht të realizueshme në të cilat do të përfshihen të gjithë nxënësit, si dhe të ketë strukturë të qartë nëpërmjet të cilës do të mund të monitorohet realizimi i tij. Ky plan mund të ngjitet edhe në një vend të dukshëm në klasë/shkollë dhe të përgatiten grafikë në ngjyra nga të cilat mund të shikohet progresi i bërë në realizimin e aktiviteteve të hartuara.

Që të përgatitet një plan vjetor i suksesshëm duhet të:

- përcaktohen të gjitha aktivitetet që mund të realizohen gjatë një viti dhe të kontribuojnë në arritjen e objektivave të punës,
- përcaktohet afat kohor për realizimin e çdo aktiviteti,
- identifikohen bartësit e çdo aktiviteti ose ata që do të kujdesen për realizimin e aktiviteteve sipas planit,
- përcaktohet numri i nxënësve për çdo aktivitet (fushëveprimi i nxënësve),
- ofrohen mënyra me të cilat do të sigurohet përfshirje e të gjithë nxënësve pa diskriminim në bazë të gjinisë ose aftësive të kufizuara,
- të identifikohen nevojat për burime materiale ose njerëzore për çdo aktivitet,
- të parashikohen bashkëpunëtorë (të brendshëm dhe të jashtëm) të cilët mund të ndihmojnë në realizimin e planit,
- plani vjetor i aktiviteteve prezantohet në mënyrë grafike nëpërmjet tabelave që të fitohet pasqyrë e qartë e aktiviteteve gjatë vitit shkollor,
- plani i veprimit është pjesë përbërëse e programit vjetor të shkollës.

2.4.2 Mbledhjet e trupave të bashkësisë së nxënësve (parlamenti i nxënësve, bashkësia e paraleles, ombudsmani i nxënësve, trupa tjerë të përhershëm dhe të përkohshëm me pjesëmarrje aktive të nxënësve)

Trupat duhet të mbajnë takime në periudhë të caktuar kohore (paraprakisht të caktuar) dhe gjithmonë kur të lind nevoja për atë. Takimet periodike të trupave mundësojnë që ato të funksionojnë në mënyrë të vazhdueshme. Nëpërmjet këtyre takimeve, trupi i caktuar i shqyrton të gjitha çështjet që kanë rëndësi për nxënësit, ndërsa njëkohësisht ushtrohet edhe demokracia në shkollë. Prandaj, është shumë e rëndësishme që takimet e trupave të jenë të mire përgatitura dhe mirë organizuara sepse nëpërmjet këtyre takimeve mësohen edhe shkathtësi që janë të domosdoshme për demokracinë, ndërsa ato janë:

- ndërmarrja e përgjegjësisë,
- shprehja e mendimeve për çështje që i shqetësojnë anëtarët dhe që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi ata,
- sjellja praktike në grup, e cila bazohet në parimet dhe vlerat demokratike,
- respektimi i të drejtave të të tjerëve,
- komunikimi në mënyrë demokratike,
- pranimi i vendimeve në mënyrë demokratike,
- zhvillimi i kulturës demokratike në shkollë.

Gjithashtu, nëpërmjet punës së këtyre takimeve përvetësohen edhe shkathtësi shoqërore, si që janë:

- të dëgjohen të tjerët,
- të zhvillohet kujdesi për të tjerët,
- të jemi të ndjeshëm ndaj të tjerëve,
- të shprehen nevojat dhe ndjenjat e veta,
- të shprehen qëndrimet e veta,
- të dihen dhe të respektohen rregullat dhe marrëveshjet,
- të tejkalohen kundërthëniet dhe vështirësitë,
- të lëvdohen të tjerët,
- të shprehet kritikë konstruktive,
- të zgjidhen konfliktet pa dhunë,
- të bisedohet rreth problemeve dhe të gjenden zgjidhje.

Që të mund të arrijnë qëllimin e vet këto takime, duhet të dihet paraprakisht procedura e mbajtjes së takimeve dhe paraprakisht të caktohen rregullat e sjelljes (për të cilat kanë rënë dakord nxënësit), të cilat do të ngjiten në një vend të dukshëm.

Në suaza të këtij dokumenti janë dhënë disa shembuj të dokumenteve të cilat konsiderohen të domosdoshme për punën e suksesshme të parlamentit të nxënësve (Shtojca 11, 12, 13, 14).

2.4.3 Roli i nxënësve në mbledhjet e trupit

Në përgjithësi, rolet e mëposhtme duhet të realizohen nga nxënësit në trupin përkatës:

- kryetari/koordinatori – e drejton takimin dhe kujdeset për realizimin e rendit të ditës (agjendës) së mbledhjes;
- proceverbalisti – mban evidencë për rezultatet dhe vendet ku organizohen takimet duke i shënuar ato në procesverbal; e arkivon procesverbalin në skedarin përkatës;
- organizatori – grumbullon propozime për diskutim; e përgatit sallën e takimit; i përgatit materialet e punës; i përgatit burimet teknike, në qoftë se është e nevojshme, etj.

Duhet të caktohen sa më tepër role (detyra), të cilat konsiderohen se janë të rëndësishme për çdo takim të veçantë, gjë që do të mundësojë angazhim dhe dhënie rëndësi të çdo nxënësi. Për shembull: grumbullimi i dokumenteve të nevojshme dhe të dhënave për një pikë të rendit të ditës, komunikimi me arsimtarët, shërbimin profesional, komunikimi me ombudsmanin e nxënësve, etj.

Detyrat duhet t'i kryejnë gjithmonë nxënës të ndryshëm. Nxënësit duhet të jenë të mirinformuar për detyrat, çfarë pritet prej tyre dhe çfarë kanë në dispozicion që të mund të përgatiten më mirë dhe t'i kryejnë detyrat me sukses. Çdo nxënës mund të kërkojë ndihmë edhe nga nxënësit tjerë për realizimin e detyrës së dhënë. Duhet të inkurajohet kërkimi i ndihmës dhe shfrytëzimi i njohurive tashmë të fituara të tjerëve.

Para mbledhjes, ekipi duhet të mbajë takim përgatitor në të cilin duhet patjetër të marrin pjesë të gjithë anëtarët që kanë një rol të caktuar për takimin e radhës.

2.5 UDHËZIME KONKRETE PËR OBLIGIMET DHE AKTIVITETET E ARSIMTARËVE DHE SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Udhëzuesi ofron burime për trajnime dhe aktivitete dedikuara arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe nxënësve të shkollave. Burimet përqendrohen në njohjen e thelbit të të drejtave të fëmijëve, mirëpo gjithashtu, me zbatimin e tyre, duke i njohur të drejtat e veta demokratike, duhet të jenë të përgatitur dhe të ndërmarrin iniciativa për të vepruar në mënyrë të vazhdueshme në shoqërinë civile.

Roli i arsimtarëve është shumë i rëndësishëm në procesin e njohjes dhe forcimit të kapaciteteve demokratike të nxënësve. Ata duhet të jenë përkrahje e vazhdueshme e nxënësve dhe t'i udhëheqin nëpër tërë procesin e njohjes demokratike në mënyrë të paimponueshme.

Ideja themelore është se parlamenti i nxënësve dhe trupat e tij duhet të jenë të organizuar dhe mbështetur nga vetë nxënësit. Qëllimi i **ekipit për përkrahje** është të mundësojë të trajtohen dhe hapen çështje dhe problematika në mënyrë sa më të strukturuar dhe demokratike. Kështu, përveç të ushtruarit të demokracisë, nxënësit do të mësojnë edhe si të veprojnë. Për çdo rast, është e nevojshme ndihma e arsimtarëve që në mënyrë të drejtë të zhvillohet puna e trupave të parlamentit të nxënësve, kryesisht nga ato arsimtarë që kanë përvojë dhe që tregojnë gatishmëri për të ndihmuar.

Në bazë të kësaj, arsimtari i cili **drejtëpërdrejtë merr pjesë** në punën e parlamentit të nxënësve:

- duhet t'i respektojë rregullat e njëjta sikur edhe nxënësit – anëtarë të trupave (për shembull, leje për të marr fjalë, respektim të kohës së fjalimit, etj.);
- nuk guxon ta uzurpojë kohën, madje as të imponojë mendime dhe qëndrime të veta;
- duhet të jep mendime të veta sa më pak që është e mundur;
- nuk duhet haptazi të përkrah ose t'i kundërvihet një ideje të caktuar;
- duhet të reagojë në rast të shkeljes së rregullave (duke u thirrur në ato rregulla).

Në qoftë se arsimtari është si **vëzhgues ose këshilltar**:

- punon si mentor dhe siguron përkrahje;
- së bashku me nxënësit zhvillon rregulla komunikimi për takimet;
- së bashku me nxënësit përgatit formatin e procesverbalit, formatin e propozim diskutimeve, etj.;
- së bashku me nxënësit i përcakton dhe përshkruan detyrat dhe funksionet e anëtarëve;
- përgatiti materiale për takime; përballet me probleme;
- vepron duke qenë si shembull dhe në qoftë se është e nevojshme tregon se si duhet të kryhen punët (për shembull, si të hapet një seancë, si të organizohet marrja e vendimeve për çështje konkrete, etj.);
- reagon kur nxënësit ta kërkojnë reagimin e tij ose kur është prishur procesi.

Në procesin e formimit të **parlamentit të nxënësve**, arsimtarët, përkatësisht **ekipi për përkrahje, së bashku me parlamentin e nxënësve** duhet të realizojnë punëtori për njohjen e nxënësve me të drejtat e tyre, si dhe me pjesëmarrjen e vërtetë dhe autentike të nxënësve në jetën e përditshme demokratike në shkollë. Në këtë paketë janë dhënë shembuj të punëtorive për të mësuar të drejtat e fëmijëve, për të ndërmarr aktivitete me nxënësit, për të organizuar ngjarje, etj. (Modulet e punëtorive gjenden në shtojcën e këtij Udhëzuesi: Burimet për trajnime dhe punëtori dedikuara nxënësve – një pjesë e moduleve janë marr nga doracakët arsimorë për shkathtësi të jetës). Në fillim të vitit shkollor, rekomandohet që anëtarët e **ekipit për përkrahje** të hartojnë një plan veprimi për pjesëmarrjen dhe organizimin

e nxënësve që të njoftohen nxënësit me procesin.

Duke pasur parasysh se për organizimin dhe pjesëmarrjen në proceset demokratike të shkollës është e nevojshme që nxënësit të fitojnë edhe shkathtësi të komunikimit, si dhe të njoftohen me procedurat e vendimmarrjes demokratike në shkollë, në këtë Udhëzues janë të përfshirë edhe përmbajtje dhe trajnime plotësuese, të cilat arsimtarët mund t'i realizojnë gjatë vitit shkollor, ndërsa ato janë: "Shkathtësi të komunikimit, leadership dhe punë në ekip", "Debati në arsim", "Hulumtimi – si të krijoni një pyetësor", "Organizimi i takimeve" dhe "Punëtorja për arsim ndërkulturor".

Njëkohësisht, arsimtarët që bëjnë pjesë në ekipin për përkrahje marrin pjesë në takime dhe sigurojnë përkrahje logjistike për funksionimin e formave të organizimit të nxënësve (bashkësia e paraleles, parlamenti i nxënësve, trupa të tjerë të përkohshëm dhe të përhershëm të organizimit të nxënësve). Ata duhet t'iu ndihmojnë nxënësve gjatë mbajtjes së arkivit të aktiviteteve (portofolin, agjendat, listat e pjesëmarrësve, ra-

portet për ngjarjet, fotografitë, videot, etj.). Arsimtarët që janë pjesë e ekipit për përkrahje mbajnë një portofol, përkatësisht dokumentacion të aktiviteteve të parlamentit të nxënësve dhe ombudsmanëve të nxënësve.

Më tutje, arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesional kanë për obligim të mbajnë takime të rregullta me ombudsmanin e nxënësve me qëllim bashkërendimin dhe shkëmbimin e informacioneve, si dhe planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta. **Shërbimet profesionale mbajnë evidencë për shkeljet dhe procesverbalet e takimeve nga aktivitetet e ombudsmanit të nxënësve.**

Arsimtarët duhet t'iu ndihmojnë ombudsmanëve të nxënësve në kryerjen e detyrave të tyre duke siguruar përkrahje gjatë organizimit të punëtorive me nxënësit në temën e të drejtave të fëmijëve, organizimin e ngjarjeve promovuese (ditëve informative), përpunimin e parashtrësave lidhur me shkelje të një të drejte të caktuar, etj.

3.

BURIMET PËR PËRKRAHJE TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE NË SHKOLLË

3.1. KOMUNIKIMI, LIDERSHIPI DHE PUNA NË EKIP

3.1.1. Komunikimi – hyrje

Komunikimi ka luajtur një ndër rolet më kryesore për zhvillimin e aftësive të njeriut, si një ndër parakushtet kryesore për zhvillimin e tij. Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit paraqesin bazën e çdo pune, veçanërisht kur bëhet fjalë për njerëz të cilët nëpërmjet aktiviteteve të tyre realizojnë projekte, të cilat duhet të jenë në funksion të zhvillimit të shoqërisë.

Mirëpo, si komunikojmë ne? Çfarë lloje të komunikimit ekzistojnë? Dhe më e rëndësishmja, si mund ta zhvillojmë dhe përmirësojmë komunikimin tonë gjatë aktiviteteve tona të përditshme, ndërsa njëkohësisht t'i shmangim dhe të jemi të vetëdijshëm për lloj-lloj pengesash që e pengojnë komunikimin tonë me pjesën tjetër të komunitetit?

Komunikimi verbal

Kur kemi ndërveprim me grupin me të cilin punojmë, atëherë duhet ta kemi parasysh procesin e dyanshëm të dërgimit dhe pranimit të porosive, përkatësisht informacioneve. Në të dyja rastet, dërguesi i informacionit dhe pranuesi, i interpretojnë ato në mënyrë të vet. Këtu, rol të rëndësishëm luajnë faktorë të ndryshëm, si që janë: përvoja paraprake, kultura, zakonet familjare, përkatësia në një komunitet etnik, gjinia e kundërt, mjedis rural/urban dhe shumë të tjerë. Që të tejkalohen (zvogëlohen) këto dallime, është e nevojshme të njihet bashkëfolësi dhe të ofrohet sqarim shumë i hollësishëm i asaj që dëshirojmë ta themi.

Komunikimi verbal mundëson një mënyrë të caktuar të ligjërit, i cili është përplot me fraza të duhura dhe adresime të këndshme (ju lutem, urdhëroni, po të dëshironi, interesant, e kam vështirë të pajtohem, ...). Një pikëpamje e posaçme e komunikimit verbal është pastri mi i gjuhës së urrejtjes, të stereotipave dhe fyerjeve.

Një pjesë e madhe e konflikteve ndërmjet njerëzve ndodhin nga përmbajtjet që nuk kuptohen siç duhet

gjatë komunikimit verbal dhe përdorimit të vrazhdësisë që krijojnë ambient kërcënues, frikësues, nënçmim dhe ndjenjë të pakëndshme.

Ushtrimi 1. Komunikimi verbal

Në këtë pjesë të punës sonë e kemi parashikuar ushtrimin "Historia prej tre minutave".

"Bëhet përzgjedhja e një historie nga një gazetë e cila zgjat rreth tre minuta dhe përbëhet nga më së shumti 10 fjali. Duhet të kemi kujdes që kjo histori të ketë bollëk të nocioneve, emrave të llojllojshëm, etj., që të mund të bëjmë ndryshime të vogla të historisë ose të shpikim tërësisht një të re.

Pasi që ta zgjidhni përmbajtjen e kësaj historie, mund ta shfrytëzojmë për ushtrimin tonë.

E nxjerrim grupin jashtë ambientit të punës, ndërsa në ambientin e punës lëmë vetëm një anëtar të grupit. Ai mund të caktohet nga vetë grupi, të jetë vullnetar ose ne mund të lusim që të rri dikush në atë ambient. Ia lexojmë historinë pjesëmarrësit që ka mbetur në ambientin e punës, ndërsa pastaj ftojme një anëtar të grupit që është jashtë ambientit të punës. Anëtari i parë që e ka dëgjuar historinë ka për detyrë t'ia thotë të njëjtën histori anëtarit që sapo ka hyrë në ambientin e punës. Mandej, vijon kjo procedurë për të gjithë të tjerët, përkatësisht i dyti ia tregon historinë të tretit, i treti të katërtit dhe kështu deri te i fundit. Kur të vijë radha e anëtarit të fundit, e lusim që ta thotë historinë që e ka dëgjuar nga anëtari i parafundit. E krahasojmë versionin fillestar me atë të fundit, e vështrojmë dallimin dhe fuqinë e fjalës që për 30 minuta mund ta ndryshojë tërësisht përmbajtjen e historisë."

Dëgjimi aktiv

“Të gjithë pjesëmarrësit përfshihen në procesin e komunikimit. Komunikimi i mirë është një proces i dyanshëm: njëri person e dërgon informacionin, ndërsa tjetri e pranon atë. Komunikim efektiv është vendimtar në punën në grup, njësoj si për trajnerin, ligjëruesin, etj., ashtu edhe për pjesëmarrësit, përkatësisht për grupin. Kur njerëzit ndjejnë që idetë dhe mendimet e tyre çmohen nga grupi, atëherë kemi kontribut më të madh në punën e grupit, si dhe ndjenjë të përkatësisë dhe ndërveprim grupor. Dëgjimi aktiv është çelësi i komunikimit efektiv.”³

Dëgjimi aktiv është diçka më tepër se sa vetëm të dëgjohet bashkëbiseduesi. Ai paraqet absorbimin e tërë asaj që e ka thënë bashkëbiseduesi, si dhe t’i bëhet me dije bashkëbiseduesit se ka qenë i dëgjuar dhe kuptuar.

Dëgjimi aktiv ndahet në dy kategori të komunikimit: verbal dhe jo verbal, kështu që tani do të kalojmë nëpër shkathtësitë dhe sqarimet e shkurtra për ato.

Tabela 1. Shkathtësitë verbale të dëgjimit

Shkathtësia	Sqarim
Përmbledhja	Drejtimi i disa gjërave që janë thënë nga bashkëfolësi drejt përgatitjes së një deklaratë. Në këtë rast duhet ta kemi parasysh saktësinë e konkluzionit. <i>Shembull:</i> „Pra, për tri gjërat që po flisnit janë ... e para,... e dyta,... e treta?”
Shpjegimi	Të verifikohet nëse gjithçka që është thënë të kuptohet mirë, siç janë disa fakte, vendime, renditja e ngjarjeve. <i>Shembull:</i> „Pra, atë që e flisni ju është se nuk do të jemi të lirë të premten për shkak të obligimeve urgjente”.
Referimi	Theksimi i ndjenjave eksplicite dhe nënkuptuara që janë shprehur nga bashkëbiseduesi dhe demonstrimi i mirëkuptimit dhe pranimit. <i>Shembull:</i> „Kjo tingëllon sikur të jetë me të vërtetë ngazëlluese...”
Parafrazimi	Dhënie e komenteve kthyesë, në masë të caktuar, lidhur me atë që është thënë, duke shfrytëzuar fjalë të veta. Kjo shkathtësi na mundëson t’ia bëjmë me dije bashkëbiseduesit se e kemi dëgjuar, ndërsa njëkohësisht e nxitim që të vazhdojë me bisedën. <i>Shembull:</i> “Nëse ju kuptova mirë, ajo çfarë ka ndodhur në punë me të vërtetë paska qenë shqetësuese...”
Sqarim	Të ofrohet interpretim i deklaratës së bërë. Kjo shkathtësi ndihmon shumë nëse dikush nuk flet mjaftueshëm qartë ose shprehet jo qartë, ndërsa ne dëshirojmë që të marrim pjesë aktive dhe ta kuptojmë. <i>Shembull:</i> “Mbase kjo ka të bëjë me...”
Pyetje të hapura-mbyllura	Parashtrimi i pyetjeve që do ta nxisin diskutimin e mëtejshëm. <i>Shembull:</i> “Çfarë ndodhi pastaj?” ose: “Si ndikoi e tërë ajo mbi ty?” Vëreni dallimin ndërmjet këtyre dy pyetjeve të hapura-mbyllura dhe atyre që përgjigjen me PO dhe me JO, si që janë: “A u frikësove?” ose: “Dhe, u largove pastaj?”
Inkurajim	Kjo shkathtësi i nxit mendimet e folësve, ndërsa theksohen edhe meritat për atë. <i>Shembull:</i> “Ishte një kontribut i mirë ai, ju faleminderit”. Ose përdorimi i theksit që të theksohet se e kuptojmë atë që është thënë. Kjo duhet të jetë në shërbim të vazhdimin të bisedës, përkatësisht t’ia bëjë me dije se dëgjuesi është i gatshëm të dëgjojë edhe më tutje. <i>Shembull:</i> “Aha, ... a, po... po, po...”
Lënie të hapësirës (qetësi)	Të lejohej pak kohë ndërmjet asaj që personi dëshiron ta thotë dhe vazhdimi i diskutimit nga folësi. Qetësia mund të mundësojë shprehjen plotësuese të folësit ose mund të ndihmojë në absorbimin e asaj që është thënë.
Ndërlidhje	Deklaratat/pyetjet/komentet mund të ndërlidhen nga folësi, duke përdorur fjali që nxisin interesim, përkrahje dhe inkurajim për të vazhduar. <i>Shembull:</i> “Pasi që ishte atje, çfarë ndodhi?” ose: “Dhe mandej ishte...”

Tabela 2. Shkathtësi të dëgjuarit jo verbal

Shkathtësia	Sqarim
Shprehja e fytyrës	Fytyra jonë i shpreh emocionet tona. Lejoni që kjo të ndodh gjatë sesionit. Personi duhet të jetë i aftë të reagojë shpejtë gjatë asaj se çfarë shprehje të fytyrës do të përdor dhe gjithnjë të ketë parasysh grupin, nevojat dhe sigurinë e tij.
Kontakti me sy	E pasqyron interesimin, e nxit bashkëbiseduesin të vazhdojë të flet dhe ofron përkrahje.
Gjuha e trupit	Mënyra se si qëndron personi, si e mban trupin, përcjell porosi interesimi ose mërzie. Kur dëgjohet një pjesëmarrës, dëgjuesi duhet të jetë i drejtuar nga personi që e dëgjon, duke pasur ndjenjë interesimi.
Gjestikulacionet	Një ndër gjestikulacionet më të rëndësishme janë ato të shprehura nëpërmjet duarve. Gjestikulacionet për ndihmë përfshijnë duar të hapura ose të shtrira për rritjen e pjesëmarrjes, mandej gjestikulacionet me duar i përdorim për t'i shprehur përkrahje bashkëbiseduesit. Tundja e kokës ofron konfirmim dhe inkurajim për të vazhduar me bisedën.
Racionalizimi i hapësirës	Lënie e distancës së rehatshme ndërmjet folësit dhe dëgjuesit. Mungesa e hapësirës, përkatësisht futja në hapësirën e dikujt tjetër mund të shkaktojë siklet. Situata e tërheqjes për shkak të ruajtjes së hapësirës së vet shkakton prishje të ambientit të punës për tërë grupin.
Korniza kohore	Të mos ndërpritet folësi nëse ajo është e domosdoshme. Kjo mund të quhet kombinim i shkathtësive verbale dhe jo verbale të dëgjimit dhe ka rëndësi thelbësore se si do të reagojë trajneri dhe si do ta përcaktojë kohën e caktuar për diskutim.

Në fund, është shumë e rëndësishme të përkujtojmë për dallimet e ndryshme kulturore, duke u nisur nga dallimet gjinore (t'i marrim parasysh disa tregues jo verbal), përkatësia etnike, grup moshat dhe të tjera, se në disa situata të gjithë treguesit mund të kenë domethënie të ndryshme.

Komunikimi jo verbal

Njerëzit gjatë komunikimit nuk përdorin vetëm tinguj dhe fjalë. Shumë porosi, përkatësisht informacione dërgohen ose pranohen pa përdorimin e fjalëve. Trajneri, ligjëruesi e ngjashëm, nuk mund të dijë në çdo çast nëse dhe sa ndërveprim do të ketë në një pjesë të përmbajtjes, mirëpo gjithsesi mund të vërejë se si reagojnë disa anëtarë të grupit, madje edhe i tërë grupi në disa raste të caktuara. Pikërisht në këto pjesë të punës në grup, duhet të jemi të vetëdijshëm për treguesit jo verbal të cilët na përcillen neve ose ndodhin në kuadër të grupit.

Kur përmendëm në fillim se vetë-analiza dhe vetëvlerësimi janë pjesë shumë të rëndësishme të zhvillimit të trajnerit, kjo në masë të madhe i referohet edhe komunikimit joverbal dhe marrëdhënieve në grup. Nëpërmjet treguesve joverbal fitojmë informacione kthyesë në kohë, të cilat mbase me qëllim ose pa qëllim na i dërgon grupi.

Treguesit joverbal në kuadër të grupit mund të na tregojnë për marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të grupit, e kështu mund t'i shfrytëzojmë ato për ta zhvilluar më tej grupin. Këtu, para së gjithash bëhet fjalë për aktivitetet e anëtarëve dhe interesimin e tyre për temat. Të mos harrojmë edhe për nivelin e përmbajtjeve, përkatësisht nëse ato nuk janë kuptuara siç duhet; grupi ende nuk është në gjendje t'i kuptojë informacionet ose përmbajtja për ta është diçka që tashmë e kanë kaluar dhe presin diçka më tepër.

Në fakt, tashmë bëme një hyrje në kuptimin e përgjithshëm të komunikimit joverbal, ndërsa tani mund të flasim për pjesën e punës në grup.

Kur punojmë në grup, duhet të jemi të vetëdijshëm për mbarëvajtjen e ngjarjeve brenda në grup, ndërsa njëkohësisht edhe për realizimin e përmbajtjeve që janë të parapara me program. Nuk është e mjaftueshme që vetëm ta kalojmë programin dhe të themi që e kemi mbuluar agjendën. Pikërisht në këto momente duhet t'i shfrytëzojmë treguesit joverbal.

Është gjë e zakonshme që gjatë punës në grup të ketë edhe nëngrupe, pa dallim të karakterit të tyre, bazës etnike, vendbanimit, gjinisë, etj. Edhe këto nëngrupe ndikojnë në zhvillimin e grupit, përkatësisht në ndërveprimin brenda në grup.

Një element shumë i rëndësishëm i komunikimit joverbal është edhe qëndrimi i trajnerit, përkatësisht arsimtarit. Çfarëdo lloj dominimi fizik të hapësirës mund ta ndryshojë dinamikën e punës së grupit.

Në këtë pjesë të trajnimit parashikua një ushtrim ku do të kemi mundësi t'i vështrojmë e njëkohësisht edhe t'i hulumtojmë treguesit joverbal që shfaqen gjatë punës në grup.

Ushtrimi 2. Komunikimi joverbal

"Karta" – ky ushtrim na jep mundësi që ta vështrojmë komunikimin joverbal nga disa pikëpamje.

"Para fillimit të trajnimit, varësisht nga madhësia e grupit, vendosim se në sa grupe do t'i ndajmë pjesëmarrësit. Kjo është e rëndësishme sepse varësisht nga numri grupeve, do të krijojmë po aq rregulla të ndryshme. Diku aset mund të jenë më të fuqishëm, pastaj dyshet e kështu me radhë deri te mbreti. Diku mbretërit mund të jenë më të fuqishëm, pastaj mbretëreshat e kështu me radhë deri te aset. Në disa grupe mund t'i ndajmë sipas fuqisë së shenjave të kartave. Për shembull, zemrat më të forta, ndërsa më të dobët janë letrat spathi, pra varësisht nga fantazia jonë. Është e rëndësishme të mbahen në mend se sa grupe do të kemi, aq rregulla do të duhet të përcaktojmë.

Pasi që t'i ndajmë në grupe, sipas shembullit një, dy, tre, katër, etj., njëshat i ulim në një tryezë, dyshat në një tjetër, treshat, katërshtet... kështu me përpikëri ua bëjmë

me dije se çfarëdo që të bëjnë nxënësit, nuk guxojnë të flasin, përkatësisht të lëshojnë ndonjë tingull. Ua japim udhëzimet e shkruara në letër, të cilat i lexojnë dhe pasi që t'i lexojnë udhëzimet, i marrim prapë udhëzimet e shkruara, ndërsa ushtrimi vazhdon me lojën e kartave. Në çdo grup kemi një anëtar me më shumë karta, përkatësisht fitues, si dhe një anëtar me më pak karta, përkatësisht humbës. Fituesit i ndërrojnë grupet, nga i pari në të dytin, nga i dyti në të tretin, nga i treti në të katërtin, nga i katërti në të parin, ndërsa humbësit nga i katërta shkojnë te grupi i tretë, nga grupi i tretë në të dytin, nga grupi i dytë në të parin dhe nga grupi i parë në të katërtin”.

Grupet e përziera në këtë mënyrë, të cilët luajnë sipas rregullave të tyre, sjellin një gjendje të çrregulluar sepse gjatë tërë kohës përmendim që pjesëmarrësit nuk guxojnë të flasin.

Sa herë do t'i përziejmë grupet sipas këtij parimi, varet nga ne. Rekomandohet të bëhen tre deri katër raunde e mandej të kalohet në pjesën e diskutimit.

Për pjesën e diskutimit, duhet të kemi përgatitur pyetje të gjysmë strukturuara të llojit, p.sh., se si ndjehen nxënësit, mandej për mbarëvajtjen e ushtrimit, si është realizuar kontakti i parë, si ka qenë reagimi gjatë ushtrimit e deri në pyetje lidhur me atë se si është zbatuar komunikimi joverbal gjatë ushtrimit.

Shembuj të ndërveprimit të komunikimit joverbal.

Kur flasim për komunikimin joverbal, mund të përmendim disa shembuj të përgjithshëm që janë të pranishëm kudo:

- **supozime të bazuara në gjini:** njerëzit sillen ndryshe kur janë në pyetje gratë ose burrat. Të gjithë pjesëtarët e shoqërisë kanë mendime të caktuara se si duhet të sillet një grua ose burrë. Mu për këtë, disa anëtarë të grupeve mund të ndjehen të rehats-hëm kur janë në praninë e të dy gjinive, varësisht nga tema dhe mosha e pjesëmarrësve.
- **statusi social/ekonomik:** mënyra e sjelljes në grup mund të ketë implikime paraprake në raport me klasën sociale. Disa anëtarë mund të ndjehen se vijnë nga një pjesë e veçantë, më e mirë e qytetit, shtetit, etj., kështu që reagojnë në mënyrë të papërshtatshme ndaj një pjesë të anëtarëve të grupit, gjë që mund të vërehet edhe nëpërmjet treguesve të ndryshëm joverbal; mbyllen para dikujt, grimasa të fytyrës, etj.
- **Përkatësia etnike dhe raca:** kjo mund të jetë nga mospranimi i tërësishëm e deri në keqardhje të tërësishme, kështu që në ty dyja rastet kemi një kombinim të papranueshëm. Që nga refuzimi i një anëtari të grupit, mbyllja e tyre, shprehja e fytyrës, etj., ndërsa në pjesën e keqardhjes kemi raste të mbrojtjes së tepërt, çiltërsi më të madhe e cila nëse është e tepërt, nga ndihma mund të shndërrohet në keqardhje dhe fyerje.
- **mosha:** ndarja sipas viteve, përkatësisht sipas moshës mund të ndikojë negativisht në ndërveprimin e grupit.
- **pengesa në zhvillim:** shenja që mund të jenë të pranishme, nga frika, nga keqardhja e sërishme, pastaj

refuzimi, përkatësisht tmerrimi nga vetë prania e këtyre njerëzve.

Mirëpo, neve na intereson grupi dhe treguesit joverbal në kuadër të grupit.

Ushtrimi 3. Reagimet dhe lëvizjet

Од таа причина ја подготвивме вежбата „Крст“, која директно ќе ни посѐужи за согѐедување на нашите движења и реакции.

Për këtë arsye e përgatitëm ushtrimin “Kryqi”, i cili drejt-përdrejtë do të na shërbejë për të vështruar lëvizjet dhe reagimet tona.

“Në këtë ushtrim marrin pjesë katër pjesëmarrës, të ulur në pozitë të kryqit, përkatësisht njëri përballë tjetrit. Çdo anëtar i grupit diskuton në temë të caktuar, ndërsa kemi edhe një person shkatërrues në grup, i cili nëpërmjet tingujve dhe lëvizjeve të papritura e pengon bisedën, i dyti është zhytur shumë në diskutime, rri i heshtur, por shikon me këmbëngulje, përkatësisht është përqendruar te diskutuesit; dhe natyrisht, kemi dy diskutues. Pas një kohe të caktuar, i ndërrojmë rolet me zhvendosjen e rrethit.

Vijon diskutimi për ushtrimin me të gjithë pjesëmarrësit.”

Konkluzioni 1: Komunikimi

Gjatë zbatimit të komunikimit verbal, duhet të kemi kujdes për:

- **tonin e zërit** – një tregues i fuqishëm në raportet e grupit. Një paqartësi e vogël ose një pranim i gabuar i porosisë nga pjesëmarrësit mund të jetë pasojë pikërisht e tonit të zërit. Nganjëherë porosia për “përfshirje më të madhe në aktivitete” mund të interpretohet ndryshe, varësisht nga zëri “i rreptë e i thellë”, nga zëri “i qetë e i papërcaktuar” e deri në zërin “emocional” të trajnerit, ligjëruesit, etj.
- **interpretimin** ose sqarimin e disa pjesëve të sesioneve, kur kemi një numër të madh të informacioneve, ndërsa renditja dhe zberthimi i tyre mund të ndihmojë në pjesën e mëtutjeshme të aktiviteteve të planifikuara, si dhe realizimin e tyre.
- **gjuhën** dhe përdorimin e tij. Përdorimi i gjuhës më të pastër dhe komunikimi i realizuar me grupin janë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Vetëm të kthehemi në fillim të doracakut tonë ku përmendën se si do të pranohej nga grupi dhe cila dozë e seriozitetit ose e humorit mund të na ndihmojë. Këtu mund ta lokalizojmë “pastërtinë” e gjuhës dhe përdorimin e zhargonit.
- **Frazat dhe shprehjet e këndshme** – të fillohet fjalia ose shprehja e mendimit dhe qëndrimin duke përdorur një frazë të këndshme mundëson zvogëlim të efektit negativ të mospajtimit dhe mundëson që të hapet në bisedë ai me mendim ndryshe. Frazat e këndshme mundësojnë shmangien e konflikteve dhe ambientin kërcënues.
- **t’iu shmangemi ofendimeve, përbuzjes, stereotipeve, shprehjeve nënçmuese** – kjo formë e të fo-

lurit gjithmonë shkakton rezistencë ndaj atij të cilit i janë drejtuar ato fraza, e pamundëson punën në grup dhe shpie në konflikte ose tërheqje dhe pasivitet të disa anëtarëve të ekipit.

Treguesit joverbal:

- **gjuhën e trupit** ose pozitën e trupit tonë në raport me grupin. Çiltërsia, përkatësisht mbajtja e duarve në formë të kryqëzuar, mandej pozita e supëve, mund të krijojë huti ose frikë. Pozita në formë të trupprojës paraqet parandalim dhe e ndërpret ndërveprimin. Duhet të kemi kujdes se si qëndrojmë sepse mund të pasqyrohet siguria jonë.
- **mënyrën e veshjes** – në këtë kontekst, u përmenden dallimet gjinore, mandej stili i veshjes dhe tërheqja e vëmendjes. Komforti i rrobave tona duhet të jetë në përputhje me grupin. Dallimi tepër i madh i gardërobës mund të paraqet edhe dallim të madh ndërmjet trajnerit, ligjëruesit dhe grupit.
- **lëvizjet** e duarve tona, në masë të madhe, mund të ndihmojnë në sqarimet tona. Duhet kushtuar vëmendje që të mos pengohet, përkatësisht shenjat tona të mos jenë kërcënuese ndaj grupit, pasi që në këtë rast do të kishim kundër efekt, përkatësisht zvogëlim ose ndërprerje të ndërveprimit të grupit.
- **qëndrimi në ambient** – në qoftë se të gjithë rrinë ulur, ndërsa dikush çohet, ai dikush dominon me ambientin. Mbajtja e hapësirës së njëjtë të grupeve të ndryshme ka rëndësi të veçantë (veçanërisht të vajzave dhe djemve).
- Kombinimin e komunikimit verbal dhe joverbal më së miri mund ta vështrijmë me përdorimin e teknikave të dëgjimit aktiv, pa të cilat këta dy lloje të komunikimit nuk do ta kishin vendin në këtë modul për punën në grup.

3.1.2. Lidershipi – hyrje

“Lidershipi, ndërmarrja e iniciativës dhe përgjegjësisë, por njëkohësisht duke lënë hapësirë që edhe të tjerët të shprehen dhe të marrin pjesë” – shpeshherë në këtë mënyrë gjenden disa definicione ose mendime të pjesëmarrësve të llojllojshëm në seminare të ndryshëm.

Mbase në jetën e përditshme fjala “lider” ka një domethënie tepër të fuqishme. Ndonjëherë merret edhe si një sjellje absolutiste dhe e drejtë e një individi. Mirëpo, a duhet kështu të perceptohet ose matet lidershipi?

Karakteristikat dhe vlerat e lidershipit

Tashmë përmendëm se lidershipi nënkupton ndërmarrjen e iniciativave, mbajtjen e përgjegjësisë. Vetë lidershipi është kombinim i disa karakteristikave dhe vlerave që i përcaktojmë.

Marrja e lidershipit për disa gjëra gjatë realizimit të aktiviteteve të ndryshme, shpeshherë është e domosdoshme. Pasi që punojmë me grupe të ndryshme, përkatësisht me anëtarë dhe personalitete, kemi nevojë për aktivitete të ndryshme në momente të ndryshme.

Pra, nuk është fare lehtë të kalojmë diçka vetëm me një definicion ose të nxjerrim konkluzion të fundit.

Në pjesën e lidershipit, shpeshherë është mirë që vetë grupi të vlerësojë dhe të përcaktojë çfarë është e nevojshme për një lidership të mirë.

Një element i rëndësishëm për të cilin duhet të kemi kujdes është ai se për aktivitete të ndryshme mund dhe duhet të ekzistojnë liderë të ndryshëm. Për shembull, gjatë një aktiviteti fizik, si liderë mund të paraqiten disa fëmijë, gjatë një aktiviteti lidhur me shkathtësi, si liderë mund të paraqiten disa fëmijë të tjerë. Nuk guxon lidershipi për një aktivitet të imponohet si lidership absolut për të gjitha aktivitetet ose të lejohet të imponohen aktivitete në të cilat do të paraqiten si liderë vetëm një grup i caktuar i fëmijëve.

Në rastin tonë, do të kemi sqarime për ushtrimet që janë të përshtatshme gjatë përcaktimit të karakteristikave dhe vlerave të lidershipit.

Ushtrimi 1. Cilësitë e lidershipit

“Qëllimi i këtij ushtrimi është të nxitet të menduarit e nxënësve për karakteristikat e një lideri të mirë.

Ky proces përfshin përcaktimin e liderëve të grupeve, si dhe përvoja që është fituar me ushtrimin.

Kohëzgjatja: 60–100 minuta.

Procedura:

- Me një fije letre dhe stilolaps në dorë, çdo nxënës mendon për një lider që ata e njohin ose si e imagjinojnë një lider. Të gjithë nxënësit shkruajnë për atë se si e imagjinojnë liderin, arrijtet e tij/saj, shkathtësitë dhe aftësitë.
- Formojmë disa grupe nga 4–5 nxënës, varësisht nga numri i nxënësve. Kërkojmë që çdo grup të caktojë një lider.
- Pasi që çdo grup të ketë caktuar një lider, kërkojmë nga lideri i emëruar që ta lehtësojë punën e grupit të tij, gjatë së cilës nxënësit do të kenë mundësi t’i ndajnë mendimet e tyre rreth asaj se cilat kanë qenë zgjedhjet e tyre për liderin që e kanë shkruar në fijen e letrës, cilat janë arrijtet, shkathtësitë dhe aftësitë e tij/saj.
- Pasi që nxënësit t’i ndajnë modelet e tyre të një lideri, lideri i zgjedhur i grupit hap diskutim për cilësitë e një lideri të mirë, duke u bazuar në atë që është thënë më herët.
- Çdo grup arrin konsensus për 6-të karakteristika për të cilat konsideron se janë më të rëndësishme për një lider të mirë.
- Tani formojmë një grup të liderëve nga grupet. E shfrytëzojmë modelin **akuarium** në qendër të sallës. Liderëve të grupeve iu japim 10–15 minuta që të merren vesh se cilat janë 6-të karakteristikat më të rëndësishme të një lideri të mirë. Pas këtyre 15 minutave, liderët kthehen në grupet e tyre fillestare. Më tutje, varet prej tyre se si do të merren vesh. Akuariumin mund ta përsërisim disa herë dhe mandej mbaron ushtrimi.

Orientimi i diskutimit:

(për liderët)

Individualisht dhe në akuarium.

- Si ndjeheni tani pas mbarimit të ushtrimit?
- Sipas mendimit tuaj, sa mirë e luajtët rolin tuaj të liderit në grupet e vogla?
- Sa jeni të kënaqur me procesin dhe mënyrën se si u zgjodhët?
- Sa jeni të kënaqur me procesin në akuarium dhe a i arsyetuat pritshmëritë?

(për anëtarët e grupeve)

- Si ndjeheni tani pas mbarimit të ushtrimit?
- A jeni të kënaqur me mënyrën se si e zgjodhët liderin?
- Në qoftë se e përsërisim ushtrimin, çfarë do të bënit ndryshe ose çfarë do të ndryshonit? Cilat janë sugjerimet tuaja për liderin tuaj?
- Çfarë do të bënit ndryshe, në qoftë se ju ishit lider?"

Lideri në mua

Kur kemi sesione trajnimi për lidërsip, gjithmonë duhet të synojmë në njohjen e aftësive të lidërsipit të njerëzimit. Në situata të ndryshme kemi nevoja të ndryshme, prandaj duhet të jemi të inkurajuar për të ndërmarr iniciativë. Do të kishim ndihmë të madhe në qoftë se jemi të vetëdijshëm për aftësitë tonë të lidërsipit.

Në këtë drejtim zhvillohet edhe ushtrimi jonë "Lideri në mua".

Ushtrimi 5. Lideri në mua

Kohëzgjatja: 45 min.

"Qëllimi i ushtrimit është t'i inkurajojmë anëtarët që t'i njohin aftësitë e tyre të lidërsipit.

- Pa përdorimin e fjalës "lidërsip" i ftojme të gjithë anëtarët e grupit që të kujtojnë një rast kur ata kanë ndërhyrë me vetë-iniciativë në një situatë të caktuar, kanë ndërmarrë iniciativë ose përgjegjësi. Këtu mund të përfshihen ngjarjet në punë, në familje, në komunitet... nuk duhet të jetë kushedi se çfarë ngjarje.
- Parashtrijmë pyetje:
 - o Çfarë ka ndodhur?
 - o Kush ka qenë i përfshirë?
 - o Si jeni ndier derisa e keni ndërmarr atë aktivitet?
 - o Çfarë reagimi pati?
- Formojmë grupe nga tre persona. Përderisa njëri e tregon ngjarjen, të tjerët e dëgjojnë dhe e vërtetojnë se cilat aftësi, cilësi dhe shkathtësi i ka përdorur folësi. Marrin shënime. Procedura përsëritet me të tre anëtarët e grupit.
- Kthehemi në grupin e madh. I listojmë vlerat dhe cilësitë që janë përdorur nga pjesëmarrësit.

Konkluzioni 2: Lidërsipi

- Menaxhimi me burimet njerëzore është një ndër punët më sfiduese dhe më të ndërlikuara të liderit. Çdo person është i veçantë dhe në qoftë se teoria e motivimit mund ta parashikojë sjelljen e njerëzve në pjesën më të madhe të kohës, nuk mund të parashikohet se çfarë do të bëjë individi në një situatë ose moment të caktuar.

3.1.3. Puna në ekip

Elementet themelore të një ekipi të suksesshëm:

- anëtarët e ekipit kanë qëllim ose qëllime të përbashkëta;
- anëtarët e ekipit pranojnë metoda të unifikuara për arritjen e qëllimit të dëshiruar;
- anëtarët e ekipit ndajnë vlera të ngjashme;
- anëtarët e ekipit kanë detyra dhe role individuale që ndihmojnë në arritjen e qëllimit;
- anëtarët marrin pjesë në diskutime, vendimmarrje dhe ndarjen e detyrave në mënyrë të barabartë. Kjo krijon ndjenjë të pronësisë dhe respektit ndërmjet anëtarëve të ekipit;
- anëtarët e ekipit bashkëpunojnë dhe respektohen; i tolerojnë dallimet individuale;
- sinjeraliteti dhe komunikimi i hapur janë në rend të parë;
- anëtarët e ekipit krijojnë atmosferë në të cilën mund të shprehet kritika konstruktive;
- anëtarët e ekipit janë të vullnetshëm ta zgjidhin konfliktin sa më shpejtë që është e mundur;
- ekipi është i bashkuar në përpjekjet e tij, nevojat individuale korrespondojnë me nevojën dhe qëllimin e përbashkët.

Ekipi paraqet ndarje të drejtave dhe përgjegjësi të çdo anëtari të ekipit varësisht nga interesat, mundësitë dhe njohuritë e tij. Vendimet merren me marrëveshje, kompromis, transparencë dhe me konsensus kur është e mundur.

Puna në ekip ka disa metoda dhe mënyra të ndryshme të sjelljes së individit. Anëtarët e ekipit duhet të punojnë së bashku dhe ta përkrahin njëri tjetrin. Ekipi krijon një ndërgjegjësim për cilësitë e çdo anëtari dhe identifikim të kontributit konkret që secili prej tyre mund ta jep. Ndarja e të drejtave dhe përgjegjësi zakonisht jep rezultate më të mëdha se sa grupi i zakonshëm i aktiviteteve individuale. Puna në ekip nuk nënkupton ndarje mekanike të punëve, por ndarje të mirë menduar dhe me marrëveshje të punëve, të cilat e nxisin secilin që të jep maksimumin. Liderët e ekipit luajnë rolin e organizimit, bashkërendimit dhe lehtësimit në drejtim të gjetjes dhe praktikimit të një stili ekipor (kolektiv).

Si të përmirësohet puna në ekip?

- Detyrat ndahen në përputhje me interesat, njohuritë dhe shkathtësitë e anëtarëve të ekipit.
- Nuk pritet që të ketë absolutisht kontribut identik i çdo anëtari të ekipit, por çmohet kontributi individual.
- Nxitet ndihma e ndërsjellë, ndarja e barrës së obligimit dhe ndarja e përgjegjësisë.
- Zgjidhni problemet në mënyrë praktike në mënyrë të rregullt; zbatoni procesin e stuhisë së ideve (brainstorming) gjithnjë kur është e mundur. Kjo e stimulon punën në ekip dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.
- Konflikti në çdo grup është i natyrshëm. Këto konflikte duhet të zgjidhen ashtu që të mos të ketë fitues dhe humbës që të mund të vazhdojë të punojë ekipi në mënyrë efikase.
- Puna në ekip nuk nënkupton se gjatë tërë kohës duhet të punohet në një grumbull gjërash (mund të ndahen punët që mund të kryhen individualisht).
- Shfrytëzoni takimet si mundësi për biseda (i cili mund të del edhe jashtë aktivitetit konkret); njohje të ndërsjellë; njohje të interesave dhe shkathtësi të çdo anëtari të ekipit, përkrahje dhe ndarje të përshtatshme të angazhimeve në përputhje me mundësitë e individëve.
- Në qoftë se ju bashkëngjitet një anëtar i ri, caktoni dikë që do të jetë përgjegjës për futjen e tij në punë, njohjen e tij me metodologjinë e punës dhe asaj që është realizuar deri më tani.

Përpiloni plan afatgjatë të aktiviteteve të ekipit, me çfarë do të krijohet ndjenja e përkatësisë së çdo anëtari të ekipit.

Festoni çdo sukses së bashku dhe mblidhuni që të analizoni çdo mospasur me qëllim minimizimin e pasojave të dëmshme dhe gjetjen e zgjidhjeve më të favorshme.

Ushtrimi 6. Puna në ekip

“Ushtrimi me vezën”

Nevojitet nga një vezë “e gjallë” për 4-5 pjesëmarrës. Mandej fije peri, me të cilin do ta lidhim vezën që të rri varur, shumë letër, gërshtë, gazeta të vjetra, karton, ngjitës, si dhe hapësirë të mjaftueshme për çdo grup.

Madhësia e grupit duhet të jetë deri 30 pjesëmarrës, ndërsa veç përmendëm që zgjidhja ideale është grupet të formohen me nga 4-5 pjesëmarrës.

Kohëzgjatja e aktivitetit është rreth një orë e 15 minuta, nga të cilat, 10 minutat e para i shfrytëzojmë për caktimin e ushtrimit. Rreth 30 minuta kemi për të zgjidhur ushtrimin dhe rreth 30 minuta të tjera për të diskutuar kryerjen e ushtrimit.

Pra, hap pas hapi:

- E përgatisim hapësirën në të cilën do të punohet. Për çdo grup, përgatisim fije peri me të cilën do ta lidhim vezën dhe ta lëmë të varur. Duhet të kemi kujdes për lartësinë që të mos jetë më lart se një metër e gjysmë deri në dy metra. Veza nuk duhet të mbështillet shumë me perin sepse nëse bie poshtë duhet të thyhet. Të gjithë grupeve të vogla iu lëmë shumë letër, gazeta të vjetra, gërshtë dhe ngjitës.
- E bëjmë ndarjen e grupeve. Ua japim udhëzimet: 30 minuta për ta krijuar konstruktin i cili do të pengojë thyerjen e vezës. Përderisa punojnë, duhet të dinë se pjesëmarrësit dhe materialin që e përgatisin nuk guxon ta prekë vezën, si dhe perin që rri varur. Pjesëmarrësit guxojnë ta shfrytëzojnë vetëm materialin që iu është dhënë.
- Kemi kujdes rreth respektimit të rregullave.
- Pas përfundimit të 30 minutave, ndërpritet puna. I kalojmë grupet një nga një dhe e presim perin. Vështrojmë nëse ushtrimi është realizuar me sukses.
- Diskutimin rreth ushtrimit mund ta zhvillojmë në dy pjesë. Pjesën e parë në grupet e vogla (nëse dëshirojmë), ndërsa pjesën e dytë në grupin e madh.

Rreth ushtrimit: në këtë ushtrim duhet të marrin pjesë të gjithë, si ekip. Ekzistojnë disa mënyra për ta kryer ushtrimin, varësisht nga ajo se si është menduar, përkatësisht varësisht nga ajo se si iu përgjigjet nevojave.

Mund t'u caktojmë edhe role të ndryshme pjesëmarrësve e mandej diskutimin ta orientojmë në atë drejtim, përkatësisht mund t'i parashtrijmë pyetjet vijuese:

- A kanë pasur hapësirë të mjaftueshme për t'u shprehur?
- Çfarë kanë vërejtur gjatë punës së përbashkët? A kanë pasur sukses dhe si kanë mundur të gjejnë kompromis?
- A ka pasur presion për kohën?
- A ka ndodhur ndonjë lidhësi i caktuar? Si ka qenë e pranuar ajo?

Në çdo rast, zgjedhja e pyetjeve orientohet nga ajo se si ka qenë puna brenda ekipit. Duhet të theksohet mënyra e komunikimit ndërmjet pjesëmarrësve, përkatësisht si ndikojnë stilet dhe mënyrat e ndryshme të punës në epilogun përfundimtar. Duhet pasur kujdes që diskutimi të mos shndërrohet në akuzime të ndërsjella.

Konkluzioni 3: Puna në ekip

Jo secili dhe jo gjithmonë jemi të përgatitur për punë në ekip. Megjithatë, duhet t'i kemi parasysh përparësitë që i sjell puna në ekip:

- Na jep mundësi për planifikim dhe vlerësim të përbashkët, si dhe pranim të informacioneve kthyesë nga të tjerët.
- Shpie në ndarjen e përvojave të llojlojshme që ndikojnë në cilësinë e realizimit të aktiviteteve të planifikuara.
- Na mundëson të vështrojmë njohuritë dhe shkaktësitë e një numri më të madh të njerëzve.
- Na jep mundësi t'i avancojmë ato fusha për të cilat nuk kemi përvojë të mjaftueshme.

1.1. UDHËZIME DHE REKOMANDIME PËR MBLEDHJE EFIKASE

Para mbledhjes – njoftoni, informoni dhe inkuadroni

Përpjekja e investuar për njoftim të anëtarëve të parlamentit të nxënësve për mbledhje do të rezultojë me grup të fuqizuar, vendimet e të cilit janë më të vlefshëm në sytë e komunitetit. Jepini bashkësisë së shkollës sa më tepër informata, njoftime dhe iniciativa për inkuadrim.

- Informoni përmes buletinit të shkollës, përmes alto-parlantit (nëse keni), përmes nxënësve të obliguar për këtë!
- Informoni në shkollë dhe gazetata lokale!
- Rrumbullakoseni mbledhjet vjetore në data që janë në fillim të vitit shkollor dhe këtë vendoseni në vend të dukshëm në shkollë!
- Përkujdesuni ti nxitni nxënësit që ta përcjellin njoftimin tuaj edhe në shtëpi!
- Paraqituni njerëzve – konsiderojeni telefonin si një sistem për përhapje të informatave!
- Dërgoni porosi elektronike!
- Shfrytëzoni rrjetet dhe shërbimet sociale!
- Reklamoni të gjitha ngjarjet e rëndësishme në një mënyrë tërheqëse dhe të larmishme!

Planifikimi i agjendës

Agjenda e planifikuar dhe organizuar me kujdes është themeli i një mbledhjeje të suksesshme. Agjenda e mirë shkurtimisht i nënvizon pikët për diskutim dhe radhitjen

sipas të cilës do të zhvillohet diskutimi. Pikët e rendit të ditës duhet ti pasqyrojnë nevojat dhe interesat e parlamentit të nxënësve dhe ngjarjet aktuale në shkollë. Kryetari e prezanton agjendën dhe pyet nëse anëtarët pajtohen me të, nëse dikush ka të shtojë ndonjë pikë, në fillim të mbledhjes ose ndoshta ka nevojë për ndryshim të radhitjes së pikëve. Kryetari:

- grumbullon të dhëna nga anëtarët e parlamentit të shkollës për përpilimin e agjendës (dërgon porosi qarkulluese elektronike deri te të gjithë anëtarët, shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjes, me pyetje nëse dikush ka ndonjë aktivitet ose problem për të cilin mendojnë se duhet të vendoset në rend dite);
- në bazë të të dhënave të fituara dhe në bazë të planit vjetor e dizajnon agjendën në pajtim me kohën, duke mbajtur llogari që për secilën pikë të ndahet kohë e mjaftueshme për diskutim;
- i shqyrton procesverbalet e mëparshme dhe në agjendë inkuadron pikë të cilët duhet të shqyrtohen sërish;
- ndan kohë për diskutim rreth grumbullimit të mjeteve financiare për realizimin e aktiviteteve dhe iniciativave të cilët burojnë nga procesverbali;
- i kufizon mbledhjet në maksimum 90 minuta;
- e dërgon agjendën deri te anëtarët tre ditë para mbledhjes;
- kujdeset që të gjithë anëtarët e parlamentit të nxënësve të jenë të informuar për datën e mbledhjes dhe pikat e rendit të ditës.

DREJTIMI I MBLEDHJES

Veçoritë e një kryetari të mirë (kryesues/moderator)

- I njeh ngjashmëritë dhe dallimet e grupit (nuk favorizon njerëz të caktuar dhe nuk jep hapësirë të ndryshme për shprehje në pajtim me simpatitë apo josimpatitë personale).
- I potencon interesat dhe nevojat (gjithmonë e kthen bisedën në temën konkrete).
- Shpreh falënderim dhe i vlerëson rolet e ndryshme të njerëzve në situatat grupore (përdor gjuhë me shprehje të mira, nuk bërtet, përkujton për rregullat e sjelljes).
- Punon në ndërtimin e mirëbesimit, respektit, kënaqësisë dhe komunikimit efektiv ndërmjet anëtarëve (nuk lejon ofendim, nënçmim, poshtërim ose përqeshje të kujtdo dhe cilitdo mendim).
- E kultivon bashkëpunimin me organet shkollore (thirret në të dhëna dhe informata të fituara nga burime të ndryshme).
- Mundëson vlerësim në fund të mbledhjes (i pyet të gjithë nëse kanë vërejtje dhe çdo vërejtje vendoset në procesverbal).

Rregulla themelore për drejtimin e mbledhjes

- Kryesuesi ua përkujton anëtarëve rregullat për të cilët janë pajtuar së bashku dhe u kërkon ti respektojnë këto rregulla.

- Mbledhjet e parlamentit të nxënësve duhet të kenë minimum formalitet i cili do të mundësojë zhvillimin e mbledhjes.
- Kryesuesi i jep fjalës i jep fjalë secilit anëtar.
- Për çdo pikë është siguruar kohë për debat të plotë dhe të lirë midis anëtarëve – një nga një (kufizimi i arsyeshëm është tre minuta për shprehje të mendimit apo qëndrimit).
- Çdonjërit i cili dëshiron të flet duhet ti mundësohet të flet njëherë para se dikush të flet për së dyti.
- Kryesuesi është përgjegjës për rrjedhën e mbledhjes dhe duhet të përkujdeset që askush mos të “përvetësojë” foltoren (rregulla e tre minutave e cila paraprakisht do të njoftohet dhe do të zbatohet në mënyrë rigorozë dhe barabartë).
- Vetëm një temë diskutohet në të njëjtën kohë.
- Nëse koha nuk mundëson diskutim të plotë për një pikë të caktuar, mund të përdoret rregulli që ajo pikë të vendoset në rend dite në një mbledhje të radhës.
- Çdo anëtarë ka të drejta të barabarta.

Rregulla për punë

Rregullat për punë u ndihmojnë njerëzve të punojnë në mënyrë efikase. Ata janë vegël, jo armë, dhe mund të zgjidhen nga çdo organizatë shkollore individualisht në varësi nga nevojat e tyre. Me rëndësi është organizata ti ndjek rregullat e vendosura, ndërsa është veçanërisht e rëndësishme që kryesuesi të dijë procedurën për:

- përgatitje të propozimit;
- njoftim për propozimin;
- dorëzim të propozimit;
- votim;
- ndryshim dhe plotësim të propozimit;
- refuzim të propozimit.

Rregullat duhet të ndërtohen paraprakisht, të jenë në formë të shkruar dhe të jenë të qasshme për të gjithë anëtarët e parlamentit të nxënësve. Nëse ndonjëri nga anëtarët i kërkon, ata duhet menjëherë ti prezantohen/dorëzohen.

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Stuhi idesh

Disa rregulla themelore të cilat do të ndihmojnë që stuhia e ideve të bëhet vegël efektive për zgjidhjen e problemeve.

- Sigurohuni që çdokush e ka të qartë pyetjen dhe metodën e punës (procedurën)!
- Mos lejoni ofendime, poshtëtime, përqeshje!
- Shënojeni secilën ide!
- Nxitni sasi, jo cilësi; sa më tepër ide aq më mirë!
- Ndërroni dhe kombinoni ide!
- Shfrytëzoni mjete vizuale (ndonjëherë edhe dërrasa shkollore është e mjaftueshme)!
- Lejojuni pjesëmarrësve ti zgjedhin prioritetet!

MBAJTJA E PROCESVERBALEVE

Procesverbalet zakonisht i mban sekretari. Për mbajtjen e procesverbaleve duhet të ketë një mostër të përgatitur paraprakisht të cilën do ta plotësojë proces verbalisti. Procesverbalet domosdoshmërisht të mbahen sipas njëres nga mënyrat në vijim:

1. procesverbale formale – kur mbledhjen e drejtohen kryesuesi ose kryetari i organizatës;
2. procesverbale gjysme formale – kur një grup i vogël diskuton për zështje të rëndësishme në mënyrë joformale;
3. procesverbale joformale – kur duhet të regjistrohen vetëm gjërat më të rëndësishme nga mbledhja.

Procesverbalet e sakta dhe në kohë, anëtarëve të trupit koordinues të parlamentit të nxënësve u mundësojnë:

- rezyme të qartë dhe objektive për rrjedhën e mbledhjes;
- arkiv të mbledhjeve të cilën mund ta shfrytëzojnë edhe gjeneratat e ardhshme;
- komente objektive, e jo vetëm mendime;
- gjërat kryesore (Highlights), e jo pjesë përshkruese në të cilën nuk mund të gjindet askush;
- propozime dhe zgjidhje për zështje të caktuara.

Procesverbalet dërgohen deri te secili anëtar i parlamentit të nxënësve dhe janë të qasshme në faqen e internetit të parlamentit të nxënësve.

Standarde për mbledhje të suksesshme të parlamentit të nxënësve

1. Mbledhjet e trupit mbahen çdo muaj. Mund të mbahet edhe mbledhje e jashtëzakonshme.
2. Të gjithë anëtarët e trupit kanë të drejta të plota dhe të barabarta. Një arsimtar ose prind mund të jetë anëtar i rregullt, por po ashtu mund të merr pjesë edhe në rolin e mbikëqyrësit ose këshilltarit me leje nga kryetari i parlamentit.
3. Anëtarët e trupit veprojnë dhe komunikojnë me njëri-tjetrin në bazë të barabartë me respekt të ndërsjellë.
4. Për shkak të zhvillimit të kulturës demokratike, nxënësit në trup arrijnë marrëveshje për rregullat, procedurat dhe pasojat/sanksionet për mosrespektimin e tyre .
5. Mbledhjet e trupit mbahen në hapësirë të përshtatur, duke u mundësuar anëtarëve të shihen me njëri-tjetrin, të ndjehen të rehatshëm, ka hapësirë të mjaftueshme për të gjithë dhe ka vegla të nevojshme për punë (dërrasë, flipzart, markerë).
6. Të gjithë vendimet e marra në mbledhje janë të obligueshme dhe duhet të jenë të dokumentuara në dosje të posazme (portofoli). Zbatimin e vendimit e ndjek udhëheqësia e trupit.
7. Çdo mbledhje e trupit është i strukturuar në mënyrë të njëjtë (fillon me lexim dhe miratim të procesverbalit të mbledhjes së kaluar, miratim dhe plotësim të rendit të ditës, pika e parë e të cilit gjithmonë duhet të jetë njoftim për aktivitetet që ndërliken me vendimet nga mbledhja e kaluar, shqyrtim dhe marrja e vendimit

për çdo pikë veçmas, pika të ndryshme, përmbledhja e detyrave për periudhën e ardhshme, mbyllja e mbledhjes).

8. Gjatë mbledhjes ka së paku tre funksione të nxënësve nga trupi:
 - a) një ose dy nxënës të cilët e drejtojnë mbledhjen (kryetar ose zëvendëskryetar);
 - b) një nxënës i cili mban evidencë (sekretar, proces verbalist);
 - c) një nxënës i cili përkujdeset për organizimin e mbledhjes (sekretar, trupi koordinues);
 - d) e dëshirueshme është të ketë edhe përgjegjës tjerë për mbledhjen: ata të cilët i shpërndajnë informatat për mbledhjen, ata të cilët grumbullojnë të dhëna, përgjegjës për komunikimin elektronik, përgjegjës për mjetet sociale, përgjegjës për ngarkimin e procesverbalit dhe informatave tjera në internet, ...).
9. Në mbledhje, po ashtu mund të ftohen edhe persona tjerë për të diskutuar për çështjet që i shqetësojnë ose për të cilët kanë njohuri.

3.3. HULUMTIMI – SI TË ZHVILLONI NJË PYETËSOR

Hulumtimi mund të definohet si kërkim dhe analizë sistemore e informatave relevante për një temë të caktuar, me qëllim të zbulimit të informatave, fakteve dhe të dhënave të reja dhe për nxjerrje të përfundimeve. Hapi i parë në dizajnimin e hulumtimit është përcaktimi i nevojës që diçka të hulumtohet dhe çfarë saktësisht do të hulumtohet. Hulumtimet realizohen që të përmirësohet një situatë e caktuar, që të zgjidhet ndonjë problem, që të kënaqen nevoja dhe interesa të caktuara në mënyrën më të mirë të mundshme, që të zbulohet mendimi i një grupi të caktuar njerëzish për aktivitete të zbatuara ose aktivitete që do të zbatohen në të ardhmen, që diçka të ndryshohet ose mos të ndryshohet.

Përcaktimi i qëllimeve të përgjithshme dhe specifike
Vendosja e qëllimit të hulumtimit kërkon një identifikim të qartë të asaj që është krijuar për hulumtimin ose për atë që ne duam të dimë në fund të hulumtimit. Qëllimi i hulumtimit është një rezultat i përgjithshëm që duhet të arrihet si rezultat i hulumtimit. Hulumtimi duhet të trajtojë vetëm një qëllim të përgjithshëm.

Qëllimet specifike janë hapa konkrete të cilët duhet të ndërmerren në drejtim të arritjes së qëllimit të përgjithshëm të hulumtimit.

Kur qëllimet e hulumtimit mund të shprehen me disa fjali të qarta dhe koncize, atëherë dizajni i pyetësorit është dukshëm më i lehtë. Qëllimet duhet të radhiten sipas rëndësisë. Qëllimet specifike me prioritet të ulët ose ato që mund të arrihen me të dhënat ekzistuese ose nga burime tjera duhet të lihen.

Përcaktimi i temës dhe lëndës së hulumtimit

Temë në fakt është "qëllimi" i përgjithshëm i hulumtimit (për shembull dhuna në shkollë).

Lënda e hulumtimit është aspekt ose veçori e rëndësishme e temës (për shembull, sa dhunë ka në shkollat fillore, llojet kyçe të dhunës, kur dhe ku ndodh dhuna, kush është bartësi i dhunës, a ka dimension gjinor në dhunë, a ka dimension etnik në dhunë, a ka intradunë (dhunë e brendshme) ose dhunë ndër-gjeneratash, sa dhunë ka nga ana e të rriturve në shkollë, dallime në trajtimin e dhunës së regjistruar në shkollat fillore, etj.).

Përcaktimi i hipotezës së hulumtimit

Hipoteza e hulumtimit është përgjigja e mundshme për problemin i cili hulumtohet ose „supozimi i parashikuar“ në formën një relacioni të shprehur qartë midis shkakut dhe efektit. Hipotezat ndërtohen në bazë të problemit të përgjithshëm hulumtues.

Hipotezat duhet të jenë:

- të shprehura qartë, me shfrytëzimin e terminologjisë adekuate;
- të verifikueshëm;
- deklaratë e lidhjes midis variablave.

Shembuj:

- Djemtë dhe vajzat në mënyrë të barabartë paraqiten në rolin e dhunuesve gjatë dhunës në shkollë;
- Lejimi i dhunës verbale në shkollë kontribuon për shndërrimin e tij në dhunë fizike;
- Ndëshkimi i dhunuesve i shoqëruar me dhënien e mbështetjes psikologjike për dhunuesit, kontribuon për përsëritje të zvogëluar të dhunës nga ana e dhunuesve.

Përzgjedhja e mostrës suaj

Përcaktimi i mostrës e përshkruan procesin e përzgjedhjes së mostrës përfaqësuese nga popullata e synuar me qëllim të zbatimit të anketës/intervistës/fokus grupeve. Zakonisht, popullata e synuar është tepër e madhe dhe është e pamundur të zbatohet pyetësori në tërë popullatën. Për këtë arsye ne përzgjedhim mostrë përfaqësuese, respektivisht grup më të vogël përfaqësuesish nga popullata e synuar, i cili pasqyron veçoritë e popullatës së synuar që nga ajo mostrë të mund të nxirren përfundime për tërë popullatën.

Përzgjedhja e të anketuarve është një çështje tjetër e cila është po ashtu e rëndësishme sa edhe përcaktimi i mostrës, meqenëse edhe ajo ndikon ndaj ndikimit të përfaqësimit të hulumtimit. Përzgjedhja e të anketuarve duhet të bëhet sipas përzgjedhjes së rastësishme, në përputhje me procedurën e përcaktuar.

Përgatitja e pyetësorit

Pyetësori është instrument i hulumtimit i cili përmban një sërë pyetjesh me qëllim të grumbullimit të informatave nga të anketuarit. Ai paraqet një sërë pyetjesh të shkruara ndaj të cilëve i anketuari duhet të përgjigjet. Pyetësori zakonisht është instrument sasior i cili ofron

mundësi për grumbullim të të dhënave objektive dhe të besueshme nga një numër i madh i të anketuarve.

Rezultatet të cilat janë siguruar përmes hulumtimit mund të shfrytëzohen për nxjerrjen e përfundimeve për tërë popullatën, nëse studimi është bërë në bazë të metodologjisë së përcaktuar dhe nëse mostra është përllëgaritur saktësisht.

Struktura e pyetësorit

Një pyetësor i dizajnuar mirë duhet ti përfshijë elementet në vijim:

Hyrje – kjo pjesë duhet të përmbajë titullin e pyetësorit, një përshkrim të shkurtë të qëllimit të hulumtimit, mënyrës në të cilën do të shfrytëzohen informatat, konfirmim për anonimitetin dhe instruksione të qarta se si të plotësohet pyetësori.

Bloqe pyetjesh – grup pyetjesh të cilët i përkasin temës së njëjtë ose korrespondojnë me qëllim të njëjtë. Blloku i parë u pyetjeve është paraqitur me *pyetje hyrëse* – disa pyetje të përgjithshme të cilët janë të lehta për tu përgjigjur dhe të cilët duhet ta fusin të anketuarin në lëndën e hulumtimit.

- Blloku i fundit *përmban pyetje socio-demografike*, si mosha, gjinia, gjendja civile, arsimit, etj.

Udhëzime për hartimin e pyetësorit

Përmbushja e qëllimeve

- Bëhuni të sigurt që të gjithë qëllimet e hulumtimit janë tërësisht të përfshirë në pyetjet;
- Bëhuni të sigurt që pyetjet burojnë nga hipoteza e hulumtimit;
- Përrjashtoni pyetjet të cilat nuk janë relevante për realizimin e qëllimeve të hulumtimit;
- Të gjithë pyetjet e përfshirë duhet të jenë adekuate me/dhe në pajtim me qëllimin e përgjithshëm të hulumtimit.

Lloje të pyetjeve

Ekzistojnë tre lloje kryesore të pyetjeve që përdoren në pyetësor:

- pyetje të tipit të hapur të cilët kërkojnë nga i anketuari vetë të formulojë përgjigjen e tij;
- pyetje të tipit të mbyllur të cilët kërkojnë nga i anketuari të zgjedh një përgjigje nga numri i ofruar i opsioneve;
- pyetje të tipit gjysmë të mbyllur që përpos numrit të dhënë të opsioneve përmbajnë edhe opsionin „Tjetër“, i cili mund të plotësohet.

Sipas përgjigjes ndaj pyetjeve të mbyllura dhe gjysmë të hapura dallohen llojet në vijim:

- pyetje me mundësi për zgjedhje midis dy opsioneve;
- pyetje me mundësi për zgjedhje nga më tepër përgjigje;
- pyetje me shkallë për vlerësim;
- pyetje me shkallë për pajtueshmëri;
- pyetje me pikë.

Shembull për zgjedhje të dyfishtë (kur i anketuari ka mundësi të zgjedh ndërmjet dy përgjigjeve të ofruara):

A ke qenë dëshmitar/dëshmitare e dhunës në shkollën tënde gjatë këtij viti shkollor? (Ju lutemi të zgjidhni vetëm një përgjigje.)

1. Po
2. Jo

Më tepër përgjigje – kur i anketuari mund të zgjedh ndërmjet më tepër se dy opsione. Për shembull:

Si u solle ti nëse ke qenë dëshmitar/dëshmitare e dhunës në shkollën tënde gjatë këtij viti shkollor? (Ju lutemi zgjidhni një përgjigje)

1. Nuk bëra asgjë, vetëm shikoja
2. E paraqita dhunën
3. Provova të ndërhyjë
4. Nuk më intereson, nuk duhet të përziehem
5. Tjetër (thekso): _____

Në pyetjet të cilët ofrojnë më tepër përgjigje, i anketuari duhet të zgjedh:

- një opsion (si në shembullin e mësipërm);
- numër të kufizuar përgjigjesh (2–3). Për shembull:

Sipas teje, cilët janë tre arsyet më të shpeshta për dhunë në shkollë? (Ju lutemi zgjidhni më së shumti tre përgjigje.)

1. Sipas teje, cilët janë tre arsyet më të shpeshta për dhunë në shkollë?
2. Hakmarrja
3. Demonstrimi i forcës
4. Vetë-konfirmimi
5. Probleme në sjellje
6. Grupimi për shkak të ideologjisë së caktuar
7. Demonstrimi i fuqisë ekonomike
8. Demonstrimi i sundimit mbi të tjerët
9. Xhelozia
10. Tjetër (thekso): _____

Numër i pakufizuar i përgjigjeve. Për shembull:

- A ke qenë ndonjëherë viktimë e ngacmimit apo keqtrajtimit në shkollë përgjatë shkollimit tënd? (Mund të zgjidhni më shumë përgjigje.)
1. Po, e dhunës fizike
 2. Po, e dhunës verbale
 3. Po, e dhunës sociale (përgjashtim nga grupi, injorim)
 4. Po, e dhunës psikologjike
 5. Po, e dhunës në internet
 6. Po, e dhunës tjetër (thekso) _____
 7. Jo, nuk kam qenë viktimë

Pyetje me shkallë të vlerësimit – kur i anketuari duhet të vlerësojë ndonjë pyetje në shkallë e cila përfshin prej dobët deri në mirë ose lloj tjetër të shkallës. Për shembull:

- Sa i kënaqur je me reagimin e kompetentëve në shkollë në rast të dhunës? (Zgjidhni një përgjigje.)
1. Shumë i kënaqur
 2. I kënaqur
 3. I pakënaqur
 4. Shumë i pakënaqur

Pyetjet me shkallë pajtueshmërie (Pyetjet e Likertit) – përcaktimi se sa të anketuarit pajtohen ose nuk pajtohen me një deklaratë të caktuar, respektivisht si ndjehen ata në lidhje me ndonjë pyetje. Për shembull:

Më poshtë janë theksuar deklaratat e caktuara për të cilat duhet të vlerësoni se sa pajtoheni ose nuk pajtoheni						
	Tërësisht nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Edhe pajtohem edhe nuk pajtohem	Pajtohem	Tërësisht pajtohem	Nuk e di

Pyetje me pikë – kur i anketuari duhet të përgjigjet në një shkallë me pikë. Për shembull:

Ju lutemi vlerësoni shkallën e pranisë së dhunës në shkollën tuaj në shkallën prej 0 deri në 10, ku 0 do të thotë se nuk ka dhunë, ndërsa 10 do të thotë se ka shumë raste të dhunës.

0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	----

Nuk ka dhunë

Shkallë shumë e lartë e dhunës

Renditja e pyetjeve

Marrë në përgjithësi, pyetjet duhet të kenë rrjedhë logjike. Që të arrihet shkallë më e lartë e pyetësorëve të përgjigjur, pyetësorin duhet ta strukturoni në mënyrën vijuese:

- Vendosni pyetjet më të rëndësishme në gjysmën e parë të pyetësorit – me këtë do të siguronit informatat më të rëndësishme nga ata që nuk do ta përfundojnë pyetësorin (do të ketë dhe të tillë);
- Pyetjet duhet të kenë rrjedhë logjike, njëra pas tjetrës;
- Hulumtuesi duhet të sigurohet që përgjigja ndaj

njëres pyetje nuk është nën ndikim të pyetjeve paraprake (Kjo në parim do të thotë se pyetjet nuk duhet ti orientojnë përgjigjet);

- Pyetjet duhet të jenë të radhitura nga ato më të përgjithshmet drejt atyre më specifike;
- Pyetjet duhet të parashtrohen nga ato më pak të ndjeshmet në ato më të ndjeshmet;
- Pyetjet duhet të rrjedhin nga pyetjet faktike dhe bihevioriste drejt pyetjeve që kanë të bëjnë me pikëpamjet dhe qëndrimet.

Rregulla themelore për konstruktimin e pyetësorit

- Pyetjet duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme, të mos jenë dykuptimshme – duhet të interpretohen vetëm në një mënyrë;
- Shfrytëzoni deklaratat pozitive dhe shmanguni deklaratave negative;
- Në rast të pyetjeve të ndjeshme, shfrytëzoni forma neutrale (as pozitive e as negative), me se do të siguroheni që nuk do të ndikoni ndaj përgjigjes;
- Përshtateni pyetësorin ndaj moshës së të anketuarit;
- Shfrytëzoni fjalë të qarta dhe të kuptueshëm të cilët mund ti kuptojë një nxënës mesatar në moshë adekuate;
- Shfrytëzoni fjali gramatike dhe grafike të sakta me

shenja pikësimi në vendin e duhur (kontrolloni dy herë, e pastaj jepjani dikujt tjetër ta kontrollojë atë që është shkruar);

- Shmangni deklaratat të cilët përfshijnë më tepër se dy pyetje (për shembull: Dëshironi dredhëza apo patate?);

Gjatësia e pyetësorit

Numri i pyetjeve në një pyetësor varet nga qëllimet e hulumtimit dhe lloji i hulumtimit (për shembull, anketat e thjeshta mund të kufizohen në disa pyetje, derisa hulumtimi anketues ka nevojë për instrumente më të ndërlikuara). Edhe pyetësorët e shkurtë edhe ata të gjatë kanë përparësitë dhe mangësitë e tyre. Si rregull e përgjithshme, pyetësorët e gjatë kanë shkallë më të ulët të pyetjeve tërësisht të përgjigjur, përkundër pyetësorëve të shkurtër. Por, nga ana tjetër, pyetësorët e gjatë mun-

dësojnë informata më të gjera, më komplekse dhe më të detajuara për lëndën e hulumtimit, ofrojnë mundësi për kontroll të korrelacioneve ose ndërvarësisë midis variablave. Po ashtu, vlefshmëria/besueshmëria është më e madhe për faktin se ne mund të fusim pyetje kontroluese (pyetje të cilët e kanë poentën e njëjtë sikur disa pyetje paraprake vetëm që janë të formuluar më ndryshe, dhe kështu mund të kontrollojmë nëse përgjigjet përmbajnë apo nuk përmbajnë kundërthënie).

Pyetësorët e shkurtë kanë një përparësi të madhe – ata kanë shkallë të lartë të përgjigjeve tërësisht të përgjigjur.

Mënyrat më të shpeshta të zbatimit të pyetësorit janë:

- zbatimi i pyetësorit ballë për ballë (personalisht) – kur anketuesi i lexon pyetjet dhe i regjistron përgjigjet;
- plotësim i pavarur i pyetësorit – kur i anketuari i lexon pyetjet dhe i shënon përgjigjet në mënyrë të pavarur.

Pyetësori po ashtu mund të zbatohet përmes internetit, telefonit ose postës.

Përpunimi i të dhënave

Procedimi i të dhënave përfshin përpunim, kodim, regjistrim dhe vërtetim të të dhënave, si dhe kontroll të qëndrueshmërisë së tyre. Regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave ndodh paralelisht me grumbullimin e të dhënave, me se mundësohet kontrolli i cilësisë së të dhënave të grumbulluara, si dhe konfirmimi i rezultateve preliminare një muaj pas përfundimit të procesit të grumbullimit të dhënave. Pajtohuni cilën pako statistikore dëshironi ta shfrytëzoni (si SPSS, Stata, EpiInfo, Excel, Access) dhe vendosni për sistemin e kodimit para se dikush të fillojë të punojë në kompletin e të dhënave.

Analiza e të dhënave përfshin përdorim të teknikave statistikore për identifikimin e korrelacionit midis përgjigjeve të dhëna (për shembull, analizë e frekuencave, korrelacioneve, devijimit dhe analiza faktoriale).

Interpretimi i të dhënave

Pasi keni përfunduar me analizën e të dhënave, ju do të duhet të mendoni në mënyrë kreative se si më qartë dhe më shkurtimisht ti prezantoni gjetjet e juaja në raport.

Dizajni në vijim është një format i propozuar për mënyrën e të shkruarit të një raporti nga hulumtimi:

- Faqja kryesore (Kopertina)
- Përmbajtja
- Hyrja
 - Historiku i problemit të hulumtimit
 - Qëllimet e përgjithshme dhe specifike
 - Hipotezat
- Metodologjia/grumbullimi i të dhënave
 - Примерок и метод на изведување на примерок
 - Mostra dhe metoda e kryerjes së mostrës
 - Metodatat statistikore dhe sasiore të përdorura për analizën e të dhënave
 - Përshkrimi i mostrës
- Gjetjet

- Rezultate, interpretimi, përfundime dhe rekomandime
- Lista e tabelave
- Lista e grafikoneve

Kur përgatitet raporti përfundimtar, ne duhet ti kemi parasysh rregullat në vijim:

- Bëhuni të sigurt se të gjithë përfundimet janë qartë të mbështetura me të dhënat.
- Raporti përfundimtar përmban informata të bazuara në fakte. Bëni dallim të qartë midis fakteve dhe interpretimeve. Përmes anketës gjithmonë fitohen perceptime, e jo fakte. Faktet grumbullohen me analizë të dokumenteve, të dhënave statistikore dhe studime tjera.
- Qartësoni cilat të dhëna i keni përdorur për mbështetje të interpretimeve të juaja.

Prezantimi i të dhënave

Tabelat dhe grafikët të cilët janë të thjeshta për tu kuptuar, në mënyrë të dukshme do ta përmirësojnë leximin e raportit me shkrim nga hulumtimi.

3.4. DEBATI NË ARSIM

Çfarë është debati?

Debati është një diskutim i organizuar dhe i argumentuar me rregulla, i cili zhvillohet ndërmjet së paku dy palëve të cilët kanë mendime kundërthënëse ose të ndryshme ose kanë kuptim të ndryshëm për metodën e arritjes deri të një qëllim i caktuar. Debati paraqet mjet i cili e ndihmon procesin e sjelljes së vendimeve në sfera të ndryshme shoqërore.

Në varësi nga fusha në të cilën përdoret debati, imponohen standarde të ndryshme të cilët i klasifikojnë argumentet, teknikat dhe normat e sjelljes në të mira dhe të këqija ose të pranueshme dhe të papranueshme.

Sipas qëllimit për të cilin përdoret debati, e grupojmë në tre sfera: private, shkencore dhe publike.

Debatet në sferën private përfshijnë diskutime ndërmjet bashkëshortëve, partnerëve, prindërve dhe fëmijëve, miqve, nxënësve, kolegëve. Debatin e përdorim në këto sfera private për të diskutuar për mospajtimet të cilët paraqiten në jetën e përditshme dhe të negociojmë për to. Këtu debati nuk është i kufizuar nga rregullat formale të debatimit dhe nuk ekzistojnë kritere që i klasifikojnë argumentet në të mira dhe të këqija dhe as normat e sjelljes në të pranueshme dhe të papranueshme për sa kohë nuk devijojnë nga rregullat e sjelljes të pranuar shoqërore nga bashkësia të cilës i takojnë folësit.

Debatet shpesh përdoren edhe në sferën shkencore dhe përfshijnë pjesëmarrës që ndajnë një fushë të përbashkët të ekspertizës. Nëse duan të marrin pjesë në këto debate, pjesëmarrësit duhet të posedojnë njohuri të detajuara për lëndën e diskutimit dhe një fjalor preciz të domosdoshëm për komunikim të koncepteve shkencore të cilët diskutohen. Shpeshherë debatet të cilat

zhvillohen në komunitetin shkencor bëhen të rëndësishme edhe për sferën publike dhe debati rrjedh nga komuniteti shkencor në atë shoqëror. E tillë është për shembull tema për ngrohjen globale dhe arsyet e pasojat që rrjedhin nga kjo dukuri.

Debatet në sferën publike krijohen ndërmjet qytetarëve, institucioneve (të mishëruar në përfaqësuesit e tyre), organizatave qytetare, mediave dhe faktorëve tjerë shoqëror publik dhe paraqesin element thelbësor të shoqërisë demokratike. Në shoqëritë demokratike, debati shoqëror nuk është vetëm një formë e të shprehurit por edhe formë e bindjes. Debatit nuk prodhon njëzëshmëri të menjëhershme, por me kalimin e kohës mund të prodhojë kompromis, harmonizim të qëndrimeve, gjetje të emëruesit të përbashkët, shumë më rrallë – konsensus dhe ndryshim të perceptimeve, qëndrimeve të caktuara, ose interpretimit të gjërave.

Çfarë është debati i strukturuar?

Debatit i strukturuar është ai debat i cili zhvillohet në një atmosferë të kontrolluar ku ekzistojnë rregulla të caktuara që vlejnë për të gjithë pjesëmarrësit në debate dhe garantojnë diskutim të drejtë dhe hapësirë të barabartë në tezën përkatëse dhe me një strukturë të përshtatshme. Në debatin e strukturuar folësit duhet të jenë të kujdesshëm, ti përmbahen temës së saktë që u është dhënë, deri te koha që e kanë në dispozicion për të folur, e deri te argumentet të cilët i përdorin gjatë debatit.

Këtë lloj të debatit (i cili dallon nga diskutimi) e hasim në emisione debative ose në debate të organizuara publike me rregulla të përcaktuara saktësisht të fjalës. Për më tepër, ky lloj debati gjendet edhe në arsimin formal, i cili përdoret për qëllime edukative dhe mban emrin debat konkurrues.

Çfarë është debati konkurrues?

Debatit konkurrues është disiplinë shkollore dhe akademike e cila përdoret si vegël në arsimimin e nxënësve përmes zhvillimit të argumentimit dhe mendimit kritik. Debatit është konkurrues meqë për të organizohet turnirë në të cilët vendoset për më të suksesshmin e garës. Ashtu siç ka gara nga matematika ose këndimi në kor, po ashtu ka edhe gara në debat në ose ndërmjet shkollave. Por, ky lloj i debatit nuk përdoret vetëm për qëllime konkurruese. Përkundrazi, qëllimi primar i përdorimit të debatit në arsimin formal është edukativ. Përmes përdorimit të debatit, profesori duhet të synojë zhvillimin e aftësive të nxënësve për argumentim, aftësive për lidhshmëri dhe punë ekipore, aftësive për komunikim, fjalim publik dhe mendim kritik.

Dallimi midis debatit në sferën publike dhe debatit konkurrues është dallimi në formë. Debatit konkurrues karakterizohet me formalitet të strukturës, kufizim të konfliktit, diskutim dhe rezultat të argumentuar, i cili është rezultat i vendimit të gjykatësit.

1. Formaliteti i strukturës

Debatit konkurrues është debat formal, diskutim i organizuar me rregulla. Në varësi nga formati, çdo debat ka rregullat e veta të cilët kanë të bëjnë me numrin e palëve në debat, numrin e ekipeve, numrin e folësve, kohëzgjatjen dhe renditjen e fjalimeve. Mungesa e strukturës formale shpeshherë ndërlikohet me përkufizimin joadekuat ose jo konkret të konfliktit. Që një debat të jetë i strukturuar dhe i organizuar me konflikt të përkufizuar konkret, është e domosdoshme që ai të përmbajë një tezë të qartë, eksplicite dhe konkrete.

2. Kufizimi i konfliktit

Thelbi i debatit nuk përbëhet nga konflikti midis të mirës dhe të keqes, e as edhe nga konflikti midis të vërtetës dhe gënjeshtërisë apo konflikti midis fakteve dhe mendimeve. Përkundrazi, thelbi i debatit përbëhet nga përplasja e vlerave dhe parimeve. Marrë në mënyrë të pavarur, secili parim ka vlerë dhe vlefshmëri dhe meriton mbështetje në formën e argumentimit. Por kur dy parime të vlefshme janë në konflikt, duhet të merret vendim se cili prej tyre është më i rëndësishëm. Në këtë pretendim qëndron thelbi i debatit. Nëse nuk do të kishte konflikte, nuk do të ekzistonin debatet.

3. Diskutimi i argumentuar

Në debatin konkurrues, argumentimi i jep debatit vlerë intelektuale. Qëndrimet e debutuesve duhet të jenë të arsyetuar përmes pretendimeve të argumentuara të cilët duhet të sqarohen dhe mbështeten me fakte. Nëse debati është proces në të cilin qëndrimet janë të përfaqësuara, mbështetura, sfiduara dhe të mbrojtura, që të ndodhin këto veprime, argumentet duhet të posedojnëtribute të caktuara: zhvillim (përmes të cilit argumentet janë të përfaqësuara dhe të mbrojtura), përplasja (përmes të cilës argumentet janë të sfiduara në mënyrë adekuate), zgjatje (përmes të cilës argumentet mbrohen pas përgënjeshtëritimit) dhe perspektivë (përmes të cilit argumentet individuale ndërlikohen me vlera më të mëdha).

4. Vendimi gjyqësor

Në fushat e tjera të shoqërisë, debati shpesh përcillet me vota: votohet për kandidatë, për politika ose për ligje. Të gjithë debutuesit janë të interesuar ti bindin dëgjuesit e tyre. Nga ana tjetër, debatuesit konkurrues janë të interesuar ti bindin gjykatësit e tyre. Puna e gjykatësit (është të vendos cila anë – pohuese ose mohuese – është më bindëse gjatë debatit.

Por, siç u përmend më lartë, debati konkurrues nuk është lloji i vetëm i debatit. Në debatet publike ose prezantuese ku qëllimi nuk është gara, debati përdoret për ngritje të vetëdijes ose të sfidohet publiku, të pranishmit të mund të ndërtojnë qëndrim ose të vendosin në mënyrë të pavarur se cila palë i ka bindur ose u ka hapur çështje për të cilët debatohet.

Në pajtim me nevojat e këtij Udhëzuesi, më poshtë vijon një shtjellim më i detajuar i tre veçorive të para:


1. Formaliteti i strukturës – formati i debatimit


Debati paraqet një diskutim të organizuar, që do të thotë se pjesëmarrësit në të (debatuesit) i nënshtrohen respektimit të një sistemi të përcaktuar rregullash që e karakterizojnë formatin e debatit.


Formati i një debati është një sistem rregullash që tregojnë numrin e saktë të folësve që marrin pjesë në debat, mënyrën e prezantimit, kohëzgjatjen e fjalimeve dhe mënyrën e marrjes së vendimit gjyqësor. Në debatin akademik ekzistojnë shumë formate, ku një nga dallimet kryesore midis tyre është numri i ekipeve dhe numri i folësve në ekipe, i cili mund të sillet prej një folësi në ekip. Formatin e cili gjen zbatim më të madh në kuadër të debatit të shkollave të mesme në mjedis formal është formati Uorlld skulls (World Schools Style), ndërsa në disa mjedise zbatohet edhe formati Karl Poper.


Për nevojat e këtij Udhëzuesi do të prezantohet një format i cili devijon nga Karl Poper dhe Uorlld skulls, respektivisht fillimisht do të prezantohet një format më i thjeshtë me tre folës dhe fjalime pesëminutësh, i përshtatur për debat për nxënësit të cilët nuk kanë përvojë paraprake.


Renditja e fjalimeve

 **Folësi i parë pohues**
– flet 5 minuta.

 **Folësi i parë mohues**
– flet 5 minuta.


 **Folësi i dytë pohues**
– flet 5 minuta.

 **Folësi i dytë mohues**
– flet 5 minuta.

 **Folësi i tretë pohues**
– flet 5 minuta.

 **Folësi i tretë mohues**
– flet 5 minuta.

Folësi i parë pohues e fillon debatin përmes prezantimit të rastit pohues të përbërë nga definicione për tezën e cila debatohet dhe argumente që e mbështesin tezën dhe ka kohë prej 5 minuta.



EKIPI POHUES
(Ekipi i cili e mbështet tezën)



EKIPI MOHUES
(Ekipi i cili e mohon tezën)

Gjatë një debati, debutuesit diskutojnë në dy ekipe kundërshtare, secili i përbërë prej tre folësve, të cilët e përfaqësojnë anë pohuese ose mohuese të tezës së propozuar. Çdo folës flet njëherë, palët e kundërshtuara flasin me radhë dhe secili folës ka rol specifik në debat.

Në debate më pak të strukturuar, të cilët mund të jenë të karakterit prezantues ose provues, është e mundur të ndryshojë edhe numri i anëtarëve në ekipe në më pak ose më tepër debatues, për sa kohë që numri i debutuesve është i njëjtë në secilin prej ekipeve të ndryshme.

Folësi i parë mohues ka për detyrë të prezantojë rastin e ekipit mohues (ekipi i cili e mohon tezën) dhe ta sulmojë rastin e ekipit pohues përmes përgënjeshtimit të argumenteve të cilët janë paraqitur nga folësi i parë pohues dhe ka kohë prej pesë minutash.

Folësi i dytë pohues dhe folësi i dytë mohues kanë qëllim parësor të theksojnë pikat e përplasjes në debat, përmes përqendrimit të debatit në dallimet kryesore midis qëndrimeve të palës pohuese dhe mohuese. Folësit e dytë kanë kohë më të shkurtë nga të parët dhe flasin pesë minuta, brenda të cilëve duhet të sulmojnë argumentet e palës së kundërt dhe të mbrojnë argumentet e paraqitura nga folësit e parë nga ekipi i tyre.

Folësi i tretë pohues dhe folësi i tretë mohues, të cilët flasin pesë minuta, janë njëkohësisht edhe folësit përmbyllës në debat, të cilët nuk përfshihen në përgënjeshtrimin (sulmimin) dhe refuzimin (mbrojtjen) klasik të argumenteve që kanë qenë të ekspozuar nga folësit pararendës. Në këto fjalime tentohet të tregohen pikat e përplasjes që janë diskutuar më së shumti dhe më relevante në debat, me qëllim të bindet gjykatësi që ekipi të cilin ata e përfaqësojnë ka mbizotëruar në diskutim.

Në formatin e shkollës së mesme Karl Poper koha për fjalim është 6 minuta, ndërsa në Uorlld skulls është 8

minuta për një fjalim. Për debate provuese ose prezantuese koha për folës mund të jetë e ndryshme (sidomos për fillestarët ku mund të shkurtohet edhe në 3 ose 4 minuta). Kur modifikohet formati, më me rëndësi është që koha për çdo fjalim të caktohet paraprakisht dhe të jetë e njëjtë për çdo folës në debat.

2. Kufizimi i konfliktit – tezës së debatimit

Termi tezë, ose rezolutë, buron nga fjala e lashtë greke “thesis” që do të thotë një pretendim ose përcaktim që kërkon prova ose anim. Sot termin tezë e interpretojmë si një temë e cila duhet të dëshmohet, temë e cila duhet të debatohet, më saktësisht e cila shqyrtohet nga ana pohuese (ana e cila e mbështet tezën) dhe mohuese (ana e cila e mohon tezën).

Shumë shpesh në debatet dhe diskutimet publike ndodh të debatohet për një tezë të vendosur keq, tezë që nuk lejon debat cilësor dhe të balancuar dhe pikërisht për këtë diskutimet marrin drejtim të gabuar. Për shembull, teza „Arsimi i mesëm duhet të jetë i obligueshëm” paraqet një pretendim mund të mbështetet ose refuzohet (të pohohet ose të mohohet) dhe me këtë mundësohet debat cilësor rreth thelbit të problemit konkret. Në këtë tezë, pala pohuese do ta mbështesë tezën se arsimi i mesëm duhet të jetë i obligueshëm përmes argumenteve që i sqarojnë përfitimet e të gjithë palëve të interesuara nga arsimi i mesëm i obligueshëm (fëmijë, prindër, ekonomia në shtet, shoqëria, etj.), ndërsa pala mohuese do ta mohojë tezën dhe do të argumentojë se arsimi i obligueshëm nuk duhet të jetë i detyrueshëm, duke synuar gjatë kësaj ti dëshmojë efektet negative nga arsimi i obligueshëm.

Ekzistojnë disa veçori të cilët duhet ti përmbajë një tezë e mirë:

Teza duhet të jetë e prekshme

Shembull për tezë të paprekshme është: „Është e arsyeshme se ekziston jetë në Mars”. Kjo tezë është e paprekshme, meqë nuk kemi dëgjuar për asnjë të dhënë që na e bën me dije faktin që ekziston jetë në planetin e kuq. Shembull për tezë të prekshme është: „Votimi duhet të jetë i obligueshëm”. Kjo tezë është shumë e prekshme, meqë votimi është e drejtë themelore demokratike e cila si i tillë mësohet në arsimin formal dhe faktet që lidhen me të mund të hulumtohen lehtë.

Teza duhet të jetë bashkëkohore dhe aktuale

Shembull për tezë jo aktuale: „Gjermani nuk bëri mjaftueshëm për ti kompenzuar dëmet nga Lufta e dytë botërore”.

Shembull për tezë aktuale: „Dënimi me vdekje është i arsyeshëm”.

Në tezën „Zhvillimi ekonomik duhet të kufizohet që të mbrohet mjedisi jetësor”, terme të cilët duhet të definohen janë: zhvillim ekonomik, mjedisi jetësor, mbro dhe përkufizo. Kështu termat, zhvillimi ekonomik dhe mjedisi jetësor janë terme të njohura gjerësisht, të cilët po ashtu mund të përcaktohen duke përdorur leksikon dhe fjalorin. Por, termet mbro dhe përkufizo edhe pse janë gjerësisht të njohura, mënyra e përkufizimit të tyre do ta përcaktojë drejtimin e debatit. Respektivisht, shpesh ndodh fjalët që e përbëjnë tezën në aspekt etimologjik dhe përmbajtjesor të kenë më shumë se një kup-

tim. Në disa raste, ato kanë një shtrirje dhe interpretime të vogla, ndërsa nganjëherë një shtrirje të gjerë të përkufizimeve të mundshme të kuptimit të tyre në kontekstin e vetë tezës. Pikërisht për këto arsye përkufizimet që do të propozohen në fillim të debatit duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme, respektivisht duhet të sqarohet saktë interpretimi i tyre. Për shembull, në rastin tonë termi mbro mund të përkufizohet si ulje e shkallës së ndotjes së ujërave, tokës dhe ajrit ose si menaxhim i përgjegjshëm i burimeve të joripërtëritshme ose termi kufizo mund të përkufizohet si mbyllje e zonave ekonomike zhvillimore ose vendosje e sanksioneve për ato subjekte afariste që prodhojnë materie të dëmshme të cilët e ndotin mjedisin jetësor. Gjithsesi, si do të përkufizohen termet u mbetet ekipeve të vendosin (fillimisht ekipit pohues) dhe nga ato përkufizime do të varet rrjedha dhe cilësia e debatit.

3. Diskutimi i argumentuar

Argumentimi është themeli i çdo debati të organizuar me të cilin ballafaqohemi dhe që e bën dallimin ndërmjet debatit si formë e organizuar e kundërshtimit të mendimit dhe llojeve të këmbimit të mendimeve tek të cilët është e domosdoshme të ketë argument. Argumentet paraqesin arsyet përse një ekip mbështet (pohon) ose sulmon (mohon) një tezë të caktuar. Argumentet përfshijnë një proces gjithëpërfshirës të krijimit të pretendimeve dhe arsytimit me anë të mendimit logjik dhe dëshmime. **Argumenti është mënyrë e të folurit ku deklarata të caktuara (arsye ose supozime) ofrohen si mbështetje e deklaratave tjera (pohime ose konkluzione).**

Çdo argument duhet ti përmbajë elementet në vijim:

Pohimi: Pohimi është emri i argumentit, titulli i argumentit, respektivisht pohimi që është i dobishëm ose kundërshton tezën të cilën e debatojmë. Pohimi është supozim, deklaratë që duhet të dëshmohet më tej gjatë shtjellimit të argumentit tonë përmes sqarimit dhe provave.

Sqarimi: Sqarimi është logjika e cila qëndron pas pohimit tuaj, respektivisht lidhja të cilën e bëni midis pohimit dhe vetë provave. Sqarimi mund të jetë një ose më tepër ide që e dëshmojnë pohimin. Sqarimi është dhënia e përgjigjes ndaj pyetjes „Pse?” kundrejt pohimit tuaj.

Dëshmia: Dëshmitë përdoren për ti dhënë besueshmëri dhe peshë plotësuese sqarimit për pohimin tuaj. Prandaj ata janë pjesë e rëndësishme e argumentit në tërësi, që kontribuojnë për bindshmërinë e pohimit. Lloji i dëshmime mund të ndryshojë nga shembujt përmes analogjive, citate, deklarata, prova statistikore, etj.

Lidhjet: Të gjithë elementet në një argument duhet të jenë të lidhura. Kjo në fakt do të thotë se sqarimi duhet të ketë për qëllim të dëshmojë pohimin, ndërsa dëshmitë duhet të shkojnë në dobi të përmirësimit të vetë sqarimit. Së bashku ata duhet të krijojnë një tërësi koherente që pohimi të mund të dëshmohet.

Për shembull: E paraqitur me një shembull të mirë në tezën, „ShBA duhet ta shfuqizojë dënimin me vdekje”, argumenti do ti kishte përmbajtur pjesët në vijim të cilët janë të lidhura reciprokisht:

Pohimi: Dënimi me vdekje lë rrezik që të ekzekutohen njerëz të pafajshëm.

Sqarimi: Për shkak të ngarkesës së madhe, sistemi penal i ShBA nuk mundëson shpërndarje të drejtësisë së barabartë për të gjithë të akuzuarit. Në shumë raste, mbrojtja, e cila u caktohet të pandehurve nga shteti, nuk janë mjaftueshëm të përgatitur dhe nuk kanë burime të mjaftueshme për të mbrojtur klientët e tyre dhe shpesh e humbin rastin. Disa nga këta klientë - të pandehur u nënshtrohen akuzave për të cilët dënimi është me vdekje.

Dëshmi: Raportet e Qendrës për informata për dënimet me vdekje nga viti 1973 deri në 2008, thonë se 130 individë të cilët kanë qenë të dënuar me vdekje, janë liruar. Dënimet e tyre janë shfuqizuar dhe të gjithë akuzat kundër tyre janë hedhur poshtë. Këtyre njerëzve të pafajshëm mund tu ishte ekzekutuar dënimi me vdekje.

Argumentimi përdoret edhe gjatë sulmimit të argumenteve të ekipit kundërshtar. Respektivisht, me qëllim që ekipi të fitojë në debat, përpos prezantimit dhe mbështetjes së argumenteve personale është e nevojshme që ti sulmojë argumentet e ekipit kundërshtar. Ky element në debat quhet përgënjeshttrim.

Përgënjeshtrimi është pohim i cili përdoret për ti sulmuar dhe minuar argumentet e kundërshtarëve dhe për të nxjerrë në pah dhe shpjeguar mospërputhjet në rastin e ekipit kundërshtar. Një mënyrë që ta bëni këtë është përmes procesit „hap pas hapi“ i përbërë prej katër elementeve:

Identifikimi: Identifikojeni pohimin të cilin e sulmoni. Në një debat do të ketë më tepër argumente, dëshmi dhe ngarkesa të cilët debatuesi duhet ti adresojë. Me identifikim të qartë të atij argumenti të kundërshtarit të cilin e sulmoni, fjalimi juaj fiton strukturë më të madhe.

Sqarimi: Pasi të keni identifikuar argumentin të cilin dëshironi ta sulmoni, duhet të sqaroni cilët janë mangësitë e tij logjike ose përse pretendimi i shprehur nga ana e kundërshtarit nuk është i saktë.

Mbështetja: Shumë argumente do të mbështeten me dëshmi, por këto dëshmi jo gjithmonë janë relevante. Detyra juaj është ti gjeni mangësitë në dëshmitë (pa dallim nëse kjo do të thotë që ata mund të jenë të vjetërsuara ose të vijnë nga një burim i gabuar) ose të ofroni dëshmi që shkojnë në favor të palës suaj.

Krahasimi: Sqaroheni rëndësinë e argumentit tuaj. Që të sjell gjykimin, gjykatësi duhet ta njoh rëndësinë kooperative dhe cilësinë e argumenteve tuaja në krahasim me ata të ekipit kundërshtar

Si organizohet një debat konkurrues me nxënësit?

Para debatit (i cili është pjesa praktike e orës) profesori duhet të japë një përmbledhje teorike të njësies mësimore. Respektivisht, fillimisht profesori duhet t'ua sqarojë nxënësve dallimin midis debatit të strukturuar dhe diskutimit. Pastaj duhet t'ua sqarojë elementet e një debati. Radhitja e temave duhet të jetë si në vijim:

1. Të sqarohet dallimi midis tezës dhe temës;
2. Të sqarohet çfarë janë argumentet dhe si formohen argumentet;
3. Të sqarohet formati në të cilin do të debatojnë nxënësit;
4. Të vendosen rregullat bazike të cilët nuk duhet të shkelen (rregullat e shkualifikimit).

Para debatit profesori duhet ta tregojë tezën për të cilën do të debatohet. Pastaj merr gjashtë vullnetarë të cilët duhet të vendosin në cilin ekip do të marrin pjesë (ekipi që e mbështet ose ekipi që e mohon tezën). Ekipeve u jepet së paku një ditë për tu përgatitur për debatin e ardhshëm. Rekomandohet që nxënësit ti përpunojnë fjalimet e tyre si ekipe, domethënë të gjithë anëtarët e ekipit pohues së bashku ti krijojnë argumentet dhe rastin e tyre. E njëjta gjë vlen edhe për ekipin mohues.

Shembuj për teza:

1. „Duhet të prezantohen uniformat shkollore“.
2. „Arsimi i lartë duhet të jetë pa pagesë“.
3. „Duhet të ndalohen video-lojërat e dhunshme për fëmijë“.
4. „Mosha e votimit duhet të zvogëlohet në 16 vjet“.
5. „Duhet të shfuqizohet shkollimi i mesëm i obligueshëm“.

Gjatë debatit nxënësit duhet të flasin para nxënësve tjerë. Në anën e majtë të hapësirës (shikuar nga ana e nxënësve që ndjekin debatin) gjendet ekipi pohues, ndërsa në anën e djathtë ekipi mohues. Folësi i cili flet në çastin e dhënë, duhet të qëndrojë në mes midis dy ekipeve ose në foltore, bankë ose në ndonjë vendndodhje tjetër për fjalim.

Njëri nga nxënësit që nuk marrin pjesë në debat ose profesori mund të bëjnë matjen e kohës së mbetur për çdonjërin nga fjalimet dhe në mënyrë vizuale t'ua bëjë me dije folësve kohën që u ka ngelur për fjalimin.

4.

MODULE PËR PUNËTORI DHE TRAJNIME ME NXËNËS

4.1. Punëtori: Kam të drejtë të njoh të drejtat e mia

Materiali i nevojshëm:

- fletë e madhe pune në të cilën shkruan: Meqenëse jam fëmijë kam të drejtë për ...,
- fletë pune për nxënësit: Vizatime me të drejtat e fëmijëve,
- kuti,
- shirit ngjites,
- pajisje për ngjyrosje,
- fletë e madhe letre,
- shkumës,
- dërrasë.

Aktiviteti kryesor

Fleta e madhe me fjalinë e papërfunduar „Meqë jam fëmijë kam të drejtë për...“ ngjitet në dërrasë.

Arsimtarja thotë: „Tani së bashku do të mendojmë cilat janë të drejtat që u takojnë fëmijëve. Çdokush mund ti thotë të gjithë idetë që do ti kujtohen.“

Arsimtarja i shënon në dërrasë të gjithë idetë dhe i komenton së bashku me fëmijët. Pastaj edhe njëherë i lexon idetë e shënuara.

Diskutim

1. Çfarë do të thotë kur do të thuhet se dikush ka të drejtë për...?
2. A mund vetëm unë të kem të drejtë për diçka, ndërsa të tjerët jo?
3. A dini ndonjë vend të posaçëm ku shënohen të drejtat e fëmijëve?
4. Çfarë do të kishte ndodhur po të mos i kishim këto të drejta?
5. Kush na garanton që mund ti përmbushim të drejtat?

Konkluzion

Të kesh të drejtë do të thotë se ke diçka, mund të bësh, duhet të marrësh, duhet të tjerët ta bëjnë për ty.

Ka një dokument i cili vlen për të gjithë fëmijët në tërë botën dhe quhet Konventa për të drejtat e fëmijës. Në këtë ligj janë përshkruar të drejtat e fëmijëve, aty është shkruar gjithçka për atë që mund ta bëjnë fëmijët dhe gjithçka që duhet ta bëjnë të rriturit të cilët janë përg-

jegjës për ti bërë fëmijët të lumtur, të shëndetshëm dhe të sigurt. Në të gjithë ligjet ka pjesë të cilët quhet nene. Edhe në Konventë ka nene. Në çdo nen është shkruar nga një e drejtë që e posedojnë fëmijët. Shteti garanton se çdo fëmijë në territorin e tij do ti gëzojë këto të drejta.

4.2. Modul për punëtori: Vendimi im, vendimi yt

Materiali i nevojshëm:

- dërrasë,
- shkumës,
- fletë pune për nxënësit: Ligji për të drejtat.

Aktiviteti hyrës

Në dërrasë vizatohet një tabelë me dy reshta dhe katër kolona në atë mënyrë që formohen 8 katrorë identik. Çdokush në një fletëz shënon numrin e përgjithshëm të katrorëve që i sheh. Në fund nxënësit tregojnë se sa katrorë kanë gjetur, deri sa të arrihet te numri prej 11 katrorësh (së bashku me katrorët në të cilët gjinden katrorët më të vegjël të vizatuar), pastaj bashkërisht gjenden në vizatimin në dërrasë.

Aktiviteti kryesor

Secilit nxënës i jepet fleta e punës „Ligji për të drejtat“, me udhëzim që secili të zgjedh 5 nga 20 të ofruarat, të cilët i konsideron si më të rëndësishme. Pastaj krijohen çifte dhe në to nxënësit duhet të merren vesh për një listë të përbashkët prej 5 të drejtave më të rëndësishme. Pas 6–7 minutash bashkohen nga dy çifte dhe në këtë mënyrë formohen katër grupe nga katër, të cilët do të duhet të merren vesh për një listë të përbashkët prej 5 të drejtave më të rëndësishme.

Në fund, secili grup i prezanton 5 të drejtat e tyre të zgjedhura dhe gjatë kësaj tregon se në çfarë mënyre kanë arritur deri te vendimi se cilët 5 të drejta ti vendosin në listë.

Diskutimi

1. Kur e kishit më të lehtë të merrni vendim cilët 5 të drejta ti zgjidhni? Pse?
2. Si u morët vesh për pesë të drejtat më të rëndësishme?
3. Kur e kishit më të vështirë? Pse?
4. Kur ndjeheshit më mirë me vendimin e marrë? Pse?
5. Kur ndjeheshit më keq ose të lënduar për mënyrën e marrjes së vendimit? Pse?

Konkluzioni

Më shpesh, sa më tepër njerëz marrin pjesë në vendim-marrje, aq më vështirë arrihet deri te pajtimi rreth marrëveshjes, respektivisht duhet më tepër kohë për arritje të pajtimit. Por, nganjëherë, marrja e vendimeve në grupe mund të jetë e lehtë dhe e shpejtë nëse shumica e pjesëmarrësve nuk përqipen shumë, respektivisht pajtohen me atë që do ta thotë njëri prej tyre.

Kur kontribuojmë në marrjen e vendimeve, kur të tjerët na pyesin për mendim dhe kur mendimet tona merren parasysh, atëherë ndjehemi mirë me marrjen e vendimeve.

Kur vendimi është i rëndësishëm për ne, e megjithatë mendimet tona nuk merren parasysh, por dikush tjetër vendos siç dëshiron, atëherë mund të ndjehemi keq, madje edhe të lënduar me vendimin e marrë.

Reflektimi

1. Çfarë bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çfarë mësuam?
4. Si mund ta shfrytëzojmë atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune për punëtorinë „Vendimi im, vendim yt“

Të drejtat e fëmijëve

1. E drejta për emër personal, kujdes dhe shtetësi.
2. E drejta për shtëpi dhe ushqim.
3. E drejta për liri të shprehjes e cila përfshin edhe lirinë për të kërkuar, pranuar dhe për të dhënë informata dhe ide.
4. E drejta për liri të mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit.
5. Liria për shoqërim dhe tubim paqësor.
6. Ndalimi për përzjerje në jetën private ose familjare të fëmijës dhe korrespondencës së tij personale.
7. Ndalimi për sulme ndaj nderit dhe reputacionit të tij.
8. E drejta për qasje në shërbimet mjekësore dhe kujdes të përhershëm shëndetësor.
9. E drejta për qasje në informata, sidomos në ato që shërbejnë për avancimin e të mirave të tija sociale, shpirtërore dhe morale dhe shëndetit fizik mendor.
10. E drejta për arsim.
11. E drejta e secilit fëmijë për shfrytëzim të mbrojtjes sociale.
12. E drejta e fëmijës për pushim dhe kohë të lirë, për lojë dhe rekreacion dhe pjesëmarrje të lirë në jetën kulturore dhe në art.
13. E drejta e fëmijës për mbrojtje nga shfrytëzimi ekonomik dhe puna e cila mund të jetë e rrezikshme dhe e cila e pengon arsimin e fëmijës ose e dëmton shëndetin e fëmijës.
14. Mbrojtja e fëmijëve nga përdorimi i paligjshëm i nar-

kotikëve dhe substancave psikoterapi.

15. Mbrojtja e fëmijëve nga të gjithë format e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual.
16. Mbrojtja e fëmijëve nga të gjithë format e përdorimit të gjërave të dëmshme për mirëqenien e fëmijës.
17. Respektimi i rregullave të së drejtës ndërkombëtare humanitare të cilat zbatohen në konflikte të armatosura, dhe kanë të bëjnë me fëmijën.
18. Përbajtja nga rekrutimi në forcat e armatosura të personave që nuk kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç.
19. Mbrojtja dhe kujdesi për fëmijët e goditur nga konfliktet e armatosura.
20. E drejta e çdo fëmije për të cilin pretendohet ose është vërtetuar apo është i akuzuar për shkelje të ligjit penal, të trajtohet në një mënyrë që është në pajtim me nxitjen e ndjenjës së tij për dinjitetin dhe vlerë dhe respektim të të drejtave dhe lirive të njeriut.

4.3. Modul për punëtorin: Ndërmarrja e veprimeve në shkollë

Materiali i nevojshëm:

- fletë pune për nxënësit: Çfarë do të donit të jetë ndryshe në shkollë?
- fletë pune për nxënësit: Ndërmarrja e veprimeve
- pajisje për shkrim.

Aktiviteti kryesor

Të gjithë ndahen në grupe të vogla dhe secilit grup i jepet një ekzemplar i fletës së punës për nxënësit: Çfarë do të donit të jetë ndryshe në shkollë? Grupi e plotëson bashkërisht. Theksohet se mund të flasim për gjendje, gjëra që ka/nuk ka në shkollë, si infrastrukturë dhe mjet tjera, por edhe për dukuri që ndodhin në shkollë, respektivisht përqendrim të marrëdhënieve midis pjesëmarrësve të ndryshëm në jetën shkollore.

Pas prodhimit të më tepër ideve, secili grup zgjedh një problem me të cilin do të merren më tej, përmes plotësimit të fletës së punës për nxënësit: Ndërmarrja e veprimeve. Në fletën e punës në kolonën e majtë shënohen gjërat të cilat mund ti ndër marrin nxënësit, ndërsa në kolonën e djathtë shënohen gjëra, parakushte që janë të nevojshme për nxënësit në ndërmarrjen e veprimeve të ofruara në kolonën e majtë.

Pastaj nga një përfaqësues prej secilit grup e prezanton punën e grupit të vet.

Diskutimi

1. Çfarë ishte më lehtë për tu gjetur: problemet të cilët u mundojnë ose të ofroni diçka që ju mund ta bëni në lidhje me problemet?
2. Çfarë lloji të problemeve identifikuat? Më të shumtë janë problemet që kanë të bëjnë me gjendjen në shkollë ose problemet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis nxënësve, arsimtarëve, etj.?

3. Çfarë masash, veprimesh ofruat? A janë gjëra që ndërmerren nga individë ose ndonjë grup, trup i cili i përfaqëson nxënësit?
4. Si reagohet më shpesh në përditshmërinë e shkollës suaj, në plan individual ose grupor?
5. Çfarë lloj reagimi kanë nxënësit në jetën e përditshme të shkollës? A haset më shumë prezantimi gojor i problemeve ose komunikohen në formë të shkruar?
6. Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e njërës, e cilit të mënyrës tjetër të komunikimit?
7. Cilëve njerëz ose struktura mund tu drejtohem kur kemi probleme në shkollë?
8. Përpos në këtë mënyrë, përmes komunikimit për problemet me strukturat relevante, në çfarë mënyrash tjera nxënësit mund të marrin pjesë në jetën e përditshme shkollore me atë që do të shprehin qëndrimin apo mendimin e tyre?

Konkluzion

Ndonjëherë është më lehtë të shihen problemet, sesa të zgjidhen, veçanërisht në situata kur kjo nuk pritet nga ne.

Shpeshherë ndodh nxënësit të reagojnë në mënyrë individuale deri te instancat e caktuara, ose për interesat e tyre individuale ose grupore. Gjatë kësaj, ndodh që reagimet e tilla të mos diskutohen ndërmjet vetë nxënësve ose të mos jenë rezultat i ndonjë vendimi të përbashkët të një grupi nxënësish.

Po ashtu, shumë shpesh reagohet me prezantim gojor të problemeve deri te instancat e caktuara shkollore, ose akoma më shpesh, deri te individë të caktuar.

Kur problemet të cilët na mundojnë prezantohen gojarisht, përparësi është ajo që prezantimi gojor paraqet mënyrën më të shpejtë të reagimit, por nga ana tjetër, ka mangësi në atë që komunikimi reduktohet në „në katër sy“ dhe nuk mbeten dëshmi materiale as nga reagimi, as edhe nga përgjigja ndaj reagimit (nëse ka një të tillë). Kur reagohet në formë të shkruar, mangësi është se kjo kërkon më tepër kohë (të grumbullohet grupi, të silllet përfundim, të shkruhet letra, të pritët përgjigje...), por nga ana tjetër, kjo është e vetmja mënyrë e cila lë dëshmi materiale se jemi marrë me një problem të caktuar. Kjo nga ana tjetër, mundëson vazhdimësi në ndjekjen e një problematike të caktuar (gjatë reagimit të serishëm në lidhje me ndonjë problem, thirrëmi në komunikimin paraprak), ndërsa po ashtu mundëson që për të njëjtin problem të komunikohet me më tepër struktura në të njëjtën kohë (përmes dërgimit të letrës deri te më shumë struktura).

Gjatë problemeve të caktuara, si nxënës mund të drejtohem deri te profesorë individual, kujdestar klase, etj., por edhe deri te struktura të caktuara në shkollë si: shërbimi profesional, këshilli i arsimtarëve, këshilli i prindërve, drejtori. Në formë të shkruar mund të drejtohem deri te sektori komunal për arsim, si dhe edhe deri te Ministria për arsim dhe shkencë.

Në jetën shkollore mund të merret pjesë edhe përmes shkrimit të informatave në buletin e nxënësve, shkrimet të ankesave, vendosjes së kutive për grumbullimin e mendimeve nga nxënësit, zbatimet të anketave, etj.

Reflektimi

1. Çfarë bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çfarë mësuam?
4. Si mund ta shfrytëzojmë atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Fletë pune nga punëtorja: „Ndërmarrja e veprimeve në shkollë“

Çfarë do të donit të jetë më ndryshe në shkollë?

Gjendje/punë/dukuri/marrëdhënie/ide/propozime/probleme

Ndërmarrja e veprimeve

Gjendja/puna/dukuria/marrëdhënia/ideja/propozimi/problemi i zgjedhur

Veprime të cilat mund ti ndërmar	Parakushtet e nevojshme për ndërmarrje të veprimeve

4.4. Modul për punëtorin: Njohja e Konventës për të drejtat e fëmijës

Kohëzgjatja e punëtorisë:	45 minuta
Qëllimi i punëtorisë:	Ombudsmanët e nxënësve të njoftohen me Konventën për të drejtat e fëmijës (mund të përfshihen edhe anëtarët e parlamentit të nxënësve)
Materiale të nevojshme:	Konventa për të drejtat e fëmijëve në gjuhën e fëmijëve

Hapi 1: Njohja me punëtorinë (5 minuta)

Meqenëse kjo është punëtorinë e parë, në fillim sqarohuni fëmijëve sa punëtori do të ketë, cilët janë qëllimet dhe temat e punëtorive dhe çfarë pritet prej tyre. Jepuni mundësi të parashtrajnë pyetje në lidhje me punëtorinë.

Hapi 2: Qëllimi i punëtorisë dhe njohja me Konventën (10 minuta)

Sqaroheni qëllimin e kësaj punëtorie. Hapni diskutim me fëmijët a kanë dëgjuar për Konventën për të drejtat e fëmijës, sa dinë për historinë e saj dhe të ngjashme.

Ndajeni me fëmijët Konventën në gjuhë të përshtatshme me moshën e fëmijëve.

Hapi 3: Historiati i Konventës (10 minuta)

Njoftoni fëmijët me historiat e Konventës. Informata themelore keni më poshtë në nëntitullin Burime. Në mënyrë plotësuese, mund të përfshini informata dhe të dhëna për të cilët konsideroni se do të jenë adekuate për temën. Zgjidhni mënyrën se si do t'ua prezantoni informatat fëmijëve (prezantim përmes projektorit, si diskutim). Me rëndësi është të mbani vëmendjen e tyre dhe t'ua bëni interesante.

Hapi 4: Struktura e Konventës (5 minuta)

Sqarohuni fëmijëve se struktura e Konventës mund të shqyrtohet nga më tepër aspekte, por për funksionin e tyre më të rëndësishëm janë dy: njëri sipas numrit të neneve në Konventë, ndërsa i dyti sipas obligimit të vendeve nënshkruese për respektimin e tij, ti mundësojnë dhe ti mbrojnë të drejtat e fëmijëve të cilët kanë të bëjnë me mbijetesën dhe zhvillimin, mbrojtjen dhe pjesëmarrjen. Informata themelore keni më poshtë në nëntitullin Burime.

Hapi 5: Roli i Konventës (5 minuta)

Sqaroheni rolin e Konventës. Konventa për të drejtat e fëmijës i përmban të drejtat e njeriut të fëmijëve të cilët që tashmë ekzistojnë në dokumente të tjera ndërkombëtare. Por, Konventa i tregon të drejtat e fëmijëve në mënyrë më të kompletuar nga instrumentet tjera dhe siguron udhëzime dhe parime të cilët në thelb i japin formë mënyrës në të cilën ne si të rritur duhet të sigurojmë praktikim, mbrojtje dhe promovim të këtyre të drejtave. Roli i Konventës është të sigurojë që çdo fëmijë në botë ti përmbush të drejtat themelore që i garantohen me këtë Konventë dhe tu ndihmojë të rriturve të mësojnë dhe të kuptojnë se si duhet të veprojnë në interesin më të mirë të fëmijës.

Kë e mbron Konventa? Të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta dhe të gjithë të drejtat kanë rëndësi të

njëjtë. Konventa i referohet secilit fëmijë në mënyrë të barabartë, me mbrojtje të veçantë të grupeve të cënueshme, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara ose fëmijët nga grupet etnike pakicë apo fëmijët që janë të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të dhunës. Konventa e nënkupton përgjegjësinë e fëmijëve për të praktikuar të drejtat e tyre në mënyrë që nuk i cenon ose kufizon të drejtat e të tjerëve. Konventa njeh që prindërit e kanë rolin më të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve përderisa veprojnë në interesin më të mirë të fëmijës.

Hapi 6: Komiteti i KB për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës (5 minuta)

Hapni diskutim me fëmijët nëse kanë dëgjuar për Komitetin e KB për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës! A kanë dëgjuar për të, nëse dinë cili është roli i tij dhe të ngjashme. Informata themelore ka më poshtë në nëntitullin Burime.

Hapi 7: Komente, pyetje! (5 minuta)

Mbylleni punëtorinë dhe jepuni mundësi të pranishmëve të japin komentet e tyre, të parashtrajnë pyetje në lidhje me temën e punëtorisë!

Burime

Historiati i Konventës

Historia e Konventës për të drejtat e fëmijës fillon me vetë formimin e Ligës së kombeve në vitin 1919, por liderëve të shteteve u duhej plot 70 vite që zyrtarisht ta prezantojnë Konventën.

Më 10 dhjetor të vitit 1948 nga ana e KB u miratua Deklarata universale për të drejtat e njeriut e cila doli drejtpërsëdrejti nga përvoja e Luftës së dytë botërore dhe përfaqëson shprehjen e parë globale të të drejtave për të cilët për nga natyra e tyre kanë të drejtë të gjithë qeniet njerëzore. Deklarata përbëhet nga 30 nene të cilët janë përshtjelluar në marrëveshjet e mëvonshme ndërkombëtare, instrumentet rajonale për të drejtat e njeriut, kushtetutat dhe ligjet kombëtare.

Në vitin 1959 KB e miratuan Deklaratën për të drejtat e fëmijës. Konventa për të drejtat e fëmijës, rreth së cilës u punua 10 vite, nga viti 1979 deri në vitin 1989 kur edhe u miratua, për herë të parë e përcakton deri kur zgjat fëmijëria. Pasi u ratifikua nga numri i nevojshëm i kombeve, më 2 shtator të vitit 1990, Konventa hyri në fuqi. Nga nëntori i vitit 2009, e ratifikuan 196 shtete, përfshi të gjithë anëtarët e Kombeve të bashkuar, me përjashtim të Shteteve të bashkuara të Amerikës (kjo nuk do të thotë se ShBA nuk e zbatojnë në masë të madhe Konventën. Problemi qëndron në atë se duhet të ratifikohet

në nivel Federal, ndërsa në ShBA ka disa shtete në të cilët është i lejuar dënimi me vdekje i adoleshentëve, që nuk është e lejuar sipas Konventës).

Konventa për të drejtat e fëmijës e Kombeve të bashkuara (shkurtesa të shpeshta të cilët hasen janë CRC, CROC ose UNCRC) është marrëveshje për të drejtat e njeriut në të cilën janë përcaktuar të drejtat qytetare, politike, ekonomike, sociale, shëndetësore dhe kulturore të fëmijëve. Veçori themelore e Konventës është qasja e saj gjithëpërfshirëse (holistike) (që do të thotë se të drejtat janë të ndërthurura dhe reciprokisht të varura). Konventa në përgjithësi e përkufizon fëmijën si çdo qenie njerëzore që nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet nga jeta, përveçse nëse në bazë të ligjit të një shteti të caktuar moshë madhore nuk është arritur më herët.

Kombet të cilët e ratifikojnë këtë Konventë janë të obliguar ndaj saj me të drejtën ndërkombëtare. Komiteti për të drejtat e fëmijës pranë Kombeve të bashkuara, të cilin e përbëjnë anëtarë të vendeve të botës, mbikëqyr respektimin e Konventës. Komiteti i raporton një herë në vit Komitetit të Tretë të Asamblesë së përgjithshme të Kombeve të bashkuara, dhe gjithashtu kryetari i Komisionit për të drejtat e fëmijës bën një fjalim para Ko-

Komiteti i KB për mbrojtje të të drejtave të fëmijëve
<https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRC/Pages/CRCIndex.aspx>

Komiteti për të drejtat e fëmijëve e KB është trup i përbërë nga ekspertë të pavarur të cilët e ndjekin zbatimin e Konventës. Të gjithë shtetet nënshkruese janë të obliguara të dorëzojnë raporte për zbatimin e Konventës në vendin e tyre në çdo 5 vjet. Deri më tani, Maqedonia dy herë ka dorëzuar raporte – në vitin 2000 dhe 2009.

Struktura e Konventës.

Struktura e Konventës mund të shqyrtohet në më tepër aspekte. Aspekti i parë është sipas numrit të neneve në Konventë. Konventa përbëhet prej 54 neneve. Nga to 45 nene kanë të bëjnë me fëmijët dhe të drejtat e tyre, ndërsa 9 nene kanë të bëjnë me masat për zbatim.

Aspekti i dytë tregon se me ratifikimin e Konventës, shtetet nënshkruese obligohen ti respektojnë të drejtat e fëmijëve, mbi të gjitha të atyre që kanë të bëjnë me:

1. mbijetesën dhe zhvillimin,
2. mbrojtjen,
3. pjesëmarrjen.

MBIJETESË DHE ZHVILLIM	MBROJTJE	PJESËMARRJE
E drejta për jetë	Nga keqpërdorimi dhe anashkalimi	Roli aktiv i bashkësisë
E drejta për të jetuar me prindërit dhe e drejta e ndarjes nga prindërit	Mbrojtja e fëmijëve pa prindër	Liria e mendimit, shprehjes së mendimit, ndërgjegje dhe religjion
Shëndet dhe shërbime shëndetësore	Nga shfrytëzimi për punë	Pjesëmarrje në marrjen e vendimeve për jetën personale
Standard adekuat jetësor	Keqpërdorimi seksual	Shoqërim
Arsim	Mospërfillja	Mbrojtje të privatësisë
Lojë dhe kohë të lirë	Konfliktet e armatosura	
Aktivitete kulturore	Keqpërdorimi i drogës	
Qasje në informata	Tregtia me njerëz	
Identitet	Mbrojtja e fëmijëve që janë në ndeshje me ligjin	
Të drejtat e fëmijëve me pengesa në zhvillim	Mbrojtja e fëmijëve nga tortura dhe privimi nga liria	
Të drejtat e fëmijëve nga pakicat dhe fëmijëve me prejardhje autoktone		

mitetit të tretë dhe Kuvendi miraton një Rezolutë për të drejtat e fëmijës.

Qeveritë e vendeve të cilët e kanë ratifikuar Konventën kanë për obligim të raportojnë dhe të paraqiten periodikisht para Komitetit për të drejtat e fëmijës pranë Kombeve të bashkuara për të rishikuar përparimin e tyre për sa i përket zbatimit të Konventës dhe statusit të të drejtave të fëmijës në vendin e tyre. Në ueb faqen e Komitetit mund ti gjeni raportet e tyre, si dhe qëndrimet dhe elementet e shqetësimit të Komitetit.

Më 25 maj të vitit 2000 u miratuan dy protokolle fakultative. Me protokollin e parë fakultativ kufizohet përfshirja e fëmijëve në konflikte ushtarake, ndërsa me protokollin e dytë fakultativ ndalohet shitja e fëmijëve, prostitucioni me fëmijë dhe pornografia e fëmijëve. Më shumë se 140 shtete i kanë ratifikuar të dy protokollat.

4.5. Modul për punëtorë: Parime të Konventës për të drejtat e fëmijës

Kohëzgjatja e punëtorisë:	135 minuta (2 pushime nga 15 minuta)
Qëllimi i punëtorisë:	Ombudsmanët e nxënësve të njoftohen me Parimet e Konventës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës (mund të përfshihen edhe anëtarët e parlamentit të nxënësve)
Materiali i nevojshëm:	Prezantim (sipas përzgjedhjes së drejtuesit të punëtorisë) Dërrasë Qasje në internet dhe mundësi që me fëmijët të ndahen video materiale për nene të caktuara të Konventës Afishë me ngjyrë (të vogla, që të mund të ngjiten në ballë) – gjelbër, verdhë, portokall

Hapi 1: Tre parimet themelore të Konventës (5 minuta)
Hyrja fillon me një rekapitullim të shkurtë të punëtorisë paraprake. Pastaj vazhdohet me hyrjen në parimet themelore të Konventës. Konventa përmban tre parime themelore fundamentale që kanë të bëjnë me pothuajse të gjithë aspektet e jetës së fëmijëve dhe këto tre parime në fakt janë shtylla e Konventës, dhe ato janë:

1. Interesi më i mirë i fëmijës (neni 3 i Konventës),
2. Mosdiskriminimi i fëmijës (neni 2 i Konventës),
3. E drejta për pjesëmarrje (neni 12 i Konventës).

Këto tre rregulla ose parime janë aq të ndërlydhura mes veti dhe të rëndësishme sa që paraqesin një **trekëndësh të të drejtave** me status të **parimeve të përgjithshme**.

Përpquni që në mënyrë vizuale t'ua prezantoni trekëndëshin e të drejtave, për shembull të vizatuar në dërrasë.

Sqarojuni fëmijëve se për çdo parim do të bisedoni në vazhdim të kësaj punëtorie dhe se do të bëni simulime/ushtrime për kuptimin më të mirë të tyre.

Hapi 2: Interesi më i mirë i fëmijës (40 minuta)
Kërkoni nga fëmijët ta shprehin mendimin e tyre për atë se si ata e kuptojnë interesin më të mirë të fëmijës. Inkurajoni që çdokush të jep mendimin e vet. Përmbledhni mendimet dhe bazuar në informatat themelore nga seksioni Burime shpjegojuni atyre se çfarë do të thotë në të vërtetë interesi më i mirë i fëmijës.

Prezantoheni video materialin e UNICEF për nenin 3 të Konventës (lidhja në Burime). Kërkoni nga fëmijët të tregojnë se si ata e kanë perceptuar video materialin. Zhvilloni një diskutim nëse të gjithë i kuptojnë interesin më të mirë të fëmijës në mënyrë të barabartë. Kërkoni nga fëmijët mendim për atë se në çfarë rastesh tjera duhet të merret parasysh interesi më i mirë i fëmijës?

Neni 3: Mosdiskriminimi i fëmijës (60 minuta)
Diskutimin fillojeni duke kërkuar mendim nga fëmijët për atë se çfarë nënkuptojnë ata me mosdiskriminim të fëmijës. Analizojeni mundësinë për diskriminim të fëmijës për shkak të vetes së tij dhe për shkak të prindërve/kujdestarëve të tij. Pastaj sqaroni çfarë do të thotë mbrojtja e fëmijëve nga diskriminimi. Informata themelore keni në pjesën Burime.

Prezantoheni video materialin e UNICEF për nenin 2 të Konventës (lidhja në Burime) dhe hapni diskutim se si e kanë kuptuar videon fëmijët, çfarë mund të nxirret si përfundim nga video materiali.

Për të kuptuar më mirë mosdiskriminimin e fëmijëve, prezantoni një ushtrim në të cilën do të duhet të marrin pjesë aktive.

Hulumtoje diskriminimin – loja „Afishë“

Sqarim

Kjo është lojë e përshëndetjes. Çdokush nga ju do të ketë nga një afishë me ngjyrë të caktuar në ballë, për të cilën nuk do të dini se çfarë ngjyre ka. Do të lëvizni përreth në hapësirë dhe do të përshëndeteni me njëritjetrin. Gjithsesi, përshëndetja do të dallojë në varësi nga ajo se çfarë ngjyre do të ketë afishja në ballin e atij që do ta takoni.

Nëse hasni në një pjesëmarrës që ka afishë të gjelbër, do ta përshëndetni me entuziazëm. Do të tregoni se vërtetë jeni të lumtur dhe se jeni të nderuar që e takoni atë person, sepse ai është shumë i rëndësishëm për ju.

Nëse hasni në një pjesëmarrës që ka afishë të verdhë, do ta përshëndetni natyrshëm, në mënyrë në të cilën përshëndeteni me njerëz që i takoni çdo ditë.

Nëse shihni dikë me afishë ngjyrë portokalli në ballë, nuk do të doni të përshëndetni atë person. Do të përpqeni ta shmangni.

Tani radhituni në një vijë dhe mbyllni sytë. Domethënë, të gjithë keni afishë në ballë. Tani keni dhjetë minuta të lëvizni nëpër hapësirë dhe ti ndiqni udhëzimet që u janë dhënë.

Diskutim

- Nëse ishit i gjelbër, si ju trajtonin njerëzit? Si ndjeheshit ju?
- Nëse ishit i portokalltë, si ju trajtonin njerëzit? Si ndjeheshit ju?
- Nëse ishit i verdhë, si ju trajtonin njerëzit? Si ndjeheshit ju?

- A ka në jetën reale fëmijë të cilët trajtohen ndryshe? Theksoni ndonjë shembull për diskriminim të vajzave, djemve në shoqëri?
- Pse sipas jush disa fëmijë janë të diskriminuar? Si ndikon kjo ndaj atyre fëmijëve?
- Çfarë mund të bëjmë për ta parandaluar diskriminimin ndaj fëmijëve?

Hapi 4: E drejta për pjesëmarrje (30 minuta)

Parimi i tretë i Konventës është e drejta për pjesëmarrje. Në fillim kërkoni nga fëmijët të shohin Konventën dhe të tregojnë nëse mund të identifikojnë në cilët nene përmendet e drejta për pjesëmarrje.

Të drejtën për pjesëmarrje të fëmijës e sqarojnë nenet 12 dhe 13 të Konventës.

Sqarojuni se çfarë shkruan në Konventë për këtë të drejtë dhe çfarë do të thotë kjo në praktikë. Informata themelore për të drejtën për pjesëmarrje do të gjeni më poshtë në pjesën Burime.

Informoni fëmijët se në punëtorinë e radhës do të kenë mundësi të njihen me këtë të drejtë.

Hapi 5: Përmbyllja e punëtorisë

Pyetini fëmijët se çfarë u ka lënë përshtypje më të madhe nga punëtorja e sotme?

Çfarë iu është dukur më interesante?

Cila pjesë ka qenë më pak interesante/e mërzitshme për to?

A kanë ndonjë pyetje në lidhje me temat dhe diskutimet e sotme?

A kishin mundësi të përfshihen në mënyrë aktive në aktivitetet dhe diskutimet gjatë punëtorisë?

Burime

Interesi më i mirë i fëmijës

<https://www.youtube.com/watch?v=M4v5Lb5qPq8> – prezantim i shkurtër i UNICEF për interesin më të mirë të fëmijës.

Një nga të drejtat themelore të garantuara me Konventën e cila e përbën trekëndëshin e të drejtave, është edhe e drejta e interesit më të mirë të fëmijës.

Çfarë nënkupton kjo e drejtë?

Sipas nenit 3 të Konventës, të gjithë aktivitetet që kanë të bëjnë me fëmijët, me interes parësor për të gjithë në është interesi më i mirë i fëmijës. Kjo do të thotë se të gjithë vendimet, masat, aktivitetet që i ndërmarim për fëmijët duhet të udhëhiqen nga nevoja që për fëmijën të sigurojmë të drejta dhe mbrojtje të tillë të cilët janë të domosdoshme për mirëqenien e tyre.

Shteti gjatë krijimit të politikave të saja, gjatë rregullimit të çështjeve të cilët prekin në të drejtat dhe interesat e fëmijëve, duhet të udhëhiqet nga interesi më i mirë i fëmijëve dhe të parashikojë zgjidhje të atilla ligjore ku interesi më i mirë i fëmijëve do të ketë prioritet. Po ashtu edhe gjatë miratimit të vendimeve konkrete për institucionet kompetente duhet të mbahet llogari për interesin më të mirë të fëmijës.

Një nga parimet kryesore filozofike të Konventës është që fëmijët janë po aq të rëndësishëm sa të rriturit dhe

janë të barabartë me ta. Nga ky tezë niset struktura e përgjithshme e fëmijëve si bartës të të drejtave. Megjithatë, për shkak të cenueshmërisë (ndjeshmërisë) së tyre specifike, fëmijëve u nevojitet mbështetje e posaçme që të mund ti praktikojnë në tërësi të drejtat e tyre. Si mund tu garantohen fëmijëve të drejta të barabarta dhe njëkohësisht tu jepet mbrojtja e domosdoshme? Pikërisht parimi për atë se çfarë është interesi më i mirë për fëmijën do të duhej të zgjidh këtë marrëdhënie në dukje kundërtëse⁴.

Në raste të caktuara, kur është në interesin më të mirë të fëmijës, të drejtat e caktuara të prindit mund të kufizohen. Për shembull, mund të kufizohet e drejta e prindit për kontakte personale me fëmijën nëse ai prind jeton ndaras, nëse kjo ndikon negativisht ndaj fëmijës, nëse fëmija nuk dëshiron asesi të takohet me prindin, nëse e keqtrajton në mënyrë fizike ose psikike, ndërsa në raste të caktuara fëmija mund tu merret prindërve dhe të vendoset në një familje ose institucion tjetër dhe tu kufizohet ose ti merret e drejta prindërore për të dy prindërve, por gjithmonë gjatë vendimeve të këtylla duhet të udhëhiqemi nga interesi më i mirë i fëmijës.

Po ashtu, kur vendosim për të drejta të caktuara të fëmijës i cili jeton me familjen e tij, para së gjithash duhet të mbajmë llogari për atë që është më e mirë për fëmijën, e jo ajo që është më e mirë për prindërit.

Sipas kësaj, interesi më i mirë i fëmijës ka dy përdorime të ndryshme:

1. **gjatë rregullimit të politikës qeveritare (legjislativi, masa të caktuara të Qeverisë dhe institucioneve tjera) dhe**
2. **për sa u përket vendimeve që kanë të bëjnë me fëmijët në bazë individuale (këtu janë prindërit, arsimtarët, zyrtarët dhe të gjithë individët dhe institucionet).**

Pra të bëjmë një përmbledhje se çfarë përfshin në vete interesi më i mirë për fëmijën.

INTERESI MË I MIRË I FËMIJËS PËRFSHIN:

mbijetesë dhe zhvillim të fëmijës, e drejta për jetë.

E DREJTA PËR MBIJETESË – Jetesë me prindërit, Ndarje nga prindërit (neni 9), Shëndet dhe shërbime shëndetësore (neni 24), Standard të jetës (neni 27), Kohë të lirë, rekreacion dhe aktivitete kulturore (neni 31).

⁴ Në të drejtën familjare shprehja „interesi më i mirë i fëmijës“ përdoret në raste kur duhet të vendoset kujt do ti takojë kujdestaria dhe kujdesi për fëmijën, në rast të shkurorëzimit ose ndarjes së prindërve, ose në cilën mënyrë do të sigurohet kujdesi për fëmijën nëse ai është pa prindër. Mirëpo, Konventa e ngrit këtë ide jashtë dhe mbi kornizat e të drejtës familjare dhe e zbaton në „të gjithë aktivitetet që kanë të bëjnë me fëmijët“. Kjo do të duhej të nënkuptojë se interesi më i mirë i fëmijës, po ashtu, do të duhej të merr peshë adekuate edhe në gjërat që kanë të bëjnë me marrjen e vendimeve në lidhje me buxhetin kombëtar, që ndaj fëmijëve pasqyrohet përmes zvogëlimit të mjeteve për mbrojtje shëndetësore dhe arsim, ose planifikim për ndërtim të një dige apo autostrade që mund të kenë ndikim të caktuar ndaj fëmijëve të cilët jetojnë në atë zonë dhe të cilët, për shembull, do të duhej ti braktisin shtëpitë e tyre. Njëjtë si edhe „interesi më i mirë“, edhe ky nen ngritët mbi përdorimin tradicional në kuadër të së drejtës familjare, dhe ua garanton fëmijëve të drejtën për ta shprehur mendimin e tyre për punë të tilla siç është buxheti, politikat zhvillimore dhe çështjet sociale, gjithçka që i prek ata.

SITUATA BRENGOSËSE për shkak të cilave mund të vijë deri në shkelje të kësaj të drejte: Fëmijë të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme për ushqim, të cilët nuk kanë ujë të pastër për pije, të cilët nuk kanë mbrojtje adekuate shëndetësore, të cilët janë të ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore, fëmijë pa kujdes prindëror, fëmijë të rrugës, fëmijë të cilët e kanë shkelur ligjin, fëmijë emigrantë, fëmijë viktime të tregtisë me njerëz, konflikteve të armatosura, traditave ose zakoneve.

Mosdiskriminimi i fëmijës

<https://www.youtube.com/watch?v=LK5a-DYzBWk> – prezantim i shkurtë i UNICEF për mosdiskriminimin.

ÇFARË DO TË THOTË MBROJTJE E FËMIJËVE NGA DISKRIMINIMI

Sipas nenit 2 të Konventës, çdo fëmijë duhet të respektohet dhe duhet ti sigurohen të gjithë të drejtat pa asnjëfarë diskriminimi dhe pa dallim racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, konfesionit, bindjeve politike dhe të tjera, prejardhjes kombëtare, etnike ose sociale, gjendjes pronësore, paaftësisë, prejardhjes ose ndonjë statusi tjetër të fëmijës ose të prindit apo kujdestarit të tij.

Pra, shteti, dhe kjo do të thotë përmes legjislacionit, përmes aktiviteteve të organeve shtetërore, institucioneve, përmes individëve, duhet të ndërmer masa me të cilat do të sigurojë mbrojtje të fëmijës nga të gjithë format e diskriminimit ose dënimeve të bazuara mbi statusin, mendimin e shprehur ose besimit të prindërve.

Si mund të diskriminohen fëmijët? Në çfarë baze?

Vëmendje e posaçme në Konventë i përkushtohet diskriminimit gjinor (diskriminim specifik i vajzave në krahasim me djemtë për shkak të dallimeve gjinore)⁵.

Në çfarë mënyre? Fëmija femër nuk dërgohet në shkollë që ti kryejë punët e shtëpisë ose që të martohet, për shkak të parave ose për shkak të vështirësive materiale në familje.

Fjalori i diskriminimit gjinor:

- diskriminimi ndodh atëherë kur për shkak të dallimeve fëmija është në pozitë të pavolitshme të vazhdueshme;
- gjinia: marrëdhëniet shoqërore midis gjinive, përfshi qasjen, sjelljen dhe fuqinë e cila përshtatet nga shoqëria;
- barazi gjinore: të jesh i drejtë ndaj vajzave dhe djemve, gruas dhe burrit. Parimi i barazimit gjinor nuk do të thotë trajtim në mënyrë identike i vajzave dhe djemve, por njohje dhe vlerësim i dallimeve të tyre në mënyrë që krijon mundësi të barabarta;
- barazi gjinore: çdokush ka status të njëjtë në shoqëri;
- perspektiva gjinore: të shihen gjërat nën prizmin e gjinisë, me pyetjen si dhe përse është gjinia në lojë;
- ndjeshmëri gjinore: politika, praktika ose programime që i marrin parasysh dallimet ndërmjet vajzave dhe djemve dhe që prodhojnë barazi.

Mund të jetë i diskriminuar çdo fëmijë i cili ka pengesa të caktuara në zhvillim ose fëmijë që është i racës së ndryshme ose me prejardhje të ndryshme kombëtare, etnike apo sociale, ose në baza tjera.

Si? Nga institucionet mund të bëhet diskriminim përmes refuzimit për tu pranuar në çerdhe, në shkollë, përmes kufizimit të drejtës për përfshirje në manifestime kulturore dhe artistike, përmes kufizimit të fëmijës që të shpreh mendimin e tij dhe të merr pjesë në sjelljen e vendimeve për jetën e tij.

Kur keqtrajtohet fizikisht ose psikikisht nga ana e prindërve, arsimtarëve ose edukatorëve në institucionet në të cilët është vendosur.

Kur fëmijët tjerë nuk dëshirojnë të shoqërohen me të, e nënçmojnë ose ofendojnë meqenëse është ndryshe nga to në çfarëdo baze.

⁵ Për identifikimin e këtij lloji të diskriminimit është shumë e rëndësishme të bëhet dallimi midis termeve: seksi dhe gjinia. **Seksi** ka të bëjë me dallimet biologjike midis meshkujve dhe femrave (këto dallime kanë të bëjnë me veçori dhe funksione të caktuara biologjike të organizmit: menstruacioni, shtatzënia, gjidhënia te femrat, prodhimi i spermës te meshkujt; dallime në konstruktin e trupit, përbërja hormonale, baraspesha e materieve). **Gjinia** ka të bëjë me dallimet në rolet dhe përgjegjësitë sociale të cilët u përshkruhen grave dhe burrave (këto dallime nuk kanë asnjë lidhje me dallimet biologjike, por paraqesin produkt të vetë bashkësisë njerëzore që përcakton një përmbledhje të caktuar të sjelljeve dhe veçorive si të pranueshme apo papranueshme për meshkujt dhe femrat. Kjo përmbledhje e sjelljeve dhe veçorive u përshkruan rol të përcaktuar në mënyrë rigoroze burrit dhe gruas në familje, në jetën publike dhe shoqërore).

Kur veprohet ndryshe meqenëse prindi i tij e ka shkelur ligjin ose meqë prindërit e tij i takojnë një religjioni tjetër.

Më tej, diskriminimi mund të kryhet edhe në atë mënyrë që për përkatësinë e një grupi etnik pranohen më pak të drejta dhe prioritete krahasuar me një grup tjetër etnik, kur nuk u mundësohet qasje dhe shfrytëzim i institucioneve të caktuara për shkak të përkatësisë së tyre etnike dhe të ngjashme.

Diskriminimi mund të jetë i drejtpërdrejtë, i shprehur qartë dhe i dukshëm, por mund të jetë edhe i fshehur. Për shembull, kur vajzat stimulohen të lozin balet në vend se të merren me sport, bëhet fjalë për diskriminim të fshehur. Kur nga djemtë pritet të mos qajnë kur të lëndohen, bëhet fjalë për diskriminim të fshehur. Kur një vajze e cila dëshiron të merret me sport, mirëpo nuk dëshiron të veshët me triko, i pamundësohet kjo, bëhet fjalë për diskriminim të fshehur. Në shikim të parë veprimi i barabartë mund të jetë diskriminues kur nuk mban llogari për dallimet.

E drejta për pjesëmarrje

Trekëndëshi i të drejtave e përbën edhe të drejtën për pjesëmarrje të fëmijës, që është e drejtë thelbësore dhe të cilës i kushtohet gjithnjë e më shumë vëmendje, meqenëse kjo akoma nuk është zhvilluar deri në fund dhe nuk është mishëruar as në legjislacion e as në praktikë.

Çfarë do të thotë kjo e drejtë?

Për të përcaktuar se çfarë është në interesin më të mirë të fëmijës, është logjike dhe e nevojshme të dëgjohet zëri i fëmijës dhe pikëpamjet e tij të marren me seriozitet⁶.

„Organet shtetërore duhet ti mundësojnë fëmijës që është i aftë të formojë qëndrime të tija, të drejtën për ti shprehur ato qëndrime në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me të, qëndrimet e tija duhet të kuptohen me seriozitet, në pajtim me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.”

Mendimit të fëmijës duhet ti jepet peshë adekuate në pajtim me moshën dhe pjekurinë e fëmijës. Mendimi i fëmijës në moshë prej 5 dhe moshë prej 15 vjeç duhet të dëgjohet me respekt të njëjtë, por fjalëve të fëmijës 15 vjeçar do tu jepet peshë më e madhe (kur bëhet fjalë për fëmijë të moshës së njëjtë, disa ndoshta janë më të aftë që një çështje ta kuptojnë dhe të flasin për të në mënyrë më kompetente se të tjerët, për të cilën arsye mendimeve të tyre duhet tu jepet peshë më e madhe). Të dëgjohet mendimi i fëmijës nuk do të thotë që ai të jetë patjetërsueshëm vendimmarrës për zgjidhjen e problemit⁷.

⁶ Të drejtat që u mundësojnë fëmijëve të marrin pjesë në çështje dhe probleme që kanë të bëjnë me jetën e tyre (të formojnë dhe shprehin mendime për punë që kanë të bëjnë me to, tu mundësohet ta kuptojnë situatën e tyre dhe tu lejohet të zhvillojnë shkathtësi sociale, përgjegjësi për zhvillimin e shoqërisë dhe arritje të nivelit të nevojshëm të pavarësisë).

⁷ Për shembull, fëmija mund të mendojë se shkuarja në shkollë është vetëm harxhim kohe, por interesi më i mirë për atë fëmijë akoma kërkon që ai të shkojë në shkollë. Megjithatë, shqyrtimi me kujdes i mendimit të fëmijës, mund të sjell deri në ndryshime në shkollë, që do ta bënin atë më të mirë dhe më tërheqës për të gjithë fëmijët.

Para së gjithash, kjo e drejtë do të thotë që fëmija nuk duhet trajtuar si objekt i pjesëmarrjes, respektivisht objekt i të drejtave, por duhet të trajtohet si një subjekt i veçantë, person i cili ka të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, i cili në procesin e pjekurisë së tij ka të drejtë të marrë vendime për mirëqenien e vet brenda kufijve të moshës së vet dhe nivelin e të kuptuarit të pasojave të vendimeve të tij.

Sipas nenit 12 të Konventës, secilit fëmijë që është i aftë të formojë mendim të vet, duhet ti sigurohet e drejta për mendim personale, e drejta për shprehje të lirë të atij mendimi për të gjithë çështjet që kanë të bëjnë me të, me atë që mendimit të tij duhet ti kushtohet kujdesi i duhur në pajtim me vitet e jetës dhe pjekurinë e fëmijës. Për këtë arsye fëmijës duhet ti jepet mundësia të jetë i dëgjuar në të gjithë procedimet gjyqësore dhe administrative që kanë të bëjnë me të edhe atë qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesit.

Fëmija, sipas nenit 13 të Konventës, ka të drejtë për liri të shprehjes, e cila përfshin edhe lirinë të kërkojë dhe pranojë informata dhe ide të të gjithë llojeve.

Por, a duhet lejuar fëmija që lehtë të arrijë deri në informata që janë të dëmshme për të, të cilët ndikojnë dëmshëm ndaj zhvillimit të tij psikik dhe a duhet të ndërmerren masa që fëmija të mbrohet nga informatat e këtilla.

Më tej, a duhet të lejohet në mjetet e informimit publik të shpalosen të dhëna me emër dhe mbiemër të fëmijëve që kanë qenë të eksponuar ndaj dhunës ose e kanë shkelur ligjin, kanë qenë të keqpërdorur, janë përdorues të substancave psikotrope, e të ngjashme.

Edhe pse fëmijët kanë të drejtë dhe liri për të pranuar dhe për të dhënë informata, megjithatë edhe në këtë rast duhet të udhëhiqemi nga nevoja për mbrojtjen e tyre, si dhe nga interesi i tyre më i mirë. Kjo do të thotë se shteti si nënshkrues i Konventës, është i obliguar tu pranojë vend të posaçëm mjeteve për informim publik, të cilët duhet ti mundësojnë fëmijës qasje deri te informatat dhe materialet prej burimeve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe në veçanti tu kushtohet vëmendje atyre informatave, qëllimi i të cilëve është avancimi i gjendjes sociale, shpirtërore dhe morale të fëmijës, si dhe shëndetit fizik dhe mendor. Për arritjen e këtyre qëllimeve të Konventës, shteti duhet ti nxisë mjetet për informim publik ti përhapin informatat dhe materialet e karakterit social dhe kulturor me interes për fëmijën, në kuptim të nenit 29 të Konventës, që parashton më tepër emisione arsimore. Më tej, ta nxisë edhe përhapjen e librave për fëmijë, ti nxisë mjetet për informim publik të kushtojnë vëmendje të veçantë për zhvillimin në drejtim të mbrojtjes së fëmijës nga informatat dhe materialet që janë të dëmshme për mirëqenien e fëmijës.

Kjo do të thotë që këto dispozita të Konventës në të vërtetë i inkurajojnë të rriturit të dëgjojnë fëmijët e tyre, t'i përfshijnë ata në vendimmarrje, që do të thotë që prindërit dhe mësuesit, punonjësit socialë dhe të gjithë entitetet tjera të marrin parasysh qëndrimet e fëmijëve, të mundësojnë që fëmija t'i sjell vendimet të cilët mund ti merr në moshë të caktuar, ta stimulojnë të merr vendime dhe ti shfrytëzojnë ata informata për marrjen e

vendimeve të cilët janë në interesin më të mirë të fëmijës, e jo ata informata të shërbejnë për marrjen e vendimeve në dëm të fëmijëve.

<https://www.youtube.com/watch?v=xKBU2B8xZYE>
- video në You Tube - UNICEF për nenin 13.

Për shembull, fëmijët duhet të përfshihen në: vendim-marrjen e përditshme në familje, në shkollë, në mjedisin në të cilin jetojnë, fëmijët duhet të kenë mundësi dhe mënyra për shprehjen e mendimit të tyre në raste kur u shkelen të drejtat, të pranojnë informata në bazë të së cilave do të mund të formulojnë mendim relevant dhe të kenë mënyra të ndryshme për shprehjen e mendimit. Fëmija ka të drejtë të pyes, të kuptojë, të kundërshtojë, të komentojë, të analizojë, të mos pajtohet. Është detyrë e të rriturve ta udhëzojnë fëmijën drejt zhvillimit dhe ushtrimit të duhur të kësaj të drejte në mënyrë e cila nuk cenon të drejtat e të tjerëve.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet keqpërdorimit të së drejtës së shprehjes, e cila mund të shfaqet si fytyrë, dhunë verbale ose gjuhë e urrejtjes.

Çfarë përfshin e drejta për pjesëmarrje: Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit (neni 14), E drejta për shoqërim (neni 15), Mbrojtja e privatësisë (neni 16), Qasja në informata (neni 17), Liria për të dhënë dhe pranuar informata (neni 13).

4.6. Modul për punëtori: Të drejta tjera nga Konventa për të drejtat e fëmijës dhe roli i ombudsmanëve të nxënësve

Kohëzgjatja e punëtorisë:	180 minuta (2 pushime nga 15 minuta - nga 60 dhe 120 minuta)
Qëllimi i punëtorisë:	Ombudsmanët e nxënësve të njihen me të drejta plotësuese të rëndësishme të cilët shtjellohen në Konventën për mbrojtje të të drejtave të fëmijës dhe dhe me rolin e tyre, në sajë të ombudsmanëve të fëmijëve në mbrojtje të atyre të drejtave (mund të përfshihen edhe anëtarët e parlamentit të nxënësve)
Materiali i nevojshëm:	Prezantim (sipas përzgjedhjes së drejtuesit të punëtorisë) Dërrasë

Hapi 1: Përmbledhje e punëtorisë së mëparshme (10 minuta)

Punëtorinë fillojeni me atë që do tu jepni mundësi pjesëmarrësve që nëse kanë ndonjë pyetje dhe/ose koment në lidhje me punëtorinë paraprake, për parimet e Konventës, të pyesin ose të komentojnë.

Hapi 2: Të drejtat e fëmijëve që kanë të bëjnë me mbijetesën dhe zhvillimin (30 minuta)

Të gjithë parimet e përmendur më parë duhet ta mundësojnë realizimin e mbijetesës dhe zhvillimit të fëmijës, si diçka shumë më tepër se një garantim i thjeshtë i të drejtës për jetë dhe mbijetesë. Sipas Konventës, mbijetesë dhe zhvillimi duhet të mundësohen „...deri në shkallën më të lartë të mundshme ...”. Në këtë kuptim, fjala mbijetesë e shënon aspektin dinamik të së drejtës për jetë (përfshi edhe nevojën për veprime parandaluese, si për shembull, imunizim)⁸. Termi *zhvillim* interpretohet në një kuptim akoma më të gjerë dhe shton një cilësi të re, që përfshin zhvillimin e personalitetit të fëmijës, talenteve dhe aftësive të tij⁹.

Pyetini fëmijët nëse mund të identifikojnë cilët nene të Konventës kanë të bëjnë me mbijetesën dhe zhvillimin.

E drejta për jetë (neni 6)

E drejta të jetojë me prindërit dhe për ndarje nga prindërit (neni 9, 10, 18, 20, 21)

Shëndet dhe shërbime shëndetësore (neni 24)

Standard adekuat jetësor (neni 27)

Arsim (neni 28)

Lojë dhe kohë të lirë (neni 31)

Aktivitete kulturore (neni 30)

Qasje në informata (neni 13)

Identitet (neni 8)

Të drejtat e fëmijëve me pengesa në zhvillim (neni 23)

Të drejtat e fëmijëve nga pakicat dhe fëmijët me prejardhje autoktone (neni 30)

8 Komponenti themelor i të drejtës për mbijetesë të fëmijëve është qasja deri te mbrojtja shëndetësore dhe shërbimet shëndetësore. Kjo duhet të rezultojë me ulje të vdekshmërisë së foshnjave dhe fëmijëve, sigurim të mbrojtjes primare shëndetësore, ulje të kequshqyerjes, sigurim të ujit të pastër, sigurim të mbrojtjes shëndetësore të nënave dhe fëmijëve, sigurim të qasjes deri te informatat për të gjithë dhe promovim të strategjive dhe planeve parandaluese për mbrojtje shëndetësore.

9 Zhvillimi i nënkupton të gjithë gjërat që u nevojiten fëmijëve për përmbushjen e potencialit të tyre të plotë. Konventa e përkufizon zhvillimin e fëmijës në kushte më të gjera të mundshme, përfshi zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social. Konventa i udhëzon shoqëritë t'i kuptojnë dhe parashikojnë nevojat zhvillimore të fëmijëve, siç janë arsimi, standardi adekuat jetësor, mbrojtja sociale dhe të tjera.

Informata themelore për këto të drejta ka në pjesën Burime.

Hapi 3: Të drejtat e fëmijëve që kanë të bëjnë me mbrojtjen (20 minuta)

Konventa përmban një korpus të tërë të të drejtave mbrojtëse, qëllimi i të cilëve është të mbrojnë fëmijët nga të gjitha format e moskujdesit dhe keqpërdorimit. Konventa njih nevojën për të mbrojtur fëmijët nga rrethanat që mund të zvogëlojnë mundësitë e tyre për mbijetesë dhe zhvillim. Më konkretisht, mbrojtja që u sigurohet fëmijëve është e ndërlidhur me kujdesin dhe udhëzimet që fëmijët i pranojnë nga prindërit e tyre, anëtarët e tjerë të familjes, këshilltarët juridik dhe të tjerët, si arsimtarët dhe punonjësit shëndetësor. Mbrojtja e fëmijëve po ashtu e përfshin edhe nevojën për kujdes ndaj fëmijëve që në mënyrë të përhershme ose përkohësisht janë privuar nga mjedisi familjar. Po ashtu, fëmijëve në rrethana jashtëzakonisht të vështira, Konventa u siguron të drejta të veçanta për mbrojtje¹⁰.

Filloni diskutim me fëmijën nëse për fëmijën është e mjaftueshme vetëm t'ia sigurojmë të drejtat themelore ndërsa gjatë kësaj të mos mbajmë llogari edhe për mbrojtjen e tij. A mund të thuhet për një fëmijë që vazhdimisht është i keqtrajtuar, keqpërdorur ose anashkaluar që i gëzon të gjithë të drejtat dhe që ka mundësi për mbijetesë, rritje dhe zhvillim normal dhe a mund të thuhet se ai fëmijë është i barabartë me fëmijët tjerë.

Një fëmijë i cili është keqtrajtuar, keqpërdorur, pa marrë parasysh në çfarë forme, ose i anashkaluar, nuk ka kushte themelore për mbijetesë, rritje dhe zhvillim normal, nuk ka mundësi për jetë të sigurt.

Me qëllim që fëmijët t'i gëzojnë të gjithë të drejtat, të mos jenë të keqpërdorur, keqtrajtuar dhe anashkaluar,

10 Drejtësia për të mitur - fëmijët trajtohen më ndryshe nga të rriturit kur janë të akuzuar për shkelje të ligjit (që bazohet në supozimin se fëmijët jo gjithmonë mund të jenë të vetëdijshëm për efektet e veprimeve të tyre ndaj personave tjerë dhe se në masë më të madhe janë të prirur për rehabilitim nga shkelësit e rritur të ligjit). Fëmijët në situatë të shfrytëzimit (mbrojtja e fëmijëve nga puna e fëmijëve, shfrytëzimit seksual, shitja, tregtia dhe përdorimi i narkotikëve). Fëmijë në situatë të rrezikut (mbrojtja e fëmijëve nga konfliktet e armatosura, rreziku, pa marrë parasysh nëse ato janë shkakuar nga konflikti njerëzor ose nga fatkeqësia natyrore).

Konventa për të drejtat e fëmijës përmban dispozita që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës.

Mbrojtja e fëmijëve duhet të jetë:

...nga keqpërdorimi dhe mospërfillja,

...e fëmijëve pa prindër,

...nga shfrytëzimi në punë,

...nga keqpërdorimi seksual,

...nga neglizhenca,

...nga konfliktet e armatosura,

...nga keqpërdorimi i drogës,

...nga tregtia me njerëz,

...të fëmijëve që janë në përplasje me ligjin,

...të fëmijëve nga tortura dhe privimi nga liria.

Sipas nenit 36 të Konventës, fëmija ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga format tjera të shfrytëzimit të cilat nuk i kemi përmendur deri më tani, respektivisht të cilat nuk janë përfshirë me dispozitat tjera të Konventës.

Këtu do të kishim theksuar disa shembuj të shfrytëzimit të fëmijës:

Shfrytëzimi i mundit të fëmijës, fëmijë shërbëtorë, shfrytëzimi i fëmijëve për lypsari; shfrytëzimi i fëmijëve të talentuar, për shembull për sporte të caktuara, lojëra, arte interpretuese; shfrytëzimi i fëmijëve si modele; shfrytëzimi i fëmijëve nga ana e mediave duke i identifikuar si fëmijë viktime, si fëmijë kundërvajtës; shfrytëzimi i fëmijëve për xhirim të reklamave të ndryshme për përfitime më të larta pa njoftim paraprak informativ të fëmijës për qëllimin e reklamës. Këtu do ta kishim përmendur edhe keqpërdorimin politik të fëmijëve, shfrytëzimin e fëmijëve për arritje të qëllimeve politike.

Informata themelore për këtë pjesë ka në Burime.

Hapi 5: Roli i ombudsmanëve të nxënësve (45 minuta)

Këtë pjesë të punëtorisë mund ta filloni me një diskutim me nxënësit për atë se sa ata kanë njohuri për funksionin dhe rolin e tyre si nxënës ombudsman.

Njoftojni pjesëmarrësit që roli i nxënësit ombudsman përbëhet prej dy komponentëve:

1. promovimi i të drejtave të fëmijëve;
 2. mbështetja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Më tepër informata mund të gjenden në pjesën Burime.

Në pjesën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, çdo ombudsman i nxënësve duhet të dijë cila është procedura për dorëzimin e parashtrësës.

Përgatitni shembull për hartimin e një parashtrësë dhe shqyrtojeni dhe diskutojeni atë me pjesëmarrësit, për atë se çfarë informata duhet të përfshihen në parashtrësë, mënyrën e dorëzimit të parashtrësës, identifikimin e parashtruesit ose parashtrësës anonime apo parashtrësës individuale apo grupore.

Njoftojni pjesëmarrësit që nxënësi ombudsman është ai i cili vendos nëse parashtrësja është adekuate dhe si e

tillë do të vazhdojë të ndjek procedurën ose po nuk ka shkelje të ndonjë të drejte të fëmijës.

Procedura e tërësishme duhet të përpilohet në mënyrën më të thjeshtë në formë të shkruar dhe e qasshme për të gjithë nxënësit.

Më tepër informata mund të gjeni në pjesën Burime.

Hapi 6: Përmbledhja e punëtorisë (15 minuta)

Pyetni fëmijët çfarë u ka lënë përshtypje më të madhe nga punëtorja e sotme?

Çfarë ka qenë më interesante për to?

Cila pjesë ka qenë më pak interesante/e mërzitshme për to?

A kanë ndonjë pyetje në lidhje me temat dhe diskutimet e sotme?

A kanë pasur mundësi të përfshihen në mënyrë aktive në aktivitetet dhe diskutimet gjatë punëtorisë?

Burime

Të drejtat për mbijetesë dhe zhvillim

Krahas tre të drejtave themelore të cilët e përbëjnë trekëndëshin e të drejtave, për çdo fëmijë është me rëndësi e drejta për mbijetesë dhe zhvillim e garantuar me nenin 6 të Konventës.

Çfarë do të thotë kjo e drejtë dhe si të sigurohet ajo?

Sipas nenit 6 të Konventës, çdo fëmijë ka të drejtë për jetë me vetë momentin e lindjes. Çfarë do të thotë kjo?

Kjo do të thotë që të gjithë fëmijët kanë të drejtë për jetë të sigurt, liri dhe siguri personale, ndërsa kjo do të thotë që fëmija duhet të ketë shtëpi, ushqim, dashuri prindërore, standard adekuat jetësor, nivelin më të lartë të mbrojtjes shëndetësore, të jetë i mbrojtur nga keqpërdorimi, keqtrajtimi dhe anashkalimi.

Kjo do të thotë se duhet të bëjmë çmos që asnjë fëmijë mos ti rrezikohet jeta, asnjë fëmijë mos të jetë e privuar nga jeta e tij. Çdo fëmijë duhet ti sigurojmë kushte për mbijetesë dhe zhvillim maksimal dhe të përqendrohemi kah rritja e jetëgjatësisë, kah zvogëlimi i mortalitetit të fëmijëve, kah lufta për luftimi i sëmundjeve, sigurimi i shtëpisë së ngrohtë dhe të sigurt, sigurimit të ushqimit, ujit dhe ajrit të shëndetshëm, ti mbrojmë fëmijët nga konfliktet e armatosura, vrasjet, dhuna, kidnapimi, shitja e fëmijëve, e të ngjashme.

Domethënë, që fëmija të mund ta gëzojë të drejtën për mbijetesë, duhet të ndërmerren të gjithë masat paraprake dhe të synojmë mbrojtjen e fëmijëve si dhe të udhëhiqemi nga nevojat dhe interesat e tyre.

FËMIJA KA TË DREJTË TË JETOJË ME PRINDËRIT E TIJ

Në mënyrë që të ketë kushte elementare për mbijetesë normale të fëmijës, së pari duhet të jetojë me prindërit e tij dhe në pajtim me nenin 9 të Konventës, asnjë fëmijë nuk duhet të ndahet nga prindërit e tij kundër vullnetit të tij, përveç se në rastet kur organi kompetent në bazë të procedurës adekuate dhe vendimit gjyqësor bie vendim se ndarja e tillë është e domosdoshme dhe është në interesin më të mirë të fëmijës.

Si mund të ndahet fëmija nga prindërit e tij?

Ndarja e fëmijëve nga prindërit para së gjithash duhet të jetë një masë të cilës i paraprinë një masë tjetër përmes të cilës duhet të përmirësohen marrëdhëniet në familje,

te punohet me prindërit, tu ndihmohet në aspekt material dhe profesional, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme.

Por, nëse edhe krahas të gjithë masave të ndërmarra, prindërit e keqtrajtojnë fëmijën e tyre, e anashkalojnë dhe e keqpërdorin, atëherë duhet vlerësuar nëse është më mirë që ky fëmijë të mbetet edhe më tej në familjen e këtillë ose të ndahet nga familja dhe të gjenden masa tjera alternative për përkujdesjen e tij.

Si e anashkalojnë?

Prindërit nuk kujdesen për fëmijën e mitur, për shëndetin e tij, nuk ndërmarrin masa për shërim të fëmijës nëse është i sëmurë, nuk mbajnë llogari për higjienën, nuk i sigurojnë ushqim, veshmbathje, nxehje, e lënë në rrugë, e keqtrajton fizikisht, e keqpërdorin (seksualisht, për punë), nuk i lejojnë të shkojnë në shkollë, e dërgojnë në rrugë, e të ngjashme. Edhe krahas të gjithë masave që i ndërmarrin organet kompetente ndaj familjes së këtillë, nëse gjërat nuk përmirësohen, atëherë fëmija duhet të ndahet nga prindërit e tij.

SHËNDETI DHE SHËRBIMET SHËNDETSORE

Gjithsesi se për mbijetesë dhe zhvillim normal, secilit fëmijë duhet t'i sigurohen kushte adekuate për ruajtjen e shëndetit dhe për ofrim të mbrojtjes adekuate shëndetësore.

Sipas nenit 24 të Konventës, fëmijës duhet t'i pranohet niveli më i lartë i mbrojtjes shëndetësore dhe mjekësore dhe rehabilitimi, ku çdo shtet duhet t'i ndërmerr të gjithë masat e mundshme që asnjë fëmijë të mos jetë i privuar nga e drejta për mbrojtje shëndetësore. Në këtë kuptim shteti duhet të ndërmerr masa adekuate për zvogëlimin e vdekshmërisë të foshnjat dhe fëmijët, duhet tu sigurojë të gjithë fëmijëve ndihmë adekuate mjekësore dhe mbrojtje shëndetësore, dhe gjatë kësaj t'i jepet theks mbrojtjes shëndetësore primare. Të ndërmerr masa për luftimin e sëmundjeve dhe mënjanimin e shkaktarëve që mund të sjellin deri në zhvillim të sëmundjeve, të sigurojë produkte adekuate ushqyese, ujë të pastër për pije, mjedis të shëndetshëm jetësor.

Gjatë kësaj duhet ti kushtohet vëmendje jo vetëm shëndetit fizik por edhe zhvillimit të tyre psikologjik. Sigurisht, konfliktet e armatosura, largimi i detyruar nga shtëpia dhe vendbanimi, kushtet e personave të zhvendosur, gjithashtu ndikojnë në shëndetin e fëmijëve, dhe në këtë drejtim bëhen përpjekje për t'u siguruar kushte normale të jetesës.

STANDARDI I JETËS

Që fëmija të ketë mbijetesë normale, është i rëndësishëm edhe standardi i jetës, meqë siç thamë, që fëmija të ketë jetë të sigurt, të mos diskriminohet, të jetë i shëndetshëm dhe pa pengesa t'i shfrytëzojë shërbimet shëndetësore, të arsimohet, të ketë të drejtë për lojë dhe rekreacion, fëmija duhet të ketë dhe standard adekuate të jetës.

Sipas nenit 27 të Konventës, fëmijës duhet t'i pranohet e drejta për standard jetësor adekuate me zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

Për sigurimin e standardit adekuate për jetë, para së gjithash përgjegjës janë prindërit, në suaza të aftësive të

tyre dhe mundësive financiare. Por, nëse prindërit nuk janë në mundësi t'u sigurojnë fëmijëve të tyre standard adekuate për jetë, a duhet t'i lëmë ato familje të gjinden vetë ose t'i lëmë pa mjete themelore për jetë? Gjithsesi, sipas Konventës, shteti ka obligim t'u ndihmojë në aspekt material këtyre familjeve nëse kanë nevojë për një gjë të tillë, por gjithsesi që shteti këtë mund ta bëjë në pajtim me kushtet kombëtare dhe në suaza të mundësive të veta.

Standardi për jetë nuk nënkupton vetëm kulm mbi kokë, por edhe ushqim, veshmbathje, kujdes, ndërsa për këtë duhet të sigurohen të drejta të caktuara sociale, në rast të pamundësisë së prindërve, në rast të papunësisë, në rast të sëmundjes, paaftësisë, në rast të vdekjes së prindërve.

KOHA E LIRË, REKREACIONI DHE AKTIVITETET KULTURORE

Që fëmija të zhvillohet në një person të shëndetshëm dhe normal, mes tjerash duhet t'i krijohen kushte për shfrytëzimin e kohës së lirë, të ketë mundësi për lojë dhe të merr pjesë në aktivitete kulturore dhe artistike.

Duke u nisur nga nevoja e fëmijëve për lojë, me nenin 31 të Konventës është përcaktuar që fëmija ka të drejtë për pushim, kohë të lirë, për lojë dhe rekreacion dhe në varësi nga mosha e tij duhet t'i jepet mundësia për pjesëmarrje në jetën kulturore dhe artistike.

Por, a i kanë këto të drejta fëmijët në rrugë dhe a mund ta realizojnë të drejtën e tyre për pushim, lojë dhe rekreacion? A mund t'i shfrytëzojnë këto të drejta fëmijët që shfrytëzohen për punë? A mund t'i shfrytëzojnë këto të drejta fëmijët që nuk shkojnë në shkollë dhe të cilët nuk kanë qasje në aktivitete kulturore dhe artistike, ose po fëmijët të cilëve u është kufizuar e drejta për pjesëmarrje dhe për shprehje të mendimit edhe nëpërmes manifestimeve kulturore dhe artistike? Por, po ashtu, parashtrohet pyetja nëse ndjekja e vazhdueshme e televizionit dhe lozja në kompjuter jep mundësi që fëmija të pushojë dhe të relaksimet.

Është më mirë që fëmija të shëtisë në natyrë, të merret me aktivitete sportive ose lojëra tjera me aktivitet fizik, se sa tërë ditën të jetë i mbyllur në shtëpi, respektivisht i ndarë nga shokët dhe të ndjek televizion ose të lozë në kompjuter. Gjithsesi fëmijës nuk duhet ti kufizohet e drejta për të shikuar televizion dhe të lozë në kompjuter, por në suaza kur kjo ndikon pozitivisht ndaj zhvillimit të tij.

Por, që fëmija të mund ta shfrytëzojë kohën e lirë për të lozur, për t'u marrë me aktivitete të lira, si dhe për realizim të këtyre të drejtave, në masë të caktuar ndikon edhe gjendja materiale e familjes dhe shtetit. Nëse familja është e varfër dhe nuk mund t'i lejojë vetes që fëmijës t'i sigurojë kushte dhe rekuizita për lojë, ose nëse shteti nuk ka objekte dhe hapësira për lojë dhe rekreacion të fëmijëve, gjithsesi që kjo e drejtë nuk do të mund të realizohet në praktikë.

E DREJTAT PËR ZHVILLIM

Krahas të drejtës për mbijetesë, fëmijët kanë të drejtë edhe për zhvillim, që nënkupton arritjen e maksimumit të potencialit të secilit fëmijë.

Kjo e drejtë në vete përfshin disa të drejta, të drejta të cilët duhet t'i sigurohen fëmijës që të ketë zhvillim normal në një person të shëndetshëm fizik dhe psikik.

Sipas Konventës, të drejta që janë të rëndësishme për zhvillimin e fëmijës janë:

- E drejta për identitet,
 - E drejta për arsim,
 - Sigurim të të drejtave të veçanta të fëmijëve me pengesa në zhvillim dhe fëmijëve me prejardhje autoktone.
- **E drejta për identitet** - neni 7 dhe 8
 1. Emër dhe kombësi (neni 7)
 2. Ruajtje të identitetit (neni 8)
 - **Fëmijë me pengesa në zhvillim** (neni 23)
 - **Arsimi** (neni 28 dhe 29)
 - **Fëmijë të pakicave**
 - **Fëmijë me prejardhje autoktone** (neni 30)

E DREJTA PËR IDENTITET

Sipas nenit 7 të Konventës, çdo fëmijë duhet të ketë një emër, duhet të jetë i regjistruar që të mund të realizojë të drejta tjera, të përfitojë nënshtetësi, të dijë cilët janë prindërit e tij dhe të drejtën që ata të kujdesen për të.

Fëmijës emri duhet t'i jepet menjëherë pas lindjes dhe për këtë duhet të pajtohen prindërit.

Me rëndësi për identitetin e çdo fëmije dhe bazë për realizimin e të drejtave të caktuara është regjistrimi në evidencën amë të të lindurve. Nëse fëmija nuk ka emër, nuk është i regjistruar askund, atëherë sikur nuk ekziston dhe nuk mund të realizojë asnjë të drejtë, nuk mund të shfrytëzojë shërbime shëndetësore, të shkojë në shkollë, të punësohet, të pranojë ndihmë nga shteti dhe të realizojë të drejta tjera. Prandaj është e rëndësishme për çdo shtet, andaj edhe për Maqedoninë, t'i ndërmerr të gjithë masat e mundshme që çdo fëmije ti jepet emër, nënshtetësi, të regjistrohet në librat amë, ti njohë prindërit dhe ata të kujdesen për të.

FËMIJËT ME PENGESA NË ZHVILLIM

Fëmijët me pengesa në zhvillim, para së gjithash i gëzojnë të gjithë të drejtat sikur edhe fëmijët tjerë. Ata duhet të jenë të barabartë me fëmijët tjerë, por megjithatë për shkak të nevojave tyre të posaçme duhet tu kushtohet kujdes, arsim dhe trajnim i veçantë.

Sipas nenit 23 të Konventës, fëmijët me pengesa në zhvillim duhet të gëzojnë jetë të plotë dhe me dinjitet, me nxitje që të jenë sa më të pavarur dhe t'u lehtësohet jeta me pjesëmarrje aktive në bashkësi.

Sipas Konventës, këto fëmijë, para së gjithash duhet të qëndrojnë në familjet e tyre, dhe vetëm në rast të fundit të akomodohen në institucione. Këto fëmijë duhet të kenë kujdes të veçantë për të cilin shteti duhet t'i jep ndihmë familjes që ka një fëmijë të tillë, në varësi nga mundësitë e tij dhe nevojat dhe gjendjen e fëmijës. Këtyre fëmijëve duhet t'u sigurohet arsim, mbrojtje e plotë shëndetësore, rehabilitim dhe integrim i plotë shoqëror,

si dhe zhvillim të tyre personal.

Fëmijët me pengesa në zhvillim nuk guxojnë të jenë të ndarë nga bashkësia, por duhet të gjendet mënyrë të jenë pjesë e arsimit të rregullt dhe e gjithë aktivitetëve të cilat i kanë edhe fëmijët tjerë.

ARSIMI

Një nga të drejtat mjaft të rëndësishme për zhvillimin e fëmijës është e drejta për arsim, e garantuar me nenet 28 dhe 29 të Konventës.

Sipas këtyre dispozitave të Konventës, fëmija ka të drejtë për arsim. Realizimi i kësaj të drejte duhet të jetë nën kushte dhe mundësi të barabarta, në veçanti fëmijët kanë të drejtë dhe obligim për arsim fillor, i cili duhet të jetë pa pagesë për të gjithë dhe inkurajohet zhvillimi i formave të ndryshme të arsimit të mesëm, i cili duhet të jetë i qasshëm për të gjithë fëmijët nën kushte të barabarta.

Gjatë kësaj shteti duhet të stimulojë shkuarjen në shkollë përmes vendosjes së arsimit pa pagesë dhe dhënies së ndihmës financiare në rast të nevojës. Konventa në veçanti kërkon që disiplina në shkolla të zbatohet në mënyrë e cila është në pajtim me dinjitetin njerëzor, e kjo do të thotë që në shkollë nuk duhet të zbatohen masa për ndëshkim fizik dhe psikik të fëmijës. Duhet të respektohet personaliteti dhe dinjiteti i fëmijës dhe ti jepet mundësi të shpreh mendimin e tij dhe ti kushtohet vëmendja e duhur mendimit të tij.

Në të njëjtën kohë, Konventa parashikon obligime për shtetet nënshkruese të drejtojnë edukimin e fëmijës drejt zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe zhvillimin e talentit dhe aftësive mendore dhe fizike deri në maksimum.

Përmes arsimit tek fëmija duhet të zhvillohet talenti dhe aftësitë fizike dhe mendore dhe të zhvillohet ndjenja për respektim të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe respektimin e prindërve të fëmijës. Njëkohësisht, përmes arsimit duhet të zhvillohet identiteti kulturor, gjuha, vlerat, vlerat kombëtare, si dhe përmes arsimit fëmija të përgatitet për jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë dhe demokratike në frymën e mirëkuptimit, paqes dhe tolerancës, barazisë dhe miqësisë ndërmjet popujve dhe grupeve etnike. Përmes arsimit duhet të zhvillohet edhe respektimi i mjedisit jetësor. Por, akoma në pikëpamje të drejtës për arsim ekzistojnë diskriminime ndërmjet fëmijëve edhe atë më shpesh në varësi nga gjinia, për shkak të pengesave në zhvillim dhe për arsye tjera. Akoma ka numër të madh fëmijësh që nuk shkojnë në shkollë dhe këtu numri më i madh janë vajza, edhe pse arsimit për vajzat është me rëndësi jetike.

Po ashtu, e drejta për arsim u është kufizuar fëmijëve nga mjediset rurale, fëmijëve në burg dhe fëmijëve të varfër.

Исто така правото на образование им е ограничено и на децата од рураëните средини, децата во затвор и сиромашните деца.

FËMIJËT NGA PAKICAT OSE FËMIJËT ME PREJARDHJE AUTOKTONE

Sipas nenit 30 të Konventës, në shtetet ku jetojnë më tepër pakica etnike, fetare ose gjuhësore ose persona me prejardhje autoktone, fëmija i cili i përket një pakice të tillë ose është me prejardhje autoktone nuk guxon të privohet në bashkësi së bashku me anëtarët tjerë të grupit nga e drejta për kulturën, konfesionin e tij fetar dhe kryerjen e riteve fetare ose nga përdorimi i gjuhës së vet.

Të drejtat e fëmijëve që kanë të bëjnë me mbrojtjen

A është e mjaftueshme për fëmijën vetëm t'ia sigurojmë të drejtat themelore e mos të mbajmë llogari për mbrojtjen e tij. A mund të thuhet që fëmija i cili vazhdimisht keqtrajtohet, keqpërdoret ose anashkalohet, i gëzon të gjithë të drejtat dhe që ka mundësi për mbijetesë, rritje dhe zhvillim normal dhe a mund të thuhet që ai fëmijë është i barabartë me fëmijët tjerë.

Një fëmijë që është i keqtrajtuar, keqpërdorur, pa marrë parasysh në çfarë forme, ose i anashkaluar, nuk ka kushte themelore për mbijetesë, rritje dhe zhvillim normal, nuk ka mundësi për jetë të sigurt.

Me qëllim që fëmijët ti gëzojnë të gjithë të drejtat, të mos keqpërdoren, keqtrajtohen dhe anashkalohen, Konventa për të drejtat e fëmijës përmban dispozita që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës.

Në këtë grup përmes Konventës janë paraparë të drejtat në vijim:

1. **Mbrojtja nga keqpërdorimi dhe anashkalimi,**
2. **Mbrojtja e fëmijëve pa prindër,**
3. **Mbrojtja e fëmijëve nga konfliktet e armatosura,**
4. **Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi për punë,**
5. **Mbrojtja e fëmijëve nga droga,**
6. **Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual,**
7. **Mbrojtja e fëmijëve që janë në ndeshje me ligjin, dhe**
8. **Mbrojtja e fëmijëve nga tortura dhe privimi nga liria.**

Me nenin 19 të Konventës shteti obligohet t'i ndërmerr të gjithë masat adekuate legislative, administrative, sociale dhe arsimore për shkak të mbrojtjes së fëmijës nga të gjithë format e dhunës fizike dhe mendore, lëndimet dhe keqpërdorimet, anashkalimet dhe sjelljet neglizhuese, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshi edhe shfrytëzimin dhe keqpërdorimin seksual.

Këto masa mbrojtëse ndërmerren derisa fëmija gjendet te prindërit e tij, por edhe në raste kur fëmija është i vendosur në institucione, kur është në shkollë ose kur realizon të drejta në institucione tjera.

Që fëmija të mbrohet nga këto forma të keqpërdorimeve, nevojitet të miratohen programe dhe ligje të tilla sociale të cilët do të mundësojnë parandalim, përcaktim, paraqitje, përcjellje dhe hetim të gjithë këtyre rasteve, si dhe në rast të nevojës edhe zbatim të procedurës gjyqësore.

Me këtë nen të Konventës në fakt vërtetohen të drejtat e barabarta të cilët i gëzojnë fëmijët, ndërsa janë në ndërlidhje të ngushtë me të drejtën për jetë dhe të drejtën për mbijetesë dhe zhvillim maksimal.

Për sigurimin e kësaj të drejte, duhet të merren parasysh shumë të drejta të tjera të parapara në Konventë, siç janë përgjegjësia prindërore për kujdes ndaj fëmijëve, pastaj çështja rreth disiplinës në shkollë, ndëshkimit fizik në institucione, e para së gjithash në institucionet ndëshkimore-përmirësuese.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve, fizike dhe mendore, ndërsa anashkalimi i fëmijëve mund të kryhet me qëllim ose të jetë e shkaktuar për shkak të paaftësisë së prindit për t'i dhënë kujdes adekuat ose për shkak të mbingarkesës së prindi nuk mund t'ia ofrojë kujdesin adekuat dhe ta mbrojë nga fatkeqësitë.

Masat për mbrojtje duhet të përfshijnë masa sociale, masa edukative, si dhe mbështetje adekuate për fëmijën dhe familjen, përmes edukimit të prindërve dhe fëmijëve për të drejtat e fëmijëve dhe për mbrojtje të fëmijëve përmes ndihmesës së prindërve gjatë kryerjes së të drejtës prindërore.

Vend të posaçëm zë dhuna familjare e cila akoma mohohet, njerëzit akoma turpërohen të flasin publikisht për të, por duhet të flasin publikisht për të dhe duhet t'i ndërmarrim të gjithë masat për mbrojtje të fëmijës nga dhuna familjare.

Në kodin penal të Maqedonisë janë parashikuar më tepër vepra penale të cilët i sanksionojnë veprimet e drejtuara ndaj fëmijëve, por megjithatë nuk mund të themi që nuk ka dhunë familjare dhe që të gjithë që zbatojnë një dhunë të tillë ndaj fëmijëve janë dënuar në mënyrë adekuate.

Po ashtu, edhe në Ligjin për familje të Maqedonisë ekzistojnë mundësi që fëmija t'u merret prindërve, tu kufizohet e drejta e tyre prindërore nëse ata e keqpërdorin, keqtrajtojnë ose e anashkalojnë fëmijën e tyre. Por, megjithatë, këto masa ndërmerren vetëm si një zgjidhje e fundit, para së gjithash ndërmerren masa për t'i ndihmuar edhe fëmijët edhe prindërit që të parandalohen dukuritë e tilla dhe fëmija papëseparë të mbetet të jetojë te prindërit e vet, por gjithsesi nëse ka rezultate nga masat e ndërmarra paraprakisht. Por, nëse nuk ka rezultate dhe nuk ekziston asnjë mundësi për përmirësim të prindërve, atëherë, edhe pse për fëmijën është më e mirë të jetojë me prindërit e tij, ai duhet të ndahet nga prindërit e tillë të cilët nuk kontribuojnë për rritjen dhe zhvillimin e tij normal.

Për fëmijët e këtyre zgjidhjeve më e mirë është të vendosen në një familje tjetër, por nëse kjo nuk është e mundur, si masë përfundimtare fëmija mund të vendoset në një institucion, por institucionet gjithnjë e më shumë duhet të shmangen meqë fëmijët e vendosur në institucione nuk janë fëmijë të lumtur.

E drejta për pjesëmarrje

Një nga të drejtat të cilët e përbëjnë trekëndëshin e të drejtave është e drejta për pjesëmarrje, por kjo e drejtë

në vete përmban edhe disa të drejta tjera të garantuara me Konventë, edhe atë:

- E drejta për mendim, ndërgjegje dhe religjion (neni 14),
- E drejta për shoqërim (neni 15),
- Mbrojtje të privatësisë (neni 16),
- Qasje në informata adekuate (neni 17),
- Liria për të dhënë dhe pranuar informata (neni 13).

LIRIA E MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE RELIGJIONIT

Sipas nenit 13 të Konventës, fëmija ka të drejtë lirshëm të shpreh mendimin e tij me se përfshihet edhe e drejta e tij të jep dhe të pranojë informata të të gjithë llojeve pa marrë parasysh kufijtë, qoftë në mënyrë të shkruar apo gojarisht, përmes shtypit, televizionit ose ndonjë media tjetër, gjithsesi sipas zgjedhjes së fëmijës. Lloji i informatave të cilat i pranon fëmija dhe mënyra e pranimit të informatave duhet të jetë e përshtatur për moshën e tij. Pranimi dhe dhënia e informatave mund të realizohet në mënyra nga më të ndryshmet (gojarisht, përmes dokumenteve të shkruara, përmes muzikës, filmave, librave, grafitëve, përmes veprimeve të të rriturve dhe porosive të cilët ata i dërgojnë me aktivitetet e tyre). Fëmijët duhet të trajnohen për t'i njohur informatat relevante dhe t'i dallojnë ata nga lajmet e rrejshme, të kenë marrëdhënie kritike ndaj informatave të cilat i pranojnë, t'i rishqyrtojnë dhe t'i analizojnë. Është veçanërisht e rëndësishme që fëmijët të trajnohen për t'i gjetur burimet adekuate të informatave të cilëve mund tu besojnë. E drejta për shprehje është e drejtë thelbësore për praktikimin e demokracisë dhe është drejtpërdrejtë e lidhur me respektimin e të drejtës së barabartë të të tjerëve për të pasur mendim personal dhe të mund të shprehin dhe mbrojnë atë mendim. E drejta për shprehje mund të kufizohet nëse është në dëm të respektimit të të drejtave dhe reputacionit të të tjerëve, ose për shkak të mbrojtjes së sigurisë kombëtare ose të rendit dhe qetësisë publike ose po nëse ajo ndikon dëmshëm ndaj shëndetit ose moralit publik. Domethënë, megjithatë të drejtat nuk mund të kuptohen si absolute dhe pa asnjë kufizim, sepse të drejtat mund t'i shfrytëzojmë vetëm nëse i respektojmë të drejtat e të tjerëve, respektivisht i shfrytëzojmë në mënyrë që nuk i shkel të drejtat e të tjerëve.

Në kuadër të së drejtës për shprehje të lirë bën pjesë edhe e drejta për liri të ndërgjegjes dhe religjionit, që nënkupton se çdo fëmijë ka të drejtë të ketë bindje të vet dhe për shkak të religjionit të tij ose besimit të tij fetar ose ndonjë besim tjetër nuk duhet të vuajë asnjë lloj kufizimi ose të diskriminohet.

E DREJTA PËR SHOQËRIM

Një e drejtë tjetër që bën pjesë në grupin e të drejtave për pjesëmarrje të fëmijës është e drejta për shoqërim e garantuar me nenin 15 të Konventës.

Kjo e drejtë nënkupton që fëmijës ti jepet e drejta dhe liria të shoqërohet dhe e drejta e tubimit të lirë. Kjo e drejtë nënkupton mundësi që fëmijët të organizohen në shoqëri të caktuara me qëllim të arritjes së ndonjë

qëllimi dhe interesi të përbashkët, ku kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm nëse me këtë shoqërim ose tubim publik rrezikohet siguria e shtetit, çrregullohet rendi dhe qetësia publike dhe nëse është në kundërshtim me normat ligjore, rrezikohet shëndeti publik ose po shoqërimi dhe tubimi publik janë në kundërshtim me botëkuptimet morale ose me të shkelen të drejtat e të tjerëve. Domethënë, në kushte të këtilla e drejta për shoqërim ose tubim publik mund të kufizohen.

Sipas legjisllacionit të Maqedonisë, fëmijët nuk mund të formojnë shoqëri qytetare deri sa të mbushin 15 vjet, mirëpo mund të praktikojnë këtë të drejtë përmes shkollave, përmes organizatave joqeveritare ose në mënyrë tjetër përmes klubeve të tyre të organizohen rreth ndonjë interesi të përbashkët dhe bashkërisht të veprojnë në zgjidhjen e ndonjë problemi të caktuar në shkollë, në bashkësinë vendore ose në nivel më të gjerë. Deri më tani me sukses funksionon parlamenti i fëmijëve si organizatë joqeveritare, ndërsa po ashtu fëmijët në shkollë organizohen në formë të bashkësisë së klasave, përmes të cilit shoqërim edhe veprojnë.

Sipas Ligjit për shoqatat dhe fondacionet: „Shoqatë qytetare mund të themelojnë persona të mitur në moshën 15 vjeç, përmes një deklarate për pëlqim për themelimin e një shoqate nga përfaqësuesi i tyre ligjor, për qëllimet për të cilat themelohet shoqata në pajtim me ligjin“ (neni 15).

Shoqërimi ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe në këmbimin e interesave të përbashkëta, shprehjen e qëndrimit të përbashkët dhe realizimin e qëllimeve të përbashkëta. Në këtë mënyrë i ndajmë idetë me të tjerët, sjellim vendime në interes të të gjithëve, e planifikojmë jetën personale në pajtim me njohuritë të cilët i fitojmë prej njerëzve të cilët i takojmë. Pa u takuar me persona tjerë dhe pa u shoqëruar dhe vepruar së bashku, fëmijët vështirë do të funksiononin siç duhet.

MBROJTJA E PRIVATËSISË

Me rëndësi për pjesëmarrjen e fëmijëve në krijimin e jetës personale është edhe mbrojtja e privatësisë së tyre e garantuar me nenin 16 të Konventës.

Sipas këtij neni të Konventës, asnjë fëmijë nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private dhe familjare, në shtëpi ose korrespondencën e tij personale. Po ashtu fëmija duhet të jetë i mbrojtur nga sulmet e paligjshme ndaj personalitetit dhe reputacionit të tij, sepse fëmijët edhe meqë janë të vegjël, ata janë persona me dinjitet dhe reputacion dhe të gjithë jemi të obliguar ta respektojmë këtë dhe të përmbahemi nga aktivitetet që do ta kishin lënduar dinjitetin dhe reputacionin e fëmijëve.

Privatësia e fëmijës nënkupton që gjërat personale janë gjëra personale dhe se edhe fëmija ka të drejtë të jetojë jetën e tij pa shqetësim ose përgjim.

Privatësia, para së gjithash ka të bëjë me hapësirën fizike rreth fëmijës, e cila nuk duhet të shqetësohet pa ndonjë nevojë të veçantë dhe pa lejen e fëmijës.

Në realizimin e këtij parimi duhet të theksohet se fëmijët mund të mbajnë ditar dhe ai nuk duhet të lexohet

nga prindërit, mësuesit ose edukatorët për fëmijët që janë vendosur në shtëpi fëmijësh.

Një formë e veçantë e rrezikimit të mundshëm të privatësisë së fëmijës është publikimi i papërshtatshëm i të dhënave personale nga ana e mediave. Mbrojtja e integritetit personal të fëmijës dhe dinjitetit të tij duhet të ngrihet në nivelin e përparësisë në çdo formë të raportimit mediatic.

Një formë e veçantë e rrezikimit të privatësisë së fëmijëve është fotografimi dhe shfaqja e paautorizuar e fëmijëve, pa lejen e prindërve/kujdestarëve ose vetë fëmijëve.

QASJA E FËMIJËS NË INFORMATA ADEKUATE

Me këto komente tash më kemi hyrë në një të drejtë tjetër e cila përshtatet me të drejtën për pjesëmarrje, ndërsa kjo është e drejta për qasje të fëmijëve në informata adekuate e garantuar me nenin 17 të Konventës. Sipas këtij neni, shteti është i obliguar t'ua pranojë ro-

lin e rëndësishëm të mjeteve për informim publik dhe t'i mundësojë fëmijës qasje në informata që janë të dobishme për të dhe me të cilët avancohet mirëqenia e tij sociale, shpirtërore dhe morale dhe shëndeti fizik dhe mendor. Për këtë shteti duhet të:

- nxis mjetet për informim publik t'i përhapin informatat me karakter social dhe kulturor për fëmijët,
- nxis bashkëpunimin ndërkombëtar për këmbim të përvojave dhe informatave nga kulturat e ndryshme, burimet kombëtare dhe ndërkombëtare,
- nxis përhapjen e librave për fëmijë,
- nxis mjetet për informim publik të kushtojnë vëmendje të veçantë ndaj nevojave linguistike të fëmijës, posaçërisht për fëmijët nga pakicat ose fëmijët me prejardhje autoktone, dhe
- nxis ndalesën për përhapje të informatave të cilët janë të dëmshme për fëmijën dhe mirëqenien e tij.

4.7. Modul për punëtori për arsim ndërkulturor

Aktiviteti: Gjetja në grup

Përshkrim i aktivitetit

Pjesëmarrësit ndahen në grupe sipas temave të ndryshme:

- grupi sipas përkatësisë etnike,
- grupi sipas përkatësisë fetare,
- grupi sipas ngjyrave të preferuara (e bardhë, e zezë, e kuqe, e kaltër),
- grupi sipas ushqimit të preferuar.

Reflektim

Si ju pëlqeu ushtrimi?

Çfarë mësuar nga ushtrimi?

Qëllimi i ushtrimit është që pjesëmarrësit të shohin se fëmijë të ndryshëm me prejardhje të ndryshme i takojnë të njëjtin grup.

Koha: 15 min.

Aktiviteti: Ushtrim „Ajsbergu“

Materiali i nevojshëm: letër flipçart, shënues, fletë letre me format A4 për të gjithë pjesëmarrësit dhe shënues për çdonjërin.

Përshkrim i aktivitetit

Në letër flipçart do të shënohet fjala kulturë, ndërsa pastaj të gjithë pjesëmarrësit, përmes stuhi idesh, duhet të tregojnë se çfarë do të thotë për to kultura. Pasi të shënohen idetë, në anën tjetër vizatohet ajsbergu. Atëherë do ti pyesim nxënësit çfarë dinë për ajsbergun? I pyesim sa mbi ujë dhe sa nën ujë gjendet ajsbergu që të vizatohet vija. Vija vizatohet në atë mënyrë që përafërsisht 20 % e ajsbergut të mbetet mbi ujë. Shumë njerëz e kanë ndërlidhur ajsbergun me kulturën e njerëzve, sepse mund të tregosh shumë për kulturën e një njeriu vetëm nëse e shikon. Këto janë ata 20 % të ajsbergut që mbeten në sipërfaqe. Por, shumë virtyte të njeriut dhe kulturës së tij mbeten të fshehura ose janë nën ujë.

Pastaj zhvillohet diskutim me pjesëmarrësit se ku sipas tyre do ti kishin vendosur idetë që i kanë dhënë më herët.

Me siguri shumica e ideve që do të jepen do të jenë mbi sipërfaqen dhe atëherë do të kërkohet nga pjesëmarrësit të japin më tepër ide të cilët do ti kishin vendosur nën ajsbergun. Shumica e këtyre ideve duhet të jenë lidhur me vlerat dhe perceptimet e situatave. Do të jepen shembuj që të fillojnë të mendojnë. Për shembull, dituri, fe, zakone, rregulla, etj. Kjo është diçka që shkon poshtë në ajsberg.

Pjesëmarrësve u sqarohet që pjesa më e madhe e njerëzve i vlerësojnë njerëzit tjerë në bazë të asaj që e shohin dhe supozojnë se njohin dikë vetëm nga ajo që e kanë parë. Por, për ta kuptuar dikë, duhet të shikojmë më thellë që të shohim se çfarë dëshiron ai njeri, çfarë e bën të lumtur, të brengosur, përse disa festa ose kremte tjera kanë rëndësi për të. Ne mund të njoftohemi më mirë me njëri-tjetrin nëse do ti ndajmë këto vlera tona të cilët nuk shihen aq shumë dhe nuk njihen nga të tjerët.

Ushtrim

Çdo pjesëmarrësi do ti jepet një fletë e zbrazur dhe një laps shënues dhe do të duhet të vizatojë një ajsberg dhe të përshkruajë veten, çfarë është ajo që do të shkojë mbi sipërfaqe, e çfarë nën sipërfaqen. Mund ti shfrytëzojnë shembujt e dhënë nga stuhia e ideve, por nuk duhet të kufizohen vetëm në to. Pastaj arsimtari do të pyes kush dëshiron ta prezantojë atë që është shkruar.

Në fund arrihet në përfundim që të gjithë duhet të përipiqen ti shohin gjërat nën vijën e ujit, të përipiqen ti kuptojnë të tjerët më thellësisht dhe ti kuptojnë arsyet përse i prezantojnë ato gjëra që janë mbi ujë e ajsbergut.

Koha: 20 min.

5.

SHTOJCA - FORMA TË DOKUMENTEVE

SHTOJCA 1

Formular për paraqitje për zgjedhje të kryetarit të bashkësisë së paraleles

Emri dhe mbiemri i kandidatit: _____

Klasa: _____

Kombësia: _____

Sjellja nga viti paraprak shkollor: _____

Suksesi nga viti paraprak shkollor:

- A) Mjaftueshëm
- B) Mirë
- C) Shumë mirë
- D) Shkëlqyeshëm

Nënshkrimi i nxënësit: _____

Data: _____

Nënshkrimi i prindit: _____

Data: _____

SHTOJCA 2

Lista me nënshkrime për mbështetje nga nxënësit për propozimin për kryetar të bashkësisë së paraleles (minimum 1/5 nënshkrime nga numri i përgjithshëm i nxënësve)

Emri dhe mbiemri i kandidatit: _____

Klasa: _____

Emri dhe mbiemri:

Nënshkrimi:

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

6. _____

7. _____

8. _____

9. _____

10. _____

SHTOJCA 3

Letër motivuese për kryetar të bashkësisë së paraleles

Në hapësirën e zbrazët më poshtë mund të shënosh pse do të kishe dashur të bëhesh kryetar i bashkësisë së paraleles. Mendo dhe shëno përse je ti kandidati më i mirë për këtë pozitë. Çfarë do të kishe bërë po të ishe kryetar i paraleles tënde.

Emri dhe mbiemri i kandidatit: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

SHTOJCA 4: THIRRJE PËR ZGJEDHJE TË OMBUDSMANIT TË NXËNËSVE DHE ZËVENDËS OMBUDSMANË TË NXËNËSVE

Sh.F.K., _____ " shpall thirrje për zgjedhje të ombudsmanit të nxënësve dhe zëvendës ombudsmanë të nxënësve.

Nxënësi ombudsman është nxënës i cili do të kujdeset për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në shkollë, i cili do të ketë obligim t'i promovojë të drejtat e fëmijës, të njoh shkeljen e të drejtave të fëmijëve në kuadër të shkollës dhe t'i paraqesë të gjithë rastet e shkeljes së të drejtave të fëmijëve te organet kompetente në dhe jashtë shkollës (kuadri shkollor dhe Ombudsmani).

I. KUSHTET PËR PJESËMARRJE

Të drejtë për paraqitje për funksionin ombudsman i nxënësve kanë **nxënësit e klasës 7, 8 ose 9.**

Të drejtë për paraqitje për funksionin zëvendës ombudsman i nxënësve kanë **nxënësit e klasës 6, 7 dhe 8.**

II. MËNYRA DHE AFATI I PARAQITJES

Dokumente për paraqitje: **fletëparaqitje dhe letër motivuese.**

Kandidatët e interesuar mund të marrin një **fletëparaqitje** nga shërbimi **pedagogjik-psikologjik** në shkollë. Është e nevojshme që kandidatët ta plotësojnë dhe dorëzojnë fletëparaqitjen te shërbimi pedagogjik-psikologjik.

Letra motivuese dorëzohet në formë të lirë.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve: _____

III. KRITERET PËR ZGJEDHJE

Zgjedhjen e ombudsmanit të nxënësve dhe zëvendësve të tij e kryejnë nxënësit prej klasës 7 deri 9, sipas kriterëve në vijim:

- **gjinia,**
- **mosha,**
- **njohje themelore e të drejtave të fëmijëve,**
- **motivimi për paraqitje,**
- **aftësitë komunikuese dhe organizative,**
- **përkatësia etnike,**
- **përvoja paraprake, respektivisht përfshirja në aktivitetet jashtë mësimore.**

IV. DETYRAT DHE OBLIGIMET e nxënësit ombudsman dhe zëvendësve të tij:

- pjesëmarrje në trajnimin fillestar për rolin dhe obligimet e nxënësit ombudsman, organizuar nga ana e shërbimit pedagogjik-psikologjik (ekipi për mbështetje të pjesëmarrjes së nxënësve);
- promovimi i të drejtave të fëmijës në shkollë përmes punëtorive edukative për bashkëmoshatarë dhe ngjarjeve informative;
- grumbullimi i parashtrësave – ankesave nga nxënësit (njohje e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve dhe sigurim i mbrojtjes për respektimin e të drejtave të fëmijëve);
- komunikim dhe koordinim i rregullt me shërbimin pedagogjik-psikologjik.

Mandati i ombudsmanit dhe zëvendës ombudsmanëve të zgjedhur është 2 (dy) vite shkollore (nëse ombudsman është në klasë të 9, mandati i tij është një vit).

Personi për kontakt: _____

Qyteti: _____ /Data: _____

SHTOJCA 5: FLETËPARAQITJE PËR OMBUDSMAN TË NXËNËSVE

1. Emri dhe mbiemri: _____

2. Adresa e banimit: _____

3. Telefon për kontakt: _____

4. E-adresa: _____

5. Data e lindjes: _____

6. Gjinia: mashkull femër 7. Klasa: VII VIII IX

8. Kombësia:

a. Maqedonase b. Shqiptare c. Rome d. Turke e. Serbe

f. Tjetër, shëno: _____

9. A ke marrë pjesë më parë në aktivitete lidhur me promovimin ose mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?

Po Jo

Nëse ke marrë pjesë, shënoji aktivitetet: _____

10. A je i/e njoftuar me Konventën për të drejtat e fëmijës?

Po Jo

11. A ke qenë i/e përfshirë në ndonjë aktivitet në kuadër të organizatës së shkollës/aktivitete jashtë mësimore?

Po Jo

Nëse po, shënoji: _____

Fletëparaqitjen së bashku me letrën motivuese dorëzoheni te shërbimi pedagogjik-psikologjik!**Afati i fundit për paraqitje**

_____ .

SHTOJCA 6: FLETËPARAQITJE PËR ZËVENDËS TË OMBUDSMANIT TË NXËNËSVE

1. Emri dhe mbiemri: _____

2. Adresa e banimit: _____

3. Telefoni për kontakt: _____

4. E-adresa: _____

5. Data e lindjes: _____

6. Gjinia: mashkull femër

7. Klasa: VI VII VIII

8. Kombësia:

a. Maqedonase

b. Shqiptare

c. Rome

d. Turke

e. Serbe

f. Tjetër, shëno: _____

9. A ke marrë pjesë më parë në aktivitete lidhur me promovimin ose mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?

Po Jo

Nëse ke marrë pjesë, shënoji aktivitetet:

10. A je i/e njoftuar me Konventën për të drejtat e fëmijës?

Po Jo

11. A ke qenë i/e përfshirë në ndonjë aktivitet në kuadër të organizatës së shkollës/aktivitete jashtë mësimore?

Po Jo

Nëse po, shënoji: _____

Fletëparaqitjen së bashku me letrën motivuese dorëzojeni te shërbimi pedagogjik-psikologjik!

Afati i fundit për paraqitje

----- .

SHTOJCA 7: DEKLARATË PËLQIMI PËR KRYERJEN E FUNKSIONIT OMBUDSMAN I NXËNËSVE

Unë _____ (emri dhe mbiemri), nxënës në klasën ____, deklaroj që do ta kryej funksionin ombudsman i nxënësve në shkollën time në pajtim me obligimet e parashikuara, ndërsa në komunikim të vazhdueshëm me zëvendësit e ombudsmanit të nxënësve, parlamentin e nxënësve, shërbimin pedagogjik-psikologjik, si dhe me funksionet tjera drejtuese në shkollë.

Në _____
(vendi dhe data))

(nënshkrimi)

SHTOJCA 8: DEKLARATË PËLQIMI PËR KRYERJEN E FUNKSIONIT ZËVENDËS OMBUDSMAN I NXËNËSVE

Unë _____ (emri dhe mbiemri), nxënës në klasën ____, deklaroj që do ta kryej funksionin zëvendës i ombudsmanit të nxënësve në shkollën time në pajtim me obligimet e parashikuara, ndërsa në komunikim të vazhdueshëm me ombudsmanin e nxënësve, parlamentin e nxënësve, shërbimin pedagogjik-psikologjik, si dhe me funksionet tjera drejtuese në shkollë.

Në _____
(vendi dhe data)

(nënshkrimi)

SHTOJCA 9

Formular për paraqitjen e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve

1. Të dhëna për parashtruesin

Emri dhe mbiemri: _____

Mosha: _____

Gjinia: Mashkull Femër

Kombësia: _____

Telefoni: _____

E-adresa: _____

Shkolla: _____

Qyteti: _____

2. Përmbajtja

1. Përshkrim i problemit/shkeljes (përshkruani në hollësi si ka ndodhur problemi, kur dhe ku ka ndodhur, a keni dëshmi e të ngjashme).

2. Kush e ka bërë problemin/shkeljen:

Vendi dhe data:

Parashtrues (emri dhe mbiemri):

SHTOJCA 10

Lista për evidencë të të drejtave të shkelura të fëmijëve

Nxënësi ombudsman:

Emri i shkollës:

Qyteti:

Muaji:

Emri dhe mbiemri (nëse është anonime nuk do të shënohet emri por vetëm gjinia)	Klasa	Arsyetimi i fletëparaqitjes
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		
7.		

SHTOJCA 11

Plan vjetor për punën e parlamentit të nxënësve
(Plani për veprim i aktiviteteve)

Numri rendor	Aktiviteti	Afati kohor												Bartës të aktivitetit	Burimet materiale/ njerëzore	
		IX	X	XI	XII	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII			
1.	Organizimi i tribunës për të drejtat e njeriut														Mirjana Safeti	Ekspert për të drejtat e njeriut nga Universiteti Salla e shkollës
2.	Fushatë për pjesëmarrje të fëmijëve në vendimet e bashkësisë lokale														Anëtarë të trupit shkollor	Salla për takime (klasë) Letër, Bojëra
3.																
4.																

SHTOJCA 12

Forma e të drejtuarit me shkrim

(Memorandum/logo e parlamentit të nxënësve – nëse ka)

Deri te:

_____ (theksohet cilit trup i drejtohet kërkesa)

Lënda: _____ (titulli i kërkesës)

Të nderuar,

Filloni me përshkrimin e problemit (shkurt dhe qartë, me fakte)

Theksoni çfarë kërkon të ndërmerr ai trup dhe pse (shkurt dhe qartë)

Afati i pritur për përgjigje (me shkrim) (shembull 5 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës)

Me respekt,

(kush e dorëzon kërkesën)

Data dhe vendi:

SHTOJCA 13**Forma e procesverbalit**

Mbajtja dhe ruajtja e procesverbalit të diskutimeve që zhvillohen në takime dhe vendimet që marren në to është shumë e rëndësishme. Ata duhet të ruhen në një skedar të veçantë të quajtur:

Portofoli i _____ (shënohet forma e organizimit: parlamenti i nxënësve, bashkësia e paraleles, trup tjetër në shkollë).

Në shtojcë, një ekzemplar nga procesverbali:

Emri i shkollës:

Bashkësia e paraleles: _____

Procesverbal nga mbledhja

[Dita, data, muaji, viti]

Të pranishëm: (shënojini emrat dhe mbiemrat e pjesëmarrësve në mbledhje)

A. Miratimi i rendit të ditës

(Shënojini pikët nga rendi i ditës. Do të ishte mirë pikën e fundit ta bëjmë "të ndryshme" që të mundësohet diskutim për ndonjë çështje që është paraqitur në ndërkohë).

Rendi i ditës u miratua njëzëri (nëse nuk kishte vërejtje).

B. Miratimi i procesverbalit

Procesverbali i mbledhjes paraprake u miratua njëzëri (nëse nuk ka vërejtje).

C. Diskutim sipas pikëve të Rendit të ditës

Pika e parë, raportim për realizimin e vendimeve nga mbledhja e kaluar.

Përmbledhni çështjet që diskutohen, përcaktohen vendimet e miratuara.

D. Propozim-rend dite për mbledhjen e ardhshme

Përcaktohen çështjet të cilët duhet të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme.

Emër dhe mbiemër.

Miratuar nga: Emër dhe mbiemër (drejtues i mbledhjes).

SHTOJCA 14

Forma e listës për vlerësim për punën e parlamentit të nxënësve

Trupi koordinues i parlamentit të nxënësve, në bazë tremujore, i fton anëtarët e tërë trupit të plotësojnë listën për vlerësim të punës së trupit. Rezultatet nga ky vlerësim do të ndihmojnë të shqyrtohet se si drejtohet dhe si punon ky trup.

1. Çfarë mendoni për punën e _____?
2. Çfarë më pëlqen te _____?
4. Çfarë nuk më pëlqen te _____?
5. Rekomandimet e miya deri te _____ janë: _____.
6. Ju lutemi përshkruani një situatë të këndshme në suaza të _____: _____.
7. Ju lutemi përshkruani një situatë të pakëndshme në suaza të _____: _____.
6. Koment plotësues: _____.

SHTOJCA 15**Formulari për PLAN VEPRIMI**

PËR

ZBATIM TË UDHËZUESIT PËR PJESËMARRJE TË NXËNËSVE, ORGANIZIM TË NXËNËSVE DHE MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Shkolla: _____

Periudha e zbatimit: _____

Lista e anëtarëve të ekipit për mbështetje të pjesëmarrjes së nxënësve:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____

(shtoni nëse ka më tepër anëtarë të ekipit)

Nr. Rendor	Aktivitetet	Rezultatet e pritura	Korniza kohore	Numri i planifikuar i orëve për aktivitetin	Përgjegjësia
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.					
11.					
12.					
13.					

SHTOJCA 16

Formulari për RAPORTIM

PËR

ZBATIM TË UDHËZUESIT PËR PJESËMARRJE TË NXËNËSVE, ORGANIZIM TË NXËNËSVE DHE MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Periudha e raportimit: _____

Arsimtari: _____

Nr. Rendor	Aktivitetet e planifikuara	Aktivitetet e realizuara (përshkrim i shkurtë)	Korniza kohore (data dhe orë)	Pjesëmarrës
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				

ISBN 978-608-4631-13-2